Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT

2022

Gusht, 2023

Lista e shkurtesave

Fjala e Auditores së Përgjithshme

Përmbledhja ekzekutive

Kapitulli - I AUDITIMI I RAPORTIT VJETOR FINANCIAR TË BUXHETIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2022

1. Opinioni i auditimit 11
2. Korniza ligjore, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit 13
3. Deficiti buxhetor 16
4. Borxhi shtetëror dhe garancitë shtetërore 18
5. Analiza e buxhetit të shtetit 25
   5.1 Analiza e të hyrave / pranimeve sipas kategorive ekonomike 27
   5.2 Analiza e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike 30
   5.2.1 Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve 32
   5.3 Analiza e shpenzimeve sipas funksionit 34
   5.4 Analiza e pakos për rimëkëmbjen ekonomike 35
6. Pasqyra e pasurive në para të gatshme dhe bilanceve të fondeve 38
7. Shënimet shpjeguese 40
   7.1 Pasuritë jo financiare kapitale, jokapitale dhe stoqet 40
   7.2 Llogaritë e arkëtueshme 43
   7.3 Detyrimet e papaguara dhe kontingjente 45
   7.4 Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore 48
   7.5 Të dhënat e punësimit 50

Kapitulli - II PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE NGA AUDITIMET INDIVIDUALE – 2022

1. Përmbledhje e opinioneve, konkluzioneve dhe rekomandimeve 53
2. Niveli Qendror 55
   2.1 Opinionet e auditimeve dhe çështjet në modifikimin e tyre 55
   2.2 Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre 56
   2.3 Çështje tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë 56
   2.4 Rekomandimet e dhëna 58
3. Niveli Lokal 59
   3.1 Opinionet e auditimeve dhe çështjet në modifikimin e tyre 59
   3.2 Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre 60
   3.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë 61
   3.4 Rekomandimet e dhëna 64
4. Sistemi i auditimit të brendshëm 65

Kapitulli - III AUDITIMET E PERFORMANCËS, PROKURIMIT, TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE NDËRMARRJEVE PUBLIKE

1. Auditimet e Performances, Prokurimit dhe TI-së 68
   1.1 Auditimet e performancës 68

1.2 Auditimet e prokurimit 72
1.3 Auditimet e TI-së 76

2. Auditimet e Ndërmarrjeve Publike 80
2.1 Opinionet e auditimit dhe çështjet në modifikimin e tyre 81
2.2 Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre 83
2.3 Obligimet e Ndërmarrjeve Publike për Raportimin Vjetor Financiar 85
2.4 Çështjet tjera të Menaxhimit Financiar dhe të Pajtueshmërisë 87
2.5 Rekomandimet e vitit paraprak dhe niveli i zbatimit 88

Kapitulli IV ZBATIMI I REKOMANDIMEVE

1. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në RVA për vitin 2021 92
2. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale për vitin 2021 93
3. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna OB-ve nga KMFP për vitin 2021 95

Shtojca I: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në RVA 2021 96

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga KMFP pas shqyrtimit të raporteve të auditimit 101

Shtojca III: Llojet e opinioneve për OB-të e audituara në tri vitet e fundit 106

Shtojca IV: Shpjegimi i llojeve të ndryshme të opinioneve dhe konkluzioneve të aplikuara nga ZKA 109

Shtojca V: Letër Konfirmimi 112

Shtojca VI: Pasqyrat kryesore financiare të Qeverisë 113

Lista e shkurtesave

AP	Auditori i Përgjithshëm	**LIVTh**	Llogaria e Vetme e Thesarit
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit	**KOSTT**	Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës	**KRPP**	Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik
ARKEP	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	**MMPHI**	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
ARC	Agjenicia e Regjistrimit Civil	**MFPT**	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
AME	Agjencia për Menagjimin e Emergjenave	**MAPL**	Ministria e Administratës Publike
ANZH	Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim	**MPB**	Ministria e Punëve të Brendshme
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit	**MASHTI**	Ministria e Arsimit, Shkencës, Tekonoligjisë dhe Inovacionit
BB	Banka Botërore	**MSH**	Ministria e Shëndetësisë
BE	Bashkimi Evropian	**ME**	Ministria e Ekonomisë
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim	**NJQH/AB**	Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brenshëm
BPV	Bruto Produkti Vendor	**NjAB**	Njësia e Auditimit të Brendshëm
BRK	Buxheti i Republikës së Kosovës	**NP**	Ndërmarrjet Publike
BQK	Banka Qendrore e Kosovës	**OB**	Organizata Buxhetore
BZHKE	Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës	**OShP**	Organi Shqyrtues i Prokurimit
DK	Doganat e Kosovës	**PVF**	Pasqyrat Vjetore Financiare
GPD	Grantet e Përcaktuara të Donatorëve	**ShSKUK**	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar	**RFV/BRK**	Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës
IFN	Institucionet Financiare Ndërkombëtare	**RVA**	Raporti Vjetor i Auditimit
INTOSAI/ ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit	**RTK**	Radio Televizioni i Kosovës
KA	Komiteti i Auditimit	**SIMFK**	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
KBFP	Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike	**SNISA**	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
KMFP	Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike	**SNKSP**	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minierale	**SISH**	Sisitemi Informativ Shëndetësor
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve	**SGJC**	Sistemi i Gjendjes Civile
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës	**TVSH**	Tatimi në Vleren e Shtuar
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	**TI**	Teknologjia e Informacionit
LMFPP	Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë	**ZKA**	Zyra Kombëtare e Auditimit
LPP	Ligji për Prokurim Publik		

Fjala e Auditores së Përgjithshme



Qytetarët e Kosovës, përmes mekanizmave dhe formave të ndryshme, në mënyrë të vazhdueshme kontribuojnë në mbushjen e arkës së shtetit me qëllim që paraja publike e mbledhur t'u rikthehet në shërbime cilësore në infrastrukturë, shëndetësi, arsim, siguri dhe jetë më të mirë në përgjithësi.

Duke vlerësuar rëndësinë e madhe që ka përdorimi dhe ruajtja sa më e mirë e parasë dhe pasurisë publike, shoqëritë e ndryshme globale, historikisht i kanë dhënë peshë të veçantë mbikëqyrjes dhe rishikimit të proceseve të menaxhimit të sajë. Zyrtarët përgjegjës për administrimin e parasë duhet të sigurojnë se paratë e taksapaguesve shpenzohen në pajtueshmëri me kornizën ligjore, efikasitet, efektivitet dhe në dobi të qytetarëve. Përderisa, qytetarët taksapagues kanë të drejtë të jenë të informuar në lidhje më atë se ku dhe si po shpenzohen kontributet e tyre financiare.

Në kontekst të kësaj, Auditori i Përgjithshëm, në përputhje me mandatin kushtetues dhe ligjor ka dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Raportin Vjetor të Auditimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2022. Ky raport përmbledh rezultatet kryesore të punës audituese që Zyra Kombëtare e Auditimit ka arritur gjatë vitit 2022, i cili përfshin opinionin, gjetjet si dhe rekomandimet e auditimit.

Zyra Kombëtare e Auditimit, për sezonin auditues 2022/2023 ka arritur të përmbush planin auditues, duke rritur më tej cilësinë e rezultateve të sajë. Ka kryer 123 auditime, prej të cilave, 86 auditime financiare dhe të pajtueshmërisë për organizata buxhetore, 11 të ndërmarrjeve publike, 9 të projekteve të Bankës Botërore dhe donatorëve tjerë, 2 auditime me informata të klasifikuara me nivel të kufizuar si dhe 15 të performancës. Për shkak të rrethanave të krijuara, Zyra nuk ka kryer auditimin e katër komunave në pjesën veriore të vendit.

Edhe këtë vit, Zyra Kombëtare e Auditimit, ka zgjeruar fushëveprimin në institucione dhe fusha me interes të lartë publik të cilat nuk ishin audituar nga auditimi i shtetit vite me radhë. Po ashtu, duke e ditur rëndësinë e projekteve dhe aktiviteteve qeveritare që ndërlidhen drejtpërdrejt me rritjen e mirëqenies së qytetarëve, theks i veçantë i është dhënë auditimeve të performancës.

Fokusi kryesor i auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë ka qenë në cilësinë e raportimit financiar, efikasitetin dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, pajtueshmërinë e vendimeve të subjekteve të audituara me kornizën ligjore, si dhe çështjet të tjera që kanë të bëjnë me vlerën për para.
Duhet theksuar se cilësia e raportimit financiar ende vazhdon të mos jetë në nivelin e pritur, edhe pse, krahasuar me vitin 2021 ka përmirësime si në nivel të organizatave buxhetore ashtu edhe tek ndërmarrjet publike. Megjithatë, krerët e institucioneve publike duhet t'i kushtojnë vëmendje të theksuar ngritjes së cilësisë së raportimit financiar për të rritur besueshmërinë ndaj lexuesve të raporteve financiare.

Sfidë mbetet kryerja e transaksioneve dhe aktiviteteve në përputhje me kornizën ligjore, klasifikimi adekuat i shpenzimeve, regjistrimi dhe menaxhimi i pasurive, detyrimeve të pa paguara, procedurat e prokurimit dhe menaxhimi i kontratave, rritja e llogarive të arkëtueshme. Këto mangësi janë shoqëruar edhe me gjetje të tjera, por më frekuencë më të ulët, rezultatet e të cilave janë përmbledhur në këtë raport.

Forcimi i kontrolleve të brendshme është më se i nevojshëm në menaxhimin e projekteve infrastrukturore për të siguruar që ato udhëhiqen në pajtueshmëri me kornizën ligjore. Tek ndërmarrjet publike, menaxhimi dhe zvogëlimi i humbjeve kishte përmirësim të dukshëm për vitin 2022, sepse vetëm njëra nga to kishte trend rritës të humbjeve. Megjithatë, sfidë mbetet niveli i lartë i detyrimeve afatshkurtra dhe atyre afatgjata.
Për sa i përket performancës financiare të buxhetit të shtetit, krahasuar me vitin 2021, të hyrat e realizuara janë rritur rreth 6%. Poashtu, kemi rritje të shpenzimeve për mbi 246 milion €. Sipas trendit historik të tri viteve të fundit vërehet se pranimet dhe pagesat kanë shënuar rritje të vazhdueshme. Qeveria e Kosovës ka mbajtur kufirin e deficitit buxhetor në kuadër të limiteve të përcaktuara ligjore. Ndërsa, borxhi publik, në raport me vitin e kaluar ka shënuar rritje prej rreth 4%, mirëpo edhe më tutje mbetet brenda kufijve të përcaktuar ligjor. Sidoqoftë, mbetet sfidë mos efikasiteti në shfrytëzimin e fondeve të marra si hua të jashtme i shkaktuar kryesisht nga problemet me menaxhimin e projekteve infrastrukturore.

Më tutje, edhe për aktivitetet, programet dhe operacionet, si ne nivel qendror, ashtu edhe atë lokal në fusha me rëndësi ekonomike, shëndetësore, të mirëqenies sociale, teknologjisë se informacionit, prokurimit publik dhe fushat e tjera, auditimet e performancës tregojnë për mungesën e efikasitetit, llogaridhënies, efektivitetit dhe mos arritjen e vlerës për paranë e shpenzuar dhe shërbimeve ndaj qytetarëve.
Për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e proceseve kemi dhënë 900 rekomandime. Në lidhje më këtë, shfrytëzoj rastin të ftojë kryesuesit e institucioneve publike te ndërmarrin veprime konkrete me qëllim që të reflektojnë dhe ofrojnë sigurinë e nevojshme që paraja publike shpenzohet në përputhje me kornizën ligjore dhe për qëllimin e synuar. Ndërsa, inkurajojë Kuvendin e Republikës së Kosovës që rezultatet tona të auditimit t'i shfrytëzojë si informata të rëndësishme për t'i mbajtur llogaridhënës administruesit e parasë publike.

Auditorja e Përgjithshme,
Vlora Spanca

Prishtinë, gusht 2023

Përmbledhja ekzekutive

Raporti Vjetor i Auditimit mbi ekzekutimin e Buxhetit të Kosovës është i mbështetur në bazë të nenit 23, paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit nr. 05-L/055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Ky raport, për Kuvendin, Qeverinë dhe palët e tjera të interesit paraqet:

- Rezultatet e auditimit të Raportit Vjetor të Qeverisë mbi ekzekutimin e Buxhetit të Kosovës për vitin 2022; dhe
- Konkluzione dhe rekomandime të rëndësishme nga të gjitha auditimet e kryera gjatë sezonit audituesë që mbulon vitin 2022/2023.

Në përputhje me mandatin kushtetues, nenin 137 dhe 138 si dhe mandatit ligjor, neni 6 dhe 18 i Ligjit përkatës, Zyra Kombëtare e Auditimit gjatë sezonit audituesë 2022/2023 ka kryer dhe 123 auditime për të cilat janë lëshuar raportet përkatëse të auditimit. Prej tyre, 86 auditime financiare dhe të pajtueshmërisë janë kryer për organizata buxhetore, 11 auditime të ndërmarrjeve publike, 9 auditime të projekteve të Bankës Botërore dhe donatorëve tjerë, 2 raporte të auditimit të pajtueshmërisë të cilat janë me informata të klasifikuara me nivel të kufizuar si dhe 15 auditime të performancës. Rezultatet e këtyre auditimeve janë përmbledhur në këtë raport.

Sipas opinionit të Auditorit të Përgjithshëm, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Raporti Vjetor Financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2022 paraqet një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Më gjerësisht, shih kapitullin 1 Opinioni i Auditimit.

Në auditimin e Raportit Vjetor të Qeverisë mbi ekzekutimin e Buxhetit të Kosovës për vitin 2022, ZKA ka identifikuar çështje në lidhje me cilësinë e raportimit financiar, kontrolleve dhe menaxhimit financiar.

Pikëpamjet tona për fushat kryesore janë si në vijim:

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit - Pranimet/të hyrat sipas buxhetit të rishikuar/final për vitin 2022 ishin planifikuar 3,010,500,000€, me një rritje prej 105,500,000€ krahasuar me buxhetin fillestar, ndërsa ishin realizuar në vlerë prej 2,628,552,000€ apo 87% e buxhetit final. Krahasuar me vitin 2021, pranimet e realizuara janë rritur për 137,579,000€, apo rreth 6%.

Buxheti final për shpenzime ishte në vlerë prej 3,158,870,000€, ndërsa ishte realizuar në vlerë 2,625,008,000€ apo 83% e buxhetit final. Krahasuar me vitin 2021 kemi rritje të shpenzimeve për 246,283,000€, megjithatë, buxheti për investime kapitale ishte shpenzuar vetëm 60%.

Paraja e gatshme në fund të vitit 2022 është rritur për 3,544,000€ në krahasim me bilancin e vitit 2021. Bilanci bankar i parasë së gatshme në llogarinë e buxhetit të Republikës së Kosovës më 31 dhjetor 2022 ishte 445,734,000€.

Sipas trendit historik të tri viteve të fundit vërehet se pranimet dhe pagesat kanë shënuar rritje të vazhdueshme.

Deficiti buxhetor - Kufiri i deficitit buxhetor gjatë vitit 2022 ishte në kuadër të limiteve të përcaktuara ligjore dhe nga realizimi i buxhetit vërehet se niveli i inkasimit të të hyrave ishte përmirësuar dukshëm dhe ishte ulur kërkesa për financim. Për vitin 2022 deficiti i përgjithshëm i përllogaritur sipas buxhetit me rishikim ishte -333,506,000€ apo -3,88%. Po ashtu, nga auditimi vërehet që në fund të vitit sipas realizimit kishte suficit në vlerë prej 13,918,000€ apo 0.16% e BPV-së.

Borxhi publik[1] - Në fund të vitit 2022, vlera e borxheve publike ka arritur në 1,753,200,000€ apo rreth 20% të BPV-së. Prej tyre, 641,200,000€ janë borxhe të jashtme dhe 1,112,000,000€ borxhe të brendshme. Në raport me vitin e kaluar borxhi i përgjithshëm ka shënuar rritje prej 70,310,000€ apo rreth 4%, mirëpo edhe më tutje mbetet brenda kufijve të përcaktuar ligjor.

Sidoqoftë, është vërejtur mos efikasitet në shfrytëzimin e fondeve të marra si hua të jashtme. Kjo është shkaktuar kryesisht nga problemet me menaxhimin e projekteve infrastrukturore qoftë të planifikimit apo zbatimit të tyre. Pasojat e Covid -19 kishin vazhduar të kenë efekt edhe në vitin 2022 në menaxhimin e këtyre projekteve.

Llogaritë e arkëtueshme - krahasuar me vitin paraprak janë rritur për 62,897,519€, apo rreth 8%. Në vitin 2022, është vërejtur se llogaritë e arkëtueshme janë nënvlerësuar në vlerë prej 1,887,506€. Vlera e përgjithshme e prezantuar e llogarive të arkëtueshme në RVF-BRK ishte 840,946,133€ (nga këto 607,974,066€ të nivelit qendror dhe 232,972,067€ të nivelit lokal). Rritja e llogarive të arkëtueshme është një tregues që institucionet publike nuk kanë ndërmarrë masat e duhura për mbledhjen e të hyrave.

Detyrimet e papaguara dhe kontingjente - Krahasuar me vitin paraprak detyrimet e papaguara janë zvogëluar për 41,098,513€, apo rreth 22%. Kjo është një tregues pozitiv për menaxhimin e buxhetit të shtetit. Sipas RVF-BRK janë 149,734,697€. Përkundër kësaj më sipër, në raport me vitin paraprak këtë vit kemi një rritje të detyrimeve kontingjente në vlerë prej 109,606,877€ apo rreth 46%. Kryesisht, kjo rritje ka ndodh në nivelin lokal. Kjo paraqet sfidë për buxhetin e shtetit për shkak të mbingarkesës së buxhetit në të ardhmen dhe në veçanti, shpenzimeve shtesë që përfshin kjo kategori.

Pagesat sipas vendimeve të gjykatave dhe përmbaruesve - për vitin 2022 ishin në vlerë 46,349,349€. Në raport me vitin 2021, vlera e këtyre pagesave ka një rënie të lehtë prej 5,568,280€ apo 11%, mirëpo ende mbetet në nivel të lartë. Shpenzimet e kësaj natyre vazhdojnë të jenë sfidë për buxhetin e shtetit, në veçanti shpenzimet shtesë të cilat derivojnë nga këto procedura.

Pasuritë jo financiare - Rezultatet e auditimit tregojnë se shpalosjet mbi pasuritë jo financiare në vitin 2022 nuk kanë ofruar siguri të mjaftueshme se institucionet publike kanë kontrolle dhe monitorim të plotë mbi pasuritë dhe menaxhimin e tyre. Të dhënat e pasurive jo financiare në sistemet për menaxhimin e pasurive në SIMFK dhe e-pasuri në vitin 2022, janë jo të plota dhe gjendja e tyre është përcjellë me pasaktësi në raportim në vlerë prej 55,865,029€, përderisa në vitin 2021 kjo pasaktësi ishte 83,507,406€[2]. Sipas kësaj rezulton se institucionet publike kanë ndërmarrë masa përmirësuese, megjithatë edhe më tutje mbetet sfidë menaxhimi i pasurisë.

Rezultatet nga auditimet individuale

Organizatat buxhetore - Cilësia e raportimit financiar ende vazhdon të mos jetë në nivelin e pritur për shkak se nga 86 auditimet e pasqyrave vjetore financiare të organizatave buxhetore 33 sosh kishin keqdeklarime materiale të cilat kanë rezultuar me opinion të modifikuar/kualifikuar. Ndërsa,

[1] Informatat për borxhin publik në këtë raport janë prezantuar bazuar në Buletinin Vjetor 2022 mbi borxhin publik të publikuar nga MFPT/Thesar
[2] MMPHI në vitin 2022 ka korrigjuar gabimin e regjistrit duke e shlyer pasurinë në vlerë prej 71,801,641€ (mirëmbajtjen e rrugëve)

53 të tjera kanë rezultuar me opinion të pamodifikuar. Megjithatë, krahasuar me vitin e kaluar cilësia e raportimit financiar është përmirësuar për shkak se në vitin 2022 janë 13 organizata buxhetore më pak të cilat kanë marrë opinion të modifikuar. Prezantimi i saktë dhe i plotë i informatave financiare e rrit besueshmërinë e lexuesve ndaj raportimit financiar.

Ndërmarrjet Publike - Cilësia e raportimit financiar edhe pse krahasuar me vitin e kaluar është përmirësuar, megjithatë edhe te ndërmarrjet publike ende vazhdon të mos jetë në nivelin e pritur. Nga 11 auditimet e pasqyrave financiare të ndërmarrjeve publike, tek 1 është dhënë opinion i pamodifikuar, ndërsa tek 10 të tjera opinion i modifikuar (7 opinion të kualifikuar dhe 3 të kundërta). Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli në ndërmarrjet publike ka nevojë për përmirësime të mëtejmë, marrë parasysh që në 10 prej tyre pasqyrat financiare për 2022 përmbanin keqdeklarime materiale. Po ashtu, sa i përket pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi, krahasuar me vitin 2021, dy ndërrmarje kanë bërë progres duke kryer aktivitetet dhe transaksionet e tyre në pajtim me kornizën ligjore, ndërsa ndërrmarjet tjera në raste të caktuara nuk kishin kryer transaksionet dhe aktivitetet në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Po ashtu, lidhur me performancën financiare, vetëm një ndërrmarje ka treguar trend negativ të rritjes së humbjes, përderisa ndërrmarjet tjera kanë trend të zvogëlimit të humbjes dhe rrjedhimisht operimit me fitim. Po ashtu, rekomandimet e auditimit ishin zbatuar në nivel të kënaqshëm.

Auditimet e Performancës, Teknologjisë së Informacionit dhe Prokurimit - Auditimet e kryera gjatë 2022, kanë identifikuar mangësi në fusha me rëndësi ekonomike, shëndetësore, të mirëqenies sociale dhe prokurimit publik, që tregojnë për mungesën e efikasitetit, llogaridhëniesë, efektivitetit dhe mos arritjen e vlerës për paranë e shpenzuar dhe shërbimeve ndaj qytetarëve.

Mangësi të ndryshme janë identifikuar në: mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, investimet kapitale në kompanitë e ujësjellësit. Sistemi shtetëror i drejtësisë ka mangësi në mbrojtjen e viktimave të dhunës, ekzaminimin e rasteve dhe regjistrimin e incidenteve. Prokurimi publik vazhdon të mos menaxhohet mirë, procedurat nuk kanë qenë efektive dhe efikase dhe në raste të caktuara nuk është arritur vlera për paranë e shpenzuar. Projektet infrastrukturore, si: ndërtimi i rrugëve, stadiumeve, shtëpive për të kthyerit janë përcjellë me mangësi të shumta që nga planifikimi deri tek funksionalizimi i projekteve. Edhe projektet e financuara nga donatorët në raste të caktuara nuk janë menaxhuar si duhet. Gjithashtu, masa përmirësuese duhet të ndërmerren në programin për trajtimin e pacientëve jashtë institucioneve shëndetësore publike.

Në fushën e teknologjisë së informacionit, institucioneve përgjegjëse u mungojnë masat adekuate të kontrollit, duke rrezikuar integritetin e sistemit. Menaxhimi i projekteve të teknologjisë së informacionit nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit dhe Institutin Bujqësor të Kosovës ka rezultuar me shpenzime të panevojshme dhe dëmtim të buxhetit. Përderisa sistemi i prokurimit elektronik ka efekte pozitive në rritjen e kontrolleve, efikasitetit dhe transparencës në prokurim publik. Megjithatë, ka mangësi në funksionimin dhe ruajtjen e vazhdueshme të stabilitetit dhe integritetit të këtij sistemi.

Zbatimi i rekomandimeve - Nga raportet individuale të auditimit është vlerësuar se 49% e rekomandimeve të dhëna në vitin 2021 janë zbatuar plotësisht, ndërsa krahasuar me vitin 2020, gjendja rreth zbatimit të rekomandimeve ishte pothuajse identike. Përderisa niveli i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në Raportin Vjetor të Auditorit për RVF-BRK për vitin 2021 përkundër që ka shënuar një rritje krahasuar me vitin 2020 ende vazhdon të mbetet i ulët. Nga 36 rekomandimet e dhëna në RVA-në 2021, prej tyre 5 janë zbatuar, 3 ishin në proces të zbatimit, 21 nuk ishin zbatuar dhe 7 nuk aplikohen më.

Kapitulli - I

AUDITIMI I RAPORTIT VJETOR FINANCIAR I BUXHETIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2022

1. Opinioni i auditimit

ZKA-ja ka audituar RVF-të e BRK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022, i cili përfshinë Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, Pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me realizimin, Pasqyrën e konsoliduar në para të gatshme dhe bilancin e fondeve, shënimet shpjeguese dhe anekset.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të kualifikuar, Raporti Vjetor Financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës paraqet pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme) dhe Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshime dhe plotësime).

Baza për opinionin e kualifikuar

- **Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve** – Përkundër përmirësimeve nga vitet paraprake edhe gjatë vitit 2022, janë identifikuar 10,396,792€ pagesa të klasifikuara në kategori jo adekuate të shpenzimeve, prej tyre 5,631,136€ ishin si rezultat i buxhetimit jo adekuat 3,761,007€ ishin si rezultat i vendimeve gjyqësore dhe 1,004,649€ ishin të ndikuara nga vetë OB-të. Kategoria më e ndikuar nga klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ishte investimet kapitale me 8,580,748€ ndërsa 1,816,044€ ishin në kategoritë tjera.

- **Pagesat e punonjësve bazuar në marrëveshjen e Brukselit** - Gjatë vitit 2022, Qeveria kishte realizuar pagesa në vlerë prej 792,955€ (të komunitetit serb të angazhuar me Marrëveshjen e Brukselit) të cilët nuk evidentohen për vijueshmëri në punë dhe nuk zhvillojnë aktivitete në kuadër të Ministrive përkatëse.

- **Pasuritë** - Në fund të vitit 2022 totali i pasurive neto ishte 9,357,170,485€. Sipas auditimeve individuale është identifikuar nënvlerësim i pasurive prej 55,865,029€ në raport me vlerën e prezantuar në RVF-BRK-së. Problemet më të mëdha të cilat e kanë përcjellur këtë kategori ishin: regjistrimi jo i plotë i pasurive, regjistrimi i pasurive finale si investime në vijim përkundër pranimit teknik, dhe aplikimi jo i duhur i normave të zhvlerësimit.

- **LLogaritë e arkëtueshme** - Shuma e borxheve të qytetarëve dhe bizneseve ndaj shtetit është 840,946,133€. Pjesa më e madhe e këtyre borxheve të pambledhura prej 607,974,066€ ishin nga niveli qendor dhe 232,972,067€ nga niveli lokal. Sipas auditimeve individuale është identifikuar nënvlerësim i llogarive të arkëtueshme prej 1,887,506€ në raport me vlerën e prezantuar në RVF-BRK.

- **Detyrimet e papaguara** - Detyrimet financiare të papaguara të organizatave buxhetore ndaj furnizuesve dhe operatorëve tjerë ekonomik në fund të vitit 2022 ishin 149,734,697€. Pjesa më e madhe e tyre prej 129,448,861€ ishte në nivelin qendror dhe 20,285,836€ në nivelin lokal. Sipas auditimeve individuale është identifikuar nënvlerësim i detyrimeve të papaguara prej 130,775€ në raport me vlerën e prezantuar në RVF-BRK.

- **Detyrimet kontingjente** Përveç detyrimeve financiare, ekzistojnë edhe detyrime kontingjente/potenciale, të cilat janë rezultat i pretendimeve përmes padive gjyqësore ndaj organizatave buxhetore dhe pritet të marrin epilogun gjyqësor në një të ardhme. Shuma e mundshme e vlerësuar është 347,003,930€ (197,233,674€ në nivel qendror dhe 149,770,256€ në nivel lokal). Sipas auditimit është identifikuar mbivlerësim i detyrimeve kontigjente për 16,086,386€.

Përshkrim më i detajuar i çështjeve të përmendura te Baza për Opinion gjenden në kapitujt përkatës të këtij raporti.

Theksim i Çështjes

Për vitin 2022, Zyra Kombëtare e Auditimit nuk ka kryer auditim në komunën e Mitrovicës Veriore, Zubin Potokut, Leposaviqit dhe të Zveqanit. Përkundër që, ZKA ka dërguar letërangazhim për fillimin e auditimit, si rezultat i mos prezencës së zyrtarëve komunal, pamundësisë që të sigurohen kushtet dhe dokumentacioni i duhur për auditim, si dhe mos përgatitjes së PFV- ve nga këto komuna. Opinioni i auditimit nuk është modifikura për këtë çështje.

Rekomandime për Qeverinë

- Përmes MFPT-së të siguroj se janë përmbushur kërkesat për raportim të plotë dhe të saktë në pasqyrat e shpalosjeve (anekseve); dhe

- Përmes ministrive përkatëse duhet të siguroj veprimet të mëtejshme për angazhimin e të gjithë të punësuarëve duke siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë, si dhe monitorim të vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.

2. Korniza ligjore, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Korniza ligjore

Roli i Auditorit të Përgjithshëm është që të ofrojë një bazë për mbylljen e procesit të llogaridhënies në mes të Kuvendit dhe Qeverisë për realizimin e buxhetit shtetëror gjatë vitit. Kjo arrihet duke zbatuar parimet e llogaridhënies menaxheriale në të gjitha nivelet e qeverisjes, përfshirë ministritë, komunat, institucionet e pavarura dhe ndërmarrjet publike.
Auditori i Përgjithshëm, bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor, një herë në vit kryen auditimin e Raportit Vjetor Financiar të Qeverisë për ekzekutimin e buxhetit të Republikës së Kosovës.

Auditimi i Raportit Vjetor Financiar të Qeverisë 2022 bazohet në dokumentet në vijim:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 137 dhe 138);
- Ligji nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (nenet 6 dhe 18);
- Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar (neni 47 dhe 48);
- Plani Vjetor i Auditimit për sezonin audites 2022/2023;
- Doracaku për Auditime Financiare dhe të Pajtueshmërisë;
- Udhëzues për kontrollin e cilësisë;
- Rregullorja e MF. nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore; dhe
- Korniza INTOSAI për Deklaratat Profesionale, përkatësisht, Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është planifikuar dhe kryer bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, në mënyrë që të arrihet siguri e arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale dhe se aktivitetet qeveritare, transaksionet financiare dhe informatat e prezantuara janë në pajtim me ligjet, rregulloret dhe aktet tjera. Në fazën përgatitore janë identifikuar dhe vlerësuar rreziqet, mjedisi i kontrollit, si dhe kontrollet e brendshme.

Baza e kontabilitetit dhe raportimit financiar të buxhetit të Kosovës sipas LMFPP është baza e parasë së gatshme. Menaxhimi i parasë së gatshme është i organizuar në formën e llogarisë së vetme të Thesarit. Llogaria e vetme e Thesarit është sistem llogarish bankare që shfrytëzohet për mbledhjen e të hyrave dhe realizimin e shpenzimeve, të cilat i menaxhon dhe kontrollon Thesari. Organizatat buxhetore kanë të deleguara përgjegjësit për mbledhjen e të hyrave dhe realizimin e shpenzimeve. Po ashtu, bazuar në rregulloren MF Nr. 01/2017 janë të detyruara që të mbajnë edhe regjistra kontabël të veçantë në bazë të të cilëve përgatisin pasqyrat e tyre financiare dhe raportojnë në MFPT/Thesar.

Raporti vjetor financiar për buxhetin e shtetit, përbëhet nga tri pasqyrat kryesore së bashku me shënimet sqaruese si dhe anekset tjera, të cilat përgatiten nga Thesari, bazuar në shënimet e SIMFK-së.

Gjatë konsolitimit të RVF-BRK-së shënimet për anekset si në vijim: ankesi nr.8 pasuritë me vlerë nën 1,000€, aneksi 9 stoqet, aneksi 10 të arkëtueshmet, aneksi 12 faturat e papaguara, aneksi 13 detyrimet kontingjente, aneksi 17 numri i të punësuarve jashtë listës se pagave dhe aneksi 18 numri

i të punësuarve me kontratë për shërbime, bazohen në shënimet nga pasqyrat financiare individuale të Organizatave Buxhetore.

Raporti Vjetor i Auditimit i dorëzohet Qeverisë dhe Kuvendit. Ndërsa, raportet e auditimeve individuale i'u dërgohen Kuvendit të Kosovës, Kuvendeve Komunale, bordeve të drejtorëve dhe menaxhmentit të subjekteve të audituara.

Rishikimet tona analitike kanë rezultuar se asnjë nga 86[3] organizata buxhetore nuk kishin mospërputhje me kërkesat e Rregullores Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, sa i përket formatit, strukturës dhe afateve të raportimit.
Nga 90 OB të planifikuara për auditim 2022 prej tyre 86 kanë kishin dorëzuar pasqyrat financiare brenda afatit ligjor, deri më 31 janar 2022, përderisa 4[4] komunat veriore nuk kishin dorëzuar PFV e tyre.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve/Thesari është përgjegjëse që në emër të Qeverisë të përgatisë dhe të prezantojë në mënyrë të drejtë Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, si dhe është përgjegjëse për aplikimin e kontrolleve të brendshme.

Ud i Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit, me 23 mars 2022 i ka dorëzuar Qeverisë për aprovim, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2022 brenda afatit dhe në formatin e kërkuar me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP me ndryshime dhe plotësime) si dhe në pajtim me SNKSP-të. Keto pasqyra janë korigjuar me datë 27 korrik 2023.

Zyra Kombëtare e Auditimit është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë (financiar dhe të pajtueshmërisë) që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e RVF-ve të Qeverisë. Auditimi është fokusuar në tri pasqyrat kryesore dhe në shënimet shpjeguese/shpalosjet:

- Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme;
- Pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me realizimin;
- Pasqyrën e konsoliduar të pasurive financiare dhe bilancet e fondeve; dhe
- Plotësinë dhe cilësinë e informatave në shënimet shpjeguese/shpalosjet e pasqyrave financiare.

Objektivë e auditimit ishte që të ofrojmë siguri të arsyeshme:

- Nëse RVF-BRK, paraqet në të gjitha aspektet materiale, një pamje të drejtë dhe të vërtetë të gjendjes financiare për periudhën raportuese;
- Nëse RVF-BRK, paraqet një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe transaksioneve financiare për periudhën raportuese;
- Për efektivitetin e kontrolleve të brendshme të aplikuara gjatë përgatitjes së RVF-BRK-së; dhe
- Nëse Qeveria ka ndërmarrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit për vitin e kaluar dhe vitet e mëhershme.

[3] Në këtë numër nuk janë perfshirë, Zyra Kombëtare e Auditimit dhe Agjencia e Kosovës për Intelegjencë.
[4] Komuna e Mitrovicës Veriore, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveqan

Auditimi i RVF-ve të BRK-së për vitin 2022 është ndërmarrë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorin Publik (SNISA) dhe udhëzuesit e brendshëm të ZKA-së. Qasja jonë është bazuar në një kuptim të plotë të procesit përmes të cilit janë hartuar RVF-të dhe me zhvillimin e një strategjie të auditimit, e cila përqendrohet në adresimin e rreziqeve specifike për opinion, ndërkohë që ofron një nivel të pranueshëm të sigurisë për pasqyrat e marra si tërësi.

Qasja e përzgjedhur përfshinë edhe vlerësimin e rezultateve të dala nga auditimet për disa anekse të RVF-ve të cilat konsolidohen nga pasqyrat financiare individuale, si: pasuritë, detyrimet, llogaritë e arkëtueshme, gjendja e borxheve publike dhe anekset tjera.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim analitik të pasqyrave, vlerësimin e procesit të përgatitjes së pasqyrave, verifikimin e vlerës së llogarive në librin kryesor dhe përputhjen me vlerat e prezantuara në pasqyra financiare, vlerësimin e efektit të keqdeklarimeve të pakorrigjuara, nëse bilancet e llogarive janë materialisht të sakta dhe aty ku janë identifikuar gabime, janë bërë rregullime në pasqyrat financiare, konfirmimin se të gjitha pohimet e auditimit janë adresuar në mënyrë adekuate, rishikimin e kontrolleve të brendshme menaxheriale, sistemeve të kontabilitetit dhe një numër të konsiderueshëm testesh e procedurash, të cilat janë konsideruar si të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit.

Pjesët e mëposhtme të raportit ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve të auditimit, si rezultat i vëzhgimeve në çdo fushë të rishikimit. Gjetjet e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha gabimeve dhe dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat qeveritare që e kanë karakterizuar vitin 2022, por gjithsesi ofrojnë një nivel të arsyeshëm të sigurisë.

3. Deficiti buxhetor

Sipas nenit 46 të Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Finanacave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar, Ministri duhet t'i dorëzoj Qeverisë raportin përfundimtar mbi buxhetin, i cili përfshin një raport mbi të ardhurat dhe shpenzimet, në të cilin duhet të paraqiten të dhëna krahasimore mes viteve lidhur me respektimin e kufirit të deficitit[5], përfshirë: shkaqet e devijimeve dhe financimin e deficiteve, nëse ka të tillë, apo shkaqet e suficiteve buxhetore dhe investimin e atyre suficiteve, nëse ka të tillë.

Në bazë të nenit 22.A.1. të LMFPP nr. 04/L-194, përcaktohet se asnjë ligj për ndarjet buxhetore nuk duhet të përfshijë një deficit të përgjithshëm që kalon nivelin prej 2% të BPV-së të parashikuar.
Ndërsa, neni 22.A.3 përcakton se me qëllim të mbajtjes së borxhit total në masë të konsiderueshme nën kufirin e borxhit të përcaktuar në Ligjin për Borxhin Publik, për çdo vit të pestë fiskal, Kuvendi shqyrton dhe sipas nevojës mund të bëjë përshtatje në:

- Kufirin e deficitit në përputhje me kufirin e borxhit dhe me rritjen afatmesme të BPV-së të parashikuar në KASH-in më të fundit; dhe
- Procedurat e zbatimit dhe parametrat kyç që shërbejnë si bazë për kufirin e deficitit.

Si rezultat i ndikimit të pandemisë Covid-19 në disa nga parametrat makrofiskal, Qeveria ka marrë vendim nr.03/02 të datës 05.06.2020 për ndryshimin e përkohshëm për disa nga rregullat fiskale, të përcaktuara me Ligjin Nr.03/048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit i plotësuar dhe ndryshuar. Pika 1 dhe 2 e vendimit kërkon nga Kuvendi i Republikës se Kosovës të bëjë rritjen e përkohshme të kufirit të deficitit deri në 6,5%, dhe uljen e kufirit të bilancit të shfrytëzueshëm bankar deri në 3% e BPV-së.

Për mbulimin e rritjes së deficitit sipas propozimit, Ministria e Financave ka identifikuar burimet shtesë të financimit të deficitit, i cili do të financohet nga burimet e brendshme dhe të jashtme të financimit, përmes letrave me vlerë, kredive të jashtme si dhe granteve.

Neni 22.A.4. përcakton se kufiri i deficitit mund të përshtatet edhe më herët nëse një përshtatje e tillë synon stabilizimin e nivelit të parashikuar total të borxhit në masë të konsiderueshme nën kufirin e borxhit. Financimi i deficiteve buxhetore, sipas rregullave fiskale, bëhet nga fondet e huamarrjeve dhe të hyrat e njëhershme të AKP-së. Qeveria ka respektuar kërkesat e mësipërme dhe për qëllime të njëjta kishte planifikuar huamarrje prej 503,000,000€. Kjo shumë ishte planifikuar për të mbuluar shpenzimet të cilat ishin më të larta se të hyrat e planifikuara.

Ne analizuam përllogaritjen e deficitit, në Aneksin nr.1 të RVF të shpalosjes së të dhënave në tabelën e deficitit buxhetor për vitin 2022, dhe nuk kemi identifikuar mospërputhje.

[5] 22.B.3. Pavarësisht nga paragrafi 2. i nenit 12(22A), të këtij ligji, pjesëmarrja e komunave në kufirin e deficitit mbetet e pandryshuar në rast se kufiri i deficitit rritet përkohësisht në përputhje me paragrafin 1. të këtij neni, përveç nëse Kuvendi vendos të rrisë pjesëmarrjen individuale të një apo më tepër komunave deri në masën e plotë të paragrafit 2. të nenit 12(22A), të këtij ligji.

Tabela 1- Përllogaritja e deficitit buxhetor[6] për vitin 2022 (në '000 €)

	Buxheti fillestar 2022	Buxheti i rishikuar 2022	Realizimi 2022 sipas RVF
1. Te hyrat buxhetore	**2,365,000**	**2,430,494**	**2,493,528**
Te hyrat tatimore	2,162,000	2,230,400	2,284,077
Kthimet tatimore	(59,000)	(61,506)	(67,069)
Te hyrat jo tatimore	239,000	239,100	256,532
nga të cilat: Taksa koncesionare	17,000	17,000	18,404
nga të cilat: Renta minerare	30,150	30,200	29,857
Mbeshtetja buxhetore nga grantet	11,000	10,500	10,250
Grantet e percaktuara te donatoreve	12,000	12,000	9,738
2. Shpenzimet buxhetore	**2,748,000**	**2,898,000**	**2,539,615**
Paga dhe shtesa	671,000	671,000	652,641
Mallra dhe sherbime	373,000	373,000	333,374
Shpenzime komunale	31,000	31,000	25,950
Subvencione dhe transfere	895,000	1,045,000	1,064,068
Shpenzimet kapitale	704,000	704,000	419,253
nga të cilat: financim nga buxheti I rregullt	570,000	570,000	401,960
nga të cilat: shpenzime kapitale nga klauzola	113,000	113,000	17,293
nga të cilat: fondet e likuidimit nga AKP-ja	21,000	21,000	
Rezerva	21,000	21,000	
Pagesa e interesit	41,000	41,000	35,039
Grantet e percaktuara te donatoreve	12,000	12,000	9,290
3. Deficiti/suficiti i përgjiithshëm	**(383,000)**	**(467,506)**	**(46,087)**
4. Shpenzimet e përjashtuara nga rregulla fiskale	**139,000**	**134,000**	**60,004**
Shpenzimet nga të hyrat vetanake te bartura			42,711
Shpenzimet nga pranimet e dedikuara për AKP	5,000		
Fondet e likuidimit nga AKP-ja	21,000	21,000	
Shpenzimet e financuara nga klauzola e investimeve dhe AKP	113,000	113,000	17,293
5.Deficiti/suficiti i përgjithshëm sipas rregullës fiskale (5=4+3)	**(244,000)**	**(333,506)**	**13,917**
6. Deficiti/ suficiti i përgjithshëm në%	**(2.90)**	**(3.88)**	**0.16**
7. Bruto produkti vendor i parashikuar	**8,405,000**	**8,593,900**	**8,593,900**

Siç vërehet nga tabela më lartë, deficiti i përllogaritur i përgjithshëm sipas buxhetit fillestar ishte -244,000,000€ apo -2.90% e BPV-së të parashikuar, ndërsa deficiti i përllogaritur sipas buxhetit me rishikim ishte -333,506,000€ apo -3.88%. Nga auditimi vërehet se në fund të vitit sipas realizimit kishte suficit në vlerë prej 13,918,000€ apo 0.16% e BPV-së.

Kufiri i deficitit buxhetor ishte respektuar si me ligjin e buxhetit ashtu edhe me ligjin e buxhetit të rishikuar për vitin 2022. Po ashtu, në raport me vitin paraprak, realizimi i kufirit të deficitit buxhetor është ulur nga -0,64%, përderisa në vitin 2022 kemi suficit prej 0,16% të BPV-së, në të cilin kishte ndikuar inkasimi i të hyrave.

[6] Per qëllime te kalkulimit te deficitit buxhetor nuk përfshihen grantet, huamarrja dhe pranimet tjera

4. Borxhi shtetëror dhe garancitë shtetërore

Borxhi shtetëror përbëhet nga borxhi i brendshëm dhe ndërkombëtar. Borxhi i brendshëm nënkupton borxhin shtetëror të emetuar ose kontraktuar nga kreditor brenda vendit[7], ndërsa borxhi ndërkombëtar[8] nënkupton borxhin shtetëror të emetuar ose kontraktuar përmes marrëveshjes ndërkombëtare dhe/ose marrëveshjes financiare me kreditor që kanë selinë jashtë vendit.

Republika e Kosovës ka filluar të marrë borxhe ndërkombëtare nga viti 2009, ndërsa prej vitit 2012 ka filluar të marrë borxhe të brendshme përmes emetimit të letrave me vlerë.

Portofolio e borxhit shtetëror në fund të vitit 2022 përbëhet nga borxhi i brendshëm dhe borxhi ndërkombëtar, si dhe dy garanci shtetërore[9]. Deri më tani, Republika e Kosovës nuk ka borxh komunal dhe as garanci komunale të emetuara.

Në fund të vitit 2022 borxhi shtetëror arriti vlerën 1,753,200,000€ që krahasuar me vitin paraprak shënoi një rritje prej 70,310,000€ apo rreth 4.18%. Gjatë dy viteve të fundit borxhi shtetëror në raport me BPV-në kishte rënie, nga 21.92% në fund të vitit 2021 në 19.91% në fund të vitit 2022.

Sipas Ligjit për Borxhet Publike nr.03/L-175 është përcaktuar që në asnjë rast shuma e kryegjësë e papaguar e borxhit të përgjithshëm nuk duhet të tejkalojë 40% të BPV-së. Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) për vitin 2022 ka respektuar në tërësi limitin e lejuar ligjor për marrjen e borxheve publike.


Tabela 2- Borxhi i brendshëm dhe ndërkombëtar në tri vitet e fundit

Përshkrimi	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020
Borxhi ndërkombëtar	641,200,000	576,750,000	525,800,000
Borxhi i Brendshëm	1,112,000,000	1,106,140,000	961,900,000
Total Borxhi Shtetëror	**1,753,200,000**	**1,682,890,000**	**1,487,690,000**
Garancitë Shtetërore	29,610,000	30,630,000	31,650,000
Borxhi dhe Garancitë shtetërore (% e BPV-së)	19.91	21.92	22.44
BPV nga ASK	**8,954,870,000**	**7,816,580,000**	**6,771,600,000**

Borxhi shtetëror përbëhet 63% nga huamarrja e brendshme dhe 37% nga huamarrja e jashtme. Qeveria aktualisht ka garancione shtetërore në vlerë prej 29,610,000€[10].

[7] I nënshtrohet ligjeve të Republikës së Kosovës;
[8] I nënshtrohen ligjeve të një juridiksioni legal përveç atij të Republikës së Kosovës;
[9] Garancitë shtetërore, paraqesin detyrime të mundshme dhe ato bëhen borxhe faktike vetëm në rastet kur subjekti publik, dështon të paguaj obligimet kontraktuese të garantuara;
[10] Garancia aktuale për Trafikun Urban - Prishtinë është në vlerë prej 5.61 milion€ dhe Garancia për Linjën e Dytë Kreditore për Fondin e Sigurimit të Depozitave në Kosovë prej 24 milion€.

Grafikoni 1 - Borxhi i brendshëm dhe ndërkombëtar (në milion €)



Borxhi i brendshëm

Republika e Kosovës ka filluar marrjen e borxhit të brendshëm përmes emetimit të letrave me vlerë nga janari i vitit 2012, ky borxh paraqet katalizatorin kryesor në financimin e deficitit buxhetor.

Në fund të vitit 2022, borxhi i brendshëm është 1,112,000,000€, në raport me vitin paraprak ka shënuar rritje për 5,850,000€, si rezultat i emetimit të letrave me vlerë. Gjithashtu gjatë vitit 2022 janë emetuar 217,750,000€ për rifinancimin e maturimeve të letrave me vlerë të emetuara në vitet paraprake.

Tabela 3 - Borxhi i Brendshëm në tre vitet e fundit

Borxhi i Brendshëm (neto)	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020
Emetimet e Reja	5,850,000	144,250,000	169,950,000
Stoku i Borxhit të Brendshëm	1,112,000,000	1,106,140,000	961,900,000
Borxhi i Brendshëm (% e BPV)	**12.42%**	**15.07%**	**14.20%**

Letra me vlerë mbajnë bankat komerciale dhe Trusti Pensional si Participant Primar. Po ashtu, letra me vlerë mbajnë edhe investitorë të tjerë fizikë dhe juridikë (biznese dhe individë privat).

Tabela 4 - Mbajtësit e Letrave me Vlerë

Instrumenti	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020
Bankat Komerciale	279,510,000	327,390,000	272,480,000
Fondet Pensionale	550,270,000	490,470,000	450,120,000
Institucionet Publike	213,560,000	228,370,000	198,860,000
Kompanitë e Sigurimeve	45,910,000	41,420,000	33,800,000
Të tjerë	26,800,000	22,400,000	10,010,000
Total	**1,116,050,000**	**1,110,050,000**	**965,270,000**

Borxhi ndërkombëtar

Në fund të vitit 2022, borxhi ndërkombëtar ishte 641,200,000€ i cili ka shënuar rritje për 64,450,000€ apo 11.18% krahasuar me vitin paraprak. Tërheqjet në shumat më të larta janë realizuar nga Bashkimi Evropian (BE), Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim (ANZh), Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës (BZhKE) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh). Borxhi i jashtëm është huazuar me qëllim të financimit të projekteve në fushën e arsimit, bujqësisë, kadastrës, energjisë, shëndetësisë, ujit, trajtimit të ujërave të zeza, ngrohjes qendrore, sistemit bankar, rehabilitimit të rrugëve dhe hekurudhave si dhe mbështetjen e buxhetit.

Tabela 5 - Borxhi ndërkombëtar në tre vitet e fundit

Përshkrimi	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020
Totali i Borxhit ndërkombëtar	**641,200,000**	**576,750,000**	**525,800,000**
Qeveria Qendrore	564,190,000	532,300,000	479,500,000
Borxhi i Nën-huazuar	47,010,000	44,440,000	46,290,000
Borxhi i jashtëm (% e BPV-së)	7.46%	7.86%	7.76%
BPV nga ASK	**8,954,870,000**	**7,816,580,000**	**6,771,600,000**

Kreditorët kryesor të borxhit ndërkombëtar janë Banka Botërore përmes ANZH me pjesëmarrje 34%, Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZH) me pjesëmarrje 16% dhe Bashkimi Evropian (BE) me pjesëmarrje 16%.

Organizatat buxhetore për projekte të cilat financohen nga borxhi ndërkombëtar kanë tërheq fonde nga kreditë, deri në fund të vitit 2022 në vlerë 111,010,000€. Tërheqjet nga kreditë direkte ishin 97,660,000€, përderisa kompanitë publike kanë tërheq fonde nga kreditë e nën-huazuara nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve në vlerë 13,350,000€. Tërheqjet në shumat më të larta janë realizuar nga ANZH, Banka Evropiane për Investime (BEI) dhe BZHKE.

Gjatë vitit 2022 në Kuvend janë ratifikuar katër (4) kredi/marrëveshje financiare, kurse gjashtë (6) kredi nuk ishin ratifikuar.
Kontraktimi i marrëveshjeve të reja financiare në vitin 2022 është realizuar me qëllim të financimit të projekteve në sektorin e energjisë, hekurudhave, ngrohjes qendrore dhe sektorit publik.

Tabela 6 - Kreditë e ratifikuara në 2022 (milion Euro)

Kredia/Projekti	Kreditori	Data e Marrëveshjes	Valuta	Vlera	Tipi i huazimit	OB Zbatuese	Statusi
Programi - Nxitja dhe Levimi i Mundësive për Sigurinë e Ujit	ANZh	13.07.2021	EUR	25.10	Huazim Direkt	MMPHI	**E ratifikuar**
Projekti i Zhvillimit të Ujërave të Zeza në Mitrovicë	BERZh	10.12.2021	EUR	13.50	Huazim Direkt	MMPHI, Komuna e Mitrovicës, KRU Mitrovica	**E ratifikuar**
Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza në Mitrovicë	BEI	10.12.2021	EUR	19.80	Huazim Direkt	MMPHI, Komuna e Mitrovicës, KRU Mitrovica	**E ratifikuar**
Financimi i Politikave Zhvillimore për Financa Publike dhe Rritje të Qëndrueshme	ANZh	21.04.2022	EUR	50.60	Huazim Direkt	MFPT	**E ratifikuar**

Mangësi në shfrytëzimin e kredive të jashtme

Sipas aneksit 21.1 të PFV të BRK-së për shpalosjen e borxhit të jashtëm, për shtatë (7) projekte/kredi në vlerë totale prej 177,900,000€ të ratifikuara përgjatë viteve 2017 deri 2022, nuk janë tërhequr fare mjetet financiare.

Kreditë e ratifikuara të cilat nuk kishin disbursim të mjeteve deri në fund të 2022:

1. Projekti Trajtimi i ujërave të zeza në Prishtinë në vlerë 66,000,000€, kreditori NATIXIS, zbatuese e projektit është Ministria e Ekonomisë, viti i ratifikimit të marrëveshjes është 2017 (me afat realizimi dhjetor 2026);

2. Projekti i Zhvillimit të Ujërave të Zeza në Gjilan në vlerë 11,000,000€, kreditori BEI, zbatuese e projektit është ME/komuna e Gjilanit/KRU Hidromorava, viti i ratifikimit të marrëveshjes është 2020 (me afat realizimi mars 2026);

3. Projekti për Masat e Energjisë Efiçiente në komunat: Prishtinë, Gjakovë dhe Gjilan, kreditori KFW, zbatues të projektit janë komunat përkatëse, në vlerë 2,500,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes është 2016 (me afat realizimi 30 maj 2021);

4. Projekti Reagimi i Kosovës ndaj pandemisë COVID -19 për NVM-të, kreditori BEI, zbatues i projektit është MFPT/FKKG, në vlerë prej 40,000,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2021 (me afat të realizimit në janar 2024);

5. Projekti i Impianti i Ujërave të Zeza në Mitrovicë, kreditori BEI, zbatues i projektit është komuna e Mitrovicës, në vlerë prej 19,800,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2021 (me afat të realizimit në dhjetor 2026);

6. Projekti i Zhvillimit të Ujërave të Zeza në Mitrovicë, kreditori BERZH, zbatues i projektit është komuna e Mitrovicës, në vlerë prej 13,500,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2021 (me afat të realizimit në dhjetor 2026); dhe

7. Projekti Nxitja dhe Levimi i Mundësive për Sigurinë e Ujit, kreditori ANZH zbatues i projektit është MMPHI, në vlerë prej 25,100,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2022 (me afat të realizimit në nëntor 2025).

Kreditë e ratifikuara të cilat kishin vonesa në disbursimin e mjeteve deri në fund të 2022:

Për tetë (8) kreditë e ratifikuara gjatë viteve 2014 - 2020, në vlerë prej 174,930,000€ të cilat kishin afat përmbyllje gjatë viteve 2021 deri 2023, niveli i disbursimit deri në fund të 2022 ishte vetëm 74,530,000€.

1. Projekti i Zgjerimit të Magjistrales M2 Milloshevë-Mitrovicë, zbatues i projektit është MMPHI, në vlerë prej 18,630,000€ nga kreditori FOZHN, ku shuma e patërhequr për këtë kredi është 14,520,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2014 (me afat të realizimit dhjetor 2022);

2. Projekti për Magjistralen Prishtinë-Mitrovicë, zbatues i projektit është MMPHI, në vlerë 14,900,000€ nga kreditori FSZH, ku shuma e patërhequr për kredi është 9,940,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2014 (me afat të realizimit dhjetor 2022);

3. Projekti për Rehabilitimi i Rrugëve Rajonale, zbatues i projektit është MMPHI, në vlerë prej 29,000,000€ nga kreditori BERZH, ku shuma e patërhequr për këtë kredi është 23,120,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2016 (me afat të realizimit gusht 2023);

4. Projekti Financim shtesë për Projektin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, zbatues i projektit është MBPZHR, në vlerë prej 20,800,000€ nga kreditori ANZH, ku shuma e patërhequr për këtë kredi është 5,080,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2018 (me afat të realizimit dhjetor 2022);

5. Projekti për Patundshmëri dhe Infrastrukturë Gjeo-hapësinore, zbatues i projektit është ME, në vlerë prej 14,600,000€ nga kreditori ANZH, ku shuma e patërhequr për këtë kredi është 14,380,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2018 (me afat të realizimit gusht 2023);

6. Projekti për Konkurrueshmëri dhe Gatishmëri për Eksport, zbatues i projektit është MTI, në vlerë prej 14,300,000€ nga kreditori ANZH, ku shuma e patërhequr për këtë kredi është 11,520,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2018 (me afat të realizimit tetor 2023);

7. Projekti i Ekonomisë Digjitale të Kosovës, zbatues i projektit është ME, në vlerë prej 20,700,000€ nga kreditori ANZH, ku shuma e patërhequr për këtë kredi është 10,640,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2018 (me afat të realizimit qershor 2023): dhe

8. Projekti Rehabilitimi i Linjës së 10-të Hekurudhore, Segmenti Jugor Hani i Elezit-Kosovë, zbatues i projektit është MMPHI, INFRAKOS, në vlerë prej 42,000,000€ nga kreditori BEI, ku shuma e patërhequr për këtë kredi është 11,200,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2016 (me afat të realizimit dhjetor 2022).

Për projektet e lartpërmendura, organizatat zbatuese të projekteve përkatëse raportojnë çdo 3 muaj në MFPT, si dhe për të njëjtat, MFPT raporton çdo 6 muaj në Qeveri mbi rrjedhën e ecurisë së realizimit të këtyre projekteve. Ne kemi vërejtur se raportimet nga njësitë implementuese të projekteve janë formale dhe jo të mirëfillta, duke mos i listuar në mënyrë të detajuar shkaqet dhe pengesat që paraqiten në terren në realizmin e këtyre projekteve, që të pasqyrojnë veprimet konkrete në eliminimin e tyre.

Hyrja në marrëveshje të kredive dhe vonesat në tërheqjen e fondeve në dispozicion, është pasojë e planifikimit të dobët, procesit të shpronësimit dhe mungesës së kapaciteteve qeveritare për t'i shfrytëzuar në kohë dhe në mënyrë efektive fondet e huamarrjes. Si pasojë e këtyre mangësive, Qeveria në vazhdimësi është duke paguar tarifë të zotimit për këto kredi të pashfrytëzuara.

Mospërputhje e dinamikës kohore në mes alokimit të kredive dhe realizimit të projekteve, për 11 kreditë efektive që përfshijnë vitet e ratifikimit 2016-2021, që parashihen tarifa zotimi për mjetet e kredive të pa tërhequra nga huamarrësit, Qeveria në vitin 2022 ka paguar tarifa të zotimit në vlerë prej 337,327€. Përkundër që ka një rënie për 94,235€ nga viti paraprak këto tarifa akoma paguhen për shkak të vonesave në tërheqjen e fondeve.

Projekti Modernizimi i Sistemit të Edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit, zbatues i të cilit ishte MASHTI, në vlerë prej 4,900,000€ nga kreditori UniCredit (me afat të realizimit dhjetor 2017), nuk ishte raportuar në dy vitet e fundit tek Ministria e Financave nëse është bërë pranimi teknik i këtij projekti, përkundër që është bërë disbursimi i plotë i këtyre mjeteve. Vlen të theksohet se për këtë projekt shpenzimet e paguara të interesit janë 50,000€ në vit.

Garancitë shtetërore

Në fund të vitit 2022 portofolio e garancive shtetërore të Republikës e Kosovës përbehet nga dy garanci shtetërore të emetuara. Garancitë Shtetërore dhe Komunale trajtohen si borxh gjatë llogaritjes së treguesit Borxh/BPV.

Garancia e emetuar gjatë vitit 2016 në vlerë 10,000,000€, përmes së cilës Republika e Kosovës e garanton ndërmarrjen publike lokale Trafiku Urban për kredinë e huazuar nga BERZh. Deri në fund të vitit 2022 huamarrësi ka kthyer shumën e kredisë në vlerë 4,390,000€.

Në fund të vitit 2016, Republika e Kosovës ka emetuar garancinë tjetër shtetërore në shumën 24,000,000€, e cila i është vënë në dispozicion Fondit për Sigurimin e Depozitave të Kosovës për linjën e dytë kreditore të ofruar nga BERZh. Këto fonde nga linja kreditore e dytë janë në gjendje të disponueshme në rast se paraqitet nevoja për disbursim.

Tabela 7 - Gjendja e garancive shtetërore

Përshkrimi	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020
Garancitë Shtetërore	**29,610,000**	**30,630,000**	**31,650,000**
BERZh Garancia për Trafikun Urban-Prishtinë	5,610,000	6,630,000	7,650,000
BERZh Garancia për Linjën e Dytë Kreditore për FSDK	24,000,000	24,000,000	24,000,000
Garancitë Shtetërore (% BPV-së)	**0.33%**	**0.39%**	**0.47%**

Rekomandime për Qeverinë

- Qeveria duhet të siguroj që para se të merren vendimet për financimin e projekteve me huamarrje, se janë bërë analiza të hollësishme dhe përgatitjet e duhura lidhur me projektet, me qëllim të shfrytëzimit sa më efikas të këtyre fondeve; dhe

- Ngecjet apo dështimi në mos fillimin apo mos realizimin e projekteve, duhet të jenë subjekt i shqyrtimeve të vazhdueshme me organizatat zbatuese të projekteve përkatëse ku analizohen shkaqet dhe arsyet që pasqyrojnë ndërmarrjen e veprimeve konkrete në reduktimin/eliminimin e tyre në mënyrë që të njëjtat të realizohen dhe të rezultojnë me përfitime publike në dobi të qytetarëve.

Rekomandime për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve

- Bazuar në raportet tremujore të Thesarit, MFPT-ja në bashkëpunim me ministritë e linjës duhet t'i adresoj të gjitha sfidat e identifikuara, në zbatimin e projekteve që financohen nga huamarrjet. Në çfarëdo kohe dhe në të gjitha rastet kur vlerësohet e nevojshme, MFPT-ja duhet t'i sugjeroj Qeverisë masat e duhura për tejkalimin e këtyre sfidave; dhe

- Të ofroj udhëzime të qarta për organizatat buxhetore për përfshirjen e planeve të investimeve kapitale që do të financohen nga huamarrjet. MFPT duhet të filloj procedurat e negocimit vetëm nëse janë kryer të gjitha përgatitjet për fillimin e zbatimit të projektit dhe të ofroj siguri të mjaftueshme dhe të dokumentuar se realizimi i këtyre projekteve do të bëhet në kohën dhe mënyrën e duhur.

5. Analiza e buxhetit të shtetit

Të dhënat e prezantuara në Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës janë reflektim i projeksioneve fillestare dhe përfundimtare të buxhetit për vitin 2022, dhe si rrjedhojë e pranimeve dhe pagesave kundrejt ndarjeve përkatëse buxhetore. Gjatë vitit 2022 është bërë rishikim i buxhetit, për të vetmin ndryshim rritjen e buxhetit për programin e ringjalljes ekonomike në vlerë prej 150,500,000€.

Projeksionet fillestare për të hyrat/pranimet, sipas Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore nr.08/L-66 ishin në vlerë 2,905,000,000€, ndërkaq sipas buxhetit final të hyrat/pranimet ishin në vlerë 3,010,500,000€, apo 105,500,000€ më të larta se planifikimi fillestar i tyre. Pranimet për vitin 2022 ishin në vlerë prej 2,628,552,000€ apo 87% e buxhetit final. Krahasuar me realizimin e vitit 2021, pranimet janë rritur për 137,579,000€, apo rreth 6%.

Rritja me buxhet kishte ndodhur në këto burime të financimit: të hyrat tatimore me një rritje prej 65,500,000€, dhe financimi nga huamarrja me rritje prej 40,000,000€.

Projeksioni i buxhetit për të hyrat/pranimet ishte parë i nevojshëm nga Qeveria, dhe kjo për arsyet si në vijim:

Të hyrat indirekte kishin rritje prej 74,900,000€, si rezultat i rritjes së të hyrave nga TVSH dhe detyrimit doganor, që vinte si pasojë e rritjes së inflacionit në tremujorin e parë të vitit 2022, me një mesatare prej 8.2%. Brenda kësaj rritje tek të hyrat indirekte, të hyrat nga akciza me rishikim janë zvogëluar për 6,900,000€, për shkak të trendit të rënies së sasisë së importit të derivateve, si pasojë e rritjes së çmimeve të derivateve.

Të hyrat direkte ishin zvogëluar për 6,200,000€, dhe kryesisht tek të hyrat nga tatimi në të ardhurat personale, si rezultat i pritjes së miratimit të Ligjit për Pagën minimale në Kuvend, i cili pritej të kishte efekt negativ në të hyrat nga tatimi në të ardhurat personale. Ndërkaq, rimbursimet tatimore ishin zvogëluar me rishikim për 2,800,000€.

Rritja e buxhetit është planifikuar edhe te huamarrja, përkatësisht financimi i jashtëm me 40,000,000€, dhe kjo vinte si nevojë e financimit shtesë për shkak të shpenzimeve të planifikuara me rishikim të buxhetit në kuadër të Programit të Ringjalljes Ekonomike.

Lëvizjet buxhetore përmes Vendimeve të Qeverisë përgjatë vitit, kishin ndikuar në disa Organizata Buxhetore, ku në kategori të caktuara ekonomike dhe projekte kishte rritur buxhetin, kurse në disa të tjera e kishin zvogëluar atë. Rritja e buxhetit përmes vendimeve të Qeverisë, kishte ndodhur në kategoritë e pagave dhe mëditjeve, mallrave dhe shërbimeve, subvencioneve dhe transfereve ndërsa te kategoria e shpenzimeve kapitale kishte zvogëlim të buxhetit.

Përderisa buxheti fillestar për shpenzime ishte 2,915,500,000€ kurse buxheti final ishte në vlerë prej 3,158,870,000€ i cili ishte realizuar në vlerë 2,625,009,000€ apo 83% e buxhetit final. Krahasuar me vitin 2021 kemi rritje të shpenzimeve për 246,283,000€.

Informata më të plota mbi planifikimet fillestare dhe buxhetin final, janë prezantuar në tabelën në vijim.

Tabela 8 - Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të buxhetit me realizim (në '000€)

Nr.	Zërat Buxhetor	Realizimi	Sipas Ligjit të Buxhetit Final	Sipas Ligjit të Buxhetit Nr. 08/L-066 viti 2022
1	Tatimet direkte	413,829	392,600	399,000
2	Tatimet indirekte	1,870,248	1,870,800	1,763,000
3	Kthimet	-67,069	-61,500	-59,000
4	Të hyrat jo tatimore	256,532	239,100	239,000
5	Grantet dhe ndihmat	19,988	22,500	23,000
6	Financimi nga huamarrja	112,201	543,000	503,000
7	Pranimet tjera	22,823	37,000	37,000
Total pranimet		**2,628,552**	**3,010,500**	**2,905,000**
1	Paga dhe mëditje	652,641	683,206	671,000
2	Mallra dhe shërbime	333,374	397,840	373,000
3	Shpenzime komunale	25,950	30,430	31,000
4	Subvencione dhe Transfere	1,064,068	1,114,919	895,000
5	Shpenzimet kapitale	419,253	698,686	704,000
6	Rezerva	-	1,920	21,000
7	Interesi	35,039	41,000	41,000
8	Të tjera	94,684	190,870	179,500
Total pagesat		**2,625,009**	**3,158,870**	**2,915,500**
Rritja/zvogëlimi i bilancit bankar		**3,544**	**-148,370**	**-10,500**

Sipas nenit 4 pika 3 të Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 "Parashikimet dhe supozimet afatmesme fiskale, si dhe ndarjet për vitin fiskal 2022 me parashikimet për dy (2) vitet vijuese, përmblidhen për informim në tabelën 1. dhe 1.1 të bashkëngjitura në këtë ligj". Ndërsa sipas pikës 2 të po të njëjtit nen parashikimet dhe supozimet makro-fiskale për buxhetin bazohen në kornizën makro-fiskale.

Korniza afatmesme e shpenzimeve e publikuar në muajin maj 2022 ka paraparë projeksion të ri të të hyrave për vitin 2022. Në ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2022 nuk janë bashkangjitur tabelat që lidhen me parashikimet fiskale.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mos bashkëngjitjes së tabelave nga ana e MFPT dhe Qeverisë me rastin e dërgimit të ligjit në Kuvend.

Rekomandim për Qeverinë

Të sigurohet se ligji për ndarjet buxhetore dhe plotësim ndryshimet dërgohet në Kuvend së bashku me tabelat me ndryshim/plotësime për parashikimet fiskale.

5.1 Analiza e të hyrave / pranimeve sipas kategorive ekonomike

Të hyrat/pranimet ishin në vlerë prej 2,628,552,000€ apo 87% e buxhetit final. Tabela më poshtë ofron informata të detajuara për buxhetin fillestar, final dhe realizimin e të hyrave/pranimeve gjatë tri viteve të fundit.

Tabela 9 - Pranimet sipas burimit sipas RVF/BRK-së ('000 në €)

Pranimet	Buxheti fillestar	Buxheti final	Realizimi 2022	Realizimi 2021	Realizimi 2020
Tatimet direkte	399,000	392,600	413,829	342,165	267,247
Tatimet indirekte	1,763,000	1,837,800	1,870,248	1,664,685	1,272,735
Kthimet	-59,000	-61,500	-67,069	-58,912	-32,999
Të hyrat jo tatimore	239,000	239,100	256,532	236,116	181,201
Grantet dhe ndihmat	23,000	22,500	19,988	16,801	43,078
Financimi nga huamarrja	503,000	543,000	112,201	269,586	389,031
Pranimet tjera	37,000	37,000	22,823	20,533	86,355
Total	2,905,000	3,010,500	2,628,552	2,490,973	2,206,647

Tatimet direkte

Tatimet direkte përbëhen prej katër kategorive: tatimi në të ardhura të korporatave, tatimi në të ardhura personale, tatimi në pronë, si dhe tatime tjera. Realizimi i tatimeve direkte ishte në vlerë prej 413,829,000€ apo 105% e shumës së planifikuar me buxhet.

Burimi kryesor i tatimeve direkte ishte: tatimi në të ardhura personale me 215,560,097€ apo 52%; tatimi në të ardhura të korporatave me 159,942,370€ apo 39%; tatimi në pronë me 34,554,041€ apo 8%, dhe tatimet tjera me 3,772,930€ apo rreth 1%. Prej tyre, tatimi në të ardhura personale dhe tatimi në të ardhura nga korporatat ishte grumbulluar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), ndërsa tatimi në pronë nga Komunat. Krahasuar me vitin 2021, tatimet direkte kanë shënuar rritje për 21%, ndërsa 55% krahasuar me vitin 2020.

Realizimi i tatimit në pronë për vitin 2022, ishte më i ulët se në vitin paraprak për 1,704,000€. Në katër komuna, siç janë: Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Zveçani, Zubin Potoku nuk janë realizuar fare të hyra nga tatimi në pronë. Mos realizimi i të hyrave nga tatimi në pronë në këto komuna është një dukuri që vazhdon nga viti në vit, dhe kjo për arsye të mos zbatimit të ligjeve në fuqi dhe mos hartimit të rregulloreve të brendshme për taksat, tarifat dhe ngarkesat e qytetarëve për shërbimet e përfituara publike.

Tatimet indirekte

Burimet kryesore të tatimeve indirekte janë: tatimi në vlerën e shtuar, detyrimi doganor, akcizat dhe tatimet tjera indirekte. Realizimi për këtë kategori të të hyrave ishte 1,870,248,000€ apo 102% nga shuma e planifikuar me buxhet. Tatimi i mbledhur në vlerën e shtuar ishte 1,220,007,000€ apo 65% e realizimit total; akcizat 517,264,000€ apo 28%; taksat doganore 132,663,000€ apo 7%, dhe tatimet tjera indirekte prej 314,000€ apo 0.02%. Krahasuar me vitin 2021, tatimet indirekte kanë shënuar rritje për 205,563,000€ apo 12%, ndërsa krahasuar me vitin 2020, rritja është për 597,513,000€ apo 47%.

Kthimet tatimore

Kthimet tatimore ndodhin për shkak të shumave të paguara nga tatimpaguesit mbi shumën e detyrimit tatimor. Me rastin e barazimit të gjendjes së tatimeve me ATK-në dhe Doganën, përllogariten diferencat, dhe si të tilla u kthehen subjekteve të ndryshme ekonomike pas shqyrtimit të kërkesave për rimbursim.

Sipas buxhetit, shuma e kthimeve ishte planifikuar në vlerën prej 61,500,000€, ndërkaq shumat e kthyera deri në përfundim të vitit ishin për 67,068,807 ose 109% e planit apo rreth 3% e totalit të përgjithshëm të tatimeve të inkasuara. Vlera e kthimeve nga ATK ishte 64,671,039€, kurse 2,397,768€ janë kthimet nga Dogana.

Në krahasim me vitin 2021, kthimet e tatimeve ishin për 8,157,000€ më të larta apo për 14%, ndërsa në raport me vitin 2020 për 34,070,000€ apo për 103%.

Të hyrat jo tatimore

Në kategorinë e të hyrave jo tatimore bëjnë pjesë të gjitha llojet e taksave administrative dhe taksave tjera, llojet e ndryshme të gjobave, të hyrat nga inspeksioni, shfrytëzimi i pronës publike, tarifat e shërbimeve, licencat, qiratë për pronat publike, taksat koncesionare, rentat minerare, etj.

Të hyra jo tatimore mblidhen nga niveli qendror, niveli lokal, agjencitë e pavarura buxhetore dhe ndërmarrjet publike.

Të hyrat jo tatimore për vitin 2022 sipas Ligjit të Buxhetit ishin planifikuar në vlerë prej 239,100,000€. Prej tyre në nivelin qendror ishin planifikuar 142,100,000€, në nivelin lokal në vlerë 46,400,000€, renta minerare në vlerë 30,200,000€, taksa koncesionare në vlerë 17,000,000 si dhe të hyrat nga interesi 3,400,000€.

Shuma totale e realizimit të të hyrave jo tatimore gjatë vitit 2022 ishte 256,532,000€ apo 107% e planit. Prej tyre, 149,310,000€ ishte shuma e mbledhur nga niveli qendror, ndërsa nga niveli lokal, shuma prej 55,596,000€. Realizimi nga rentat minerare ishte 29,857,000€, nga taksa koncesionare 18,404,000€, si dhe të hyrat nga interesi i kredive për ndërmarrje publike 3,365,000€.

Nëse krahasojmë realizimin e këtyre të hyrave në relacion me buxhetin, atëherë në nivel qendror janë realizuar 105% e planit, kurse në nivel lokal 120% e planit. Ndërkaq, analizuar trendin e tri viteve të fundit, shihet se të hyrat jo tatimore kanë shënuar rritje për 20,425,000€ apo rreth 9% krahasuar me vitin 2021, dhe për 75,340,000€ apo rreth 42% në raport me vitin 2020.

Grantet dhe ndihmat

Grantet e Përcaktuara të Donatorëve janë fonde të cilat duhet të shfrytëzohen në pajtim me kushtet e marrëveshjeve në mes të Qeverisë dhe donatorëve. Këto fonde planifikohen me buxhet vjetor dhe janë pjesë e të hyrave të përgjithshme buxhetore për financimin e projekteve të ndryshme.

Shuma e granteve sipas Ligjit të Buxhetit fillestar nr.08/L-066 për ndarjet buxhetore për vitin 2022, duke përfshirë grantet për mbështetje buxhetore, ishte planifikuar në vlerë prej 22,500,000€. Vlera e njejtë ishte planifikuar edhe me buxhet përfundimtar, ndërsa realizimi ishte 19,988,000€ apo 89%. Në vitin 2021 vlera e realizuar ishte 16,801,000€, ndërsa në vitin 2020 ishte 43,078,000€.

Në fund të vitit 2022, fondet e pa shpenzuara nga donatorët arrijnë shumën prej 12,730,371€ (kjo vlerë paraqet fondet e pa shpenzuara të akumuluara ndër vite). Mos efikasiteti i shfrytëzimit të fondeve nga donatorët sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje, rritë rrezikun që grantet në të ardhmen të zvogëlohen.

Financimi nga huamarrja

Si burim për financimin e pagesave buxhetore, me Ligjin e Buxhetit Nr.08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2022, Qeveria kishte planifikuar që një pjesë të pagesave ta financojë nga huamarrjet.

Pranimet nga huamarrja me Ligjin Nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2022 ishin planifikuar në vlerë 503,000,000€. Ndërkaq, me buxhet final, shuma e financimit nga huamarrja ishte rritur në 543,000,000€ apo 8% më shumë se plani fillestar. Kjo për arsye të nevojës për rritje të financimit shtesë, me qëllim të ruajtjes së deficitit buxhetor, për shkak të projeksioneve për rritjen e shpenzimeve në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve, përkatësisht, në Programin për Ringjallje Ekonomike.

Huamarrja e jashtme ishte planifikuar në vlerë prej 423,400,000€, ndërsa janë realizuar 106,347,000€ apo 25% e planit. Kjo kishte ndodhur pasi për projekte të caktuara nuk është bërë ratifikimi i marrëveshjeve në Kuvend, dhe aranzhimi i huamarrjes është bërë para krijimit të kushteve të cilat sigurojnë implementimin e këtyre projekteve, sic janë studimet dhe analizat e duhura, zgjidhja e problemeve me shpronësim në mënyrë që fondet të shfrytëzohen në mënyrë sa më efikase.

Huamarrja e brendshme ishte planifikuar në vlerë prej 120,000,000€, ndërsa janë realizuar 5,854,000€ apo vetëm 5% e planit. Kjo për arsye të bilancit bankar pozitiv, ku si rezultat i ekzistencës së likuiditetit, nuk është bërë emetimi i letrave me vlerë.

Realizimi i huamarrjes në raport me vitin 2021 ishte për 157,385,000€ më i ulët, ndërsa në raport me vitin 2020, më i ulët për 276,830,000€.

Pranimet tjera

Pranimet tjera përbëhen nga financimi i njëhershëm AKP-së, kthimi i kredive nga ndërmarrjet publike, të hyrat e dedikuara dhe pranimet nga depozitat. Sipas Ligjit të Buxhetit Nr.08/L-066, pranimet tjera ishin planifikuar në vlerë prej 37,000,000€, ndërsa nuk kishte pasur rishikim të buxhetit në këtë kategori. Kjo vlerë përbëhej nga: kthimi i kredive nga ndërmarrjet publike në vlerë 11,400,000€ dhe të hyrat e dedikuara në vlerë prej 4,500,000€.

Realizimi i pranimeve tjera ishte në vlerë 22,823,000€, prej të cilave: kthimi i kredive nga ndërmarrjet publike 11,387,000€ apo 50% e planit, të hyrat e dedikuara në vlerë 5,888,000€ apo 26% e planit, dhe pranimet nga depozitat në vlerë 5,548,000€ apo 24% e planit.

5.2 Analiza e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike

Buxheti final për shpenzimet e përgjithshme ishte në vlerë 3,158,870,000€, ndersa realizimi ishte 2,625,009,000€ apo 83% e buxhetit. Nëse e krahasojmë me vitin 2021, pagesat janë rritur për 246,269,000€, ndërsa me vitin 2020 janë rritur për 290,066,000€.

Tabela 10 - Pasqyra e pagesave krahasuar me dy vitet e fundit ('000 në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	Realizimi 2022	Realizmi 2021	Realizimi 2020
Pagat dhe Shtesat	671,000	683,206	652,641	667,312	660,768
Mallrat dhe Shërbimet	373,000	397,840	333,374	302,410	276,995
Shërbimet Komunale	31,000	30,430	25,950	25,287	22,168
Subvencionet dhe Transferet	895,000	1,114,919	1,064,068	842,570	867,794
Investime kapitale	704,000	698,686	419,253	419,807	379,713
Shpenzimet e interesit	41,000	41,000	35,039	30,881	27,505
Rezervat	21,000	1,920			
Të tjera	179,500	190,870	94,684	90,473	100,000
Total	2,915,500	3,158,870	2,625,009	2,378,740	2,334,943

Në vijim janë paraqitur realizimi i shpenzimeve sipas kategorive si dhe krahasimet me vitet e kaluara.

Pagat dhe shtesat

Në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore prezantohen si një ndër kategoritë me përqindje të lartë të shpenzimeve me rreth 25%. Buxheti për vitin 2022 ishte 683,206,000€, ndërsa shpenzimet 652,641,000€ apo 95.5% e buxhetit. Krahasuar me vitin e kaluar ka një ulje të shpenzimeve për 15,483,000€ që ka ndodhur kryesisht për shkak të zvogëlimit të shtesave për të punësuarit nga pakoja e ringjalljes ekonomike.

Mallrat dhe shërbimet

Në strukturën e përgjithshme të shpenzimeve buxhetore marrin pjesë me rreth 13%. Buxheti për vitin 2022 ishte 397,840,000€, ndërsa shpenzimet 333,374€ apo rreth 84% e buxhetit. Krahasuar me vitin e kaluar ka një rritje të shpenzimeve për 27,135,000€. Në këtë rritje të shpenzimeve ka ndikuar blerja e librave dhe veprave artistike, blerjet për rezervën shtetërore, shpenzimet e qirasë, shpenzimet e karburanteve për vetura dhe gjenerator, shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit etj. Ndërsa pagesat me vendime të gjykatave kanë shënuar një rënije prej 4,400,000€ krahasuar me vitin e kaluar.

Zërat kryesor në këtë kategori të cilat përfshijnë pjesën më të madhe të shpenzimeve janë: shërbimet kontraktuese tjera me 61,000,000€, furnizimet mjekësore 51,555,000€, shpenzimet e karburantit 31,066,000€, blera e librave 17,634,000€, shpenzimet e qirasë 12,488,000€ etj.

Shërbimet komunale

Buxheti për vitin 2022 ishte 30,430,000€, ndërsa shpenzimet 25,950,000€ apo rreth 85% e buxhetit. Zërat të cilat e përfshijnë këtë kategori janë: shpenzimet e rrymës, ujit, mbeturinave, ngrohja qendrore dhe shpenzimet e telefonisë fikse.

Subvencionet dhe Transferet

Në strukturen e shpenzimeve të përgjithshme marrin pjesë me rreth 41% që njëherit prezanton kategorinë me përqindjen më të lartë të shpenzimeve. Buxheti për vitin 2022 ishte 1,114,919,000€, kurse shpenzimet ishin 1,064,068,000€ apo 95% e buxhetit. Rritja e shpenzimeve në këtë kategori në krahasim me vitin e kaluar ishte për 221,171,000€. Kjo rritje ka reflektuar në këto kode ekonomike: subvencione për entitetet publike dhe jo publike, pensionet bazë, subvencion për shtesat për fëmijë, subvencionimi i lehonave të papuna etj.

Zërat kryesor në këtë kategori të cilat përfshijnë pjesën më të madhe të shpenzimeve janë: subvencionet për entitetet publike me 233,109,000€, subvencionet për entitetet jopublike 98,269,000€, pensionet bazë me 209,849,000€, pensionet bazë kontribut dhënëse me 141,070,000€, pensionet për veteranet e luftës 81,110,000€ etj.

Pagesat për menaxhimin e pandemisë Covid-19, nga kjo kategori në total ishin 233,504,085€. Prej tyre, nga pakoja emergjente 44,542€, ndërsa nga pakoja për Rimëkëmbje Ekonomike 233,459,543€.

Investimet kapitale

Në strukturen e shpenzimeve të përgjithshme marrin pjesë me rreth 16%. Buxheti final për këtë kategori ishte 698,686,000€, kurse shpenzimet ishin 419,253,000€ apo 60% e buxhetit. Krahasuar me vitin e kaluar ka një ulje të shpenzimeve për 4,688,000€. Fondet buxhetore për investime kapitale janë të destinuara për financimin e projekteve në infrastrukturë, ndërtimin e autoudhëve, rrugëve lokale, në fushën e arsimit, shëndetësisë, objekteve kulturore dhe sportive, si dhe shërbimeve tjera publike.

Në këtë nivel të ulët të realizimit kanë ndikuar mos inicimi i kërkesave nga njësitë kërkuese të organizatave apo tejzgjatja e procedurave të prokurimit për shkak të ankesave nga operatorët në OSHP. Po ashtu, një pjesë e kontratave për punë janë ndërprerë për shkak të mos realizimit të punimeve nga operatorët ekonomik dhe mos zgjidhja e problemeve shpronësore mbetet një sfidë nga viti në vit si shkak i të cilës tejzgjaten punimet e kontraktuara.

Realizimi më i ulët i projekteve kapitale vërehet te këto organizata buxhetore: Ministria e Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës 55%, Ministria e Ekonomisë 38%, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë 16%, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve 38% (nuk janë përfshirë kontingjencat për transfere kapitale), Komuna e Prishtinës 28%, dhe Komuna e Fushë Kosovës 26% etj.

Shpenzimet e interesit dhe pagesat tjera

Për këto kategori janë buxhetuar gjithsej 231,870,000€ ndërsa janë realizuar shpenzime në vlerë 129,723,000€. Këto shpenzime kanë të bëjnë me shpenzimet e interesit, pagesat për kthimin e borxhit dhe nën huazimeve dhe kthimi i depozitave.

Rekomandim për Qeverinë

Të sigurojë që planifikimi i projekteve kapitale i nënshtrohet një analize të kapaciteteve të organizatës për menaxhimin e projekteve në përputhje me planet fillestare. Kontrollet në planifikimin e projekteve dhe realizimin e buxhetit duhet të forcohen me qëllim të realizimit të projekteve me kohë dhe arritjes së objektivave. Një harmonizim i rrjedhës së parasë me planifikimin e projekteve është i domosdoshëm për të adresuar nivelet e ulëta të realizimit financiar të projekteve kapitale.

5.2.1 Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Sipas Rregullës financiare nr. 01/2013-Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Gjatë vitit 2022, në 35 organizata buxhetore janë identifikuar klasifikime jo adekuate të shpenzimeve në vlerë prej 10,396,762€, prej tyre 8,514,156€ apo 82% te niveli lokal (23 komuna) dhe 1,882,636€ apo 18% te niveli qendror (12 OB).

Në raport me vitin paraprak, vlera e shpenzimeve të klasifikuara në kategori jo adekuate është zvogëluar për 2,754,131€ apo rreth 27% (në vitin 2021 vlera e tyre ishte 13,150,923€). Zvogëlimi më i theksuar është te pagesat e bëra nga buxhetimi jo adekuat i shpenzimeve.

Tabela në vijim tregon klasifikime jo adekuate të shpenzimeve të bëra në kategori të ndryshme ekonomike.

Tabela 11 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve në kategori ekonomike

Kategoria e gabuar	Kategoria e duhur	E ndikuar nga OB	E planifikuar gabimisht	Me vendime gjyqësore	Gjithsej
Mallrat dhe shërbimet	Pagat dhe mëditjet	83,231	39,437	478,734	601,402
	Subvencionet dhe transferet	121,007	115,557	49,309	285,873
	Investimet kapitale	222,552	174,593	111,221	508,366
Gjithsej Mallrat dhe shërbimet		426,790	329,587	639,264	1,395,641
Subvencionet dhe transferet	Pagat dhe mëditjet	0	0	338,613	338,613
	Mallrat dhe shërbimet	0	0	0	0
	Investimet kapitale	0	81,790	0	81,790
Gjithsej Subvencionet dhe transferet		0	81,790	338,613	420,403
Investimet kapitale	Pagat dhe mëditjet	200,000	0	1,740,035	1,940,035
	Mallrat dhe shërbimet	247,657	5,158,601	863,200	6,269,458
	Subvencionet dhe transferet	130,202	61,158	179,895	371,255
Gjithsej Investimet kapitale		577,859	5,219,759	2,783,130	8,580,748
Gjithsej keqklasifikimi për vitin 2022		**1,004,649**	**5,631,136**	**3,761,007**	**10,396,792**

Siç vërehet në tabelën e mësipërme kategoria më e ndikuar është ajo e investimeve kapitale me 8,580,748€ apo 83% në raport me totalin, pastaj mallrat dhe shërbimet me 1,395,641€ apo 13% dhe subvencionet dhe transferet me 420,403€ apo 4%.

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ishte ndikuar kryesisht nga buxhetimi jo i duhur me 5,631,136€ apo 54%, pastaj nga pagesat e realizuara nga Thesari përmes vendimeve gjyqësore me 3,761,007€ apo 36% si dhe nga shpenzimet e bëra nga vetë organizatat buxhetore në kategori ekonomike të gabuara me 1,004,649€ apo 10%.

Nëse analizohen klasifikimi jo adekuat nga aspekti i mbi/nënvlerësimit nëpër kategori ekonomike, gjendja është paraqitur si në vijim:

Tabela 12 - Mbi/nënvlerësimi i kategorive ekonomike

Kategoria ekonomike	Paga dhe Shtesa	Mallra dhe Shërbime	Subvencione dhe Transfere	Investime Kapitale
Mbivlerësimi	0	1,395,641	420,403	8,580,748
Nënvlerësimi	2,880,050	6,269,458	657,128	590,156

Nëse krahasojmë informatat e mësipërme atëherë vërejmë se kategoria më e mbivlerësuar është ajo e investimeve kapitale, përderisa kategoria më e nënvlerësuar është e mallrave dhe shërbimeve.

Në vijim janë paraqitur OB-të të cilat kanë vlerën më të lartë të klasifikimeve jo adekuate të buxhetuara dhe me vendime gjyqësore.

Tabela 13 - Niveli qendror

Entiteti	Kategoria e gabuar	Kategoria e duhur	Vlera financiare	Natyra e shpenzimit
MASHT	Investimet kapitale	Mallrat dhe Shërbimet	1,100,887€	Shpenzimet për renovimin e sallës së amfiteatrit, blerje të veglave muzikore dhe inventar për shkollë, blerje të paisjeve për mbrojtjen e objekteve arsimore, etj.
MMPHI	Investimet kapitale	Mallrat dhe Shërbimet	190,027€	Furnizim me kontenjer.
MSH	Investimet kapitale	Mallrat dhe Shërbimet	90,040€	Furnizimi me frigorifer dhe shtretër mjekësor, blerja e pajisjeve laboratorike
MBPZHR	Investimet kapitale	Mallrat dhe Shërbimet	58,286€	Programi kombëtar për inventarizimin e tokave bujqësore, servisimi dhe kalibrimi i pajisjeve laboratorike.

Tabela 14 - Niveli lokal

Entiteti	Kategoria e gabuar	Kategoria e duhur	Vlera financiare	Natyra e shpenzimit
Komuna e Prishtinës	Investimet kapitale	Mallrat dhe Shërbimet	2,453,137€	Pagesat për mirëmbajtjen dhe gjelbërimin e hapsirave publike, sinjalizimet rrugore, pastrimi i lumenjëve,etj.
Komuna e Ferizajit	Investimet kapitale	Mallrat dhe Shërbimet	924,341€	Shtrimi i rrugëve me zhavor, mirëmbajtja e hapsirave dhe ndërtimi i parqeve, pajisje me pompa të ujit, etj.
Komuna e Gllogocit	Investimet kapitale	Pagat dhe Shtesat	702,915€	Pagesa për vendime gjyqësore për kompensimin e pagave jubilare.
Komuna e Gjilanit	Investimet kapitale	Mallrat dhe Shërbimet	605,692€	Mirëmbajtja teknike e objekteve komunale, sanimi dhe mirëmbajtja e ndriqimit publik dhe mirëmbajtja verore e rrugëve ekzistuese.
Komuna e Podujevës	Investimet kapitale	Pagat dhe Shtesat	401,980€	Pagesë me vendime gjyqësore për kompensimin e pagave jubilare.

Rekomandim për Qeverinë

Përmes MFPT-së të siguroj kontrolle efektive në proceset e buxhetimit me qëllim që shpenzimet të jenë planifikuar në kategoritë ekonomike adekuate, sipas kërkesave të LMFPP-së dhe SNKSP-ve.

5.3 Analiza e shpenzimeve sipas funksionit

Shpenzimet sipas funksionit përfshijnë shërbimet publike, mbrojtjen, rendin dhe sigurinë publike, çështjet ekonomike, mbrojtjen e mjedisit, komoditetet e banimit dhe të bashkësisë, shëndetësinë, rekreacionin, kulturën dhe religjionin, arsimin, si dhe mbrojtjen sociale.

Tabela 15 - Pasqyra e pagesave sipas funksionit në tri viteve ('000 në €)

KF	Përshkrimi	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020
01	Shërbimet e përgjithshme publike	472,062	277,401	287,820
02	Mbrojta	48,822	91,802	59,653
03	Rendi dhe siguria publike	213,930	210,480	204,834
04	Çështjet ekonomike	409,042	358,492	462,356
05	Mbrojtja e mjedisit	7,880	9,491	14,780
06	Komoditetet e banimit dhe të bashkësisë	46,951	39,303	37,227
07	Shëndetësia	238,150	275,780	261,683
08	Rekreacioni, kultura dhe religjioni	54,068	60,712	51,790
09	Arsimi	346,711	340,335	313,146
10	Mbrojtja sociale	666,960	602,693	550,685
	Total[11]	2,504,576	2,266,488	2,243,974

Totali i shpenzimeve sipas funksionit ishin në vlerë prej 2,504,576,000€ e që në raport me vitin paraprak kanë shënuar një rritje prej 238,088,000€.

Shpenzimet sipas funksionit janë prezantuar bazuar në shënimet e SIMFK-së. Nga analiza e shpenzimeve vërehet se ka shpenzime të cilat nuk janë klasifikuar drejt sipas funksionit. Rasti më i theksuar është regjistrimi i shpenzimeve prej 88,955,010€ të cilat i takojnë mbrojtjes përderisa ishin të regjistruara gabimisht te shërbimet e përgjithshme publike.

Rekomandim për Qeverinë

Përmes MFPT të siguroj se planifikimi dhe realizimi i buxhetit bëhet sipas kodeve funksionale përkatëse në mënyrë që shpenzimet të paraqesin gjendjen e saktë të tyre sipas planit kontabël.

5.4 Analiza e pakos për rimëkëmbjen ekonomike

Shpenzimet për menaxhimin e pandemisë janë ndarë përmes Programit të Rimëkëmbjes/Ringjalljes Ekonomike dhe janë alokuar me kodet e dedikuar në planin Kontabël (00098 dhe 00099). Këto mjete janë ndarë me vendime të Qeverisë, sipas autorizimeve të ligjit të buxhetit për vitin 2022 me qëllim të zbatimit të masave të parapara nga ky program.

Për këtë qëllim, në vitin 2022 ishin buxhetuar gjithsej mjete në vlerë 270,250,122€ ndërsa ishin shpenzuar 258,432,932€ apo rreth 96% e mjeteve të buxhetuara.

Tabela 16 – Totali i pagesave nga kodi 00098 dhe 00099

Përshkrimi	Buxheti 2022	Realizimi 2022	Realizimi 2021	Progresi
Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike (kodi 00098)	259,862,246	254,170,426	229,143,042	98%
Pakoja Emergjente (kodi 00099)	10,387,876	4,262,506	4,883,645	41%
Total	270,250,122	258,432,932	234,026,687	96%

Totali i këtyre shpenzimeve ishte 258,432,932€ apo 96% e buxhetit të planifikuar, të cilat në raport me vitin paraprak ishin rritur për 24,406,245€ apo rreth 10.5%. Në këtë rritje kishte ndikuar 'Pako e Rimëkëmbjes Ekonomike"(00098) me 25,027,384€ përderisa "Pako Emergjente"(00099) ishte zvogëluar për 621,139€.
Rreth 98% e mjeteve të shpenzuara në kuadër të "Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike" (00098) janë shpenzuar nga Niveli Qendror, ku pjesa më e madhe e shpenzimeve është realizuar si në vijim:

- Ministria e Ekonomisë ka shpenzuar 133,210,918€ nga këto mjete apo rreth 52% të shpenzimeve totale të realizuara nga ky program. Prej tyre, 79,210,918€ ishin shpenzuar për zbatim të masës 3.7 "Mbështetje për tejkalimin e krizës energjetike", përkatësisht për subvencionim të energjisë elektrike për konsumatorët fundor. Ndërsa, 54,000,000€ ishin shpenzuar për zbatim të masës 4.6 "Mbështetje e ndërmarrjeve publike", përkatësisht për mbulimin e konsumit të energjisë elektrike (humbjeve jo teknike) në pjesën veriore të

[11] Në total nuk përfshihen pagesat tjera: pagesa e borxhit, kredi dhënia për ndërmarrjet publike dhe kthimet nga fondet e depozitave

Kosovës për ndaljen e devijimeve dhe pagesën e borxhit të KOSTT ndaj sistemit interkonektiv evropian;

- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka shpenzuar 72,442,541€ apo rreth 29% të shpenzimeve të përgjithshme nga "Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike". Prej tyre, mjetet në vlerë 57,113,550€ apo rreth 79% e shpenzimeve kanë të bëjë për masën 3.6 "Mbështetja e likuiditetit familjar", ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve sipas masave përkatëse përfshinë subvencionimin e lehonave të papunësuara, shtesat për fëmijë, subvencionimi i faturave për energji elektrike, pagesa për punonjësit e sektorit publik, privat dhe të ndërmarrjeve publike, subvencionim për studentët etj;

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka shpenzuar 17,991,508€ apo rreth 7% të shpenzimeve të përgjithshme në kuadër të këtij programi. Mjetet janë shpenzuar me qëllim të zbatimit të masës 2.5 "Ringjallja e fshatit përmes bujqësisë dhe agro-turizimit"; dhe

- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka shpenzuar 15,925,670€ apo rreth 6% të shpenzimeve nga "Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike", që ka të bëjë me masën 2.1 "Subvencionim i kredive investive", masën 2.4 "Mbështetje e eksportit", si dhe masën 3.8 "Rritja e rezervave shtetërore".

Pjesa tjetër e mjeteve nga kjo pako janë shpenzuar me qëllim të mbështetjes së pagesave dhe shtesave të punonjësve shëndetësor, mbështetje të projekteve të caktuara kulturore, mbështetje për skemën e granteve për zanate etj.

Sa i përket nivelit lokal, shuma e mjeteve të shpenzuara nga "Pako e Rimëkëmbjes Ekonomike" ishte 4,494,219€ apo rreth 2% e shpenzimeve të përgjithshme nga ky program. Qëllimi i shpenzimit të mjeteve në përgjithësi ka të bëj me kompensimin e pagesave të stafit (në sektorin e shëndetësisë, mirëqenies sociale dhe sektorin e arsimit) sipas vendimeve të nivelit qendror.

Tabela 17 – Pagesat nga "Pakoja e Ringjalljes Ekonomike (kodi 00098) sipas kategorive ekonomike

Kategoria ekonomike	Buxheti 2022	Realizimi 2022	Realizimi 2021	Progresi
Paga dhe shtesa	10,854,674	10,822,922	22,750,147	100%
Mallra dhe shërbime	10,110,000	9,887,961	17,134,297	98%
Shërbime komunale			23,894	
Subvencione dhe transfere	238,897,572	233,459,543	189,234,704	98%
Total	259,862,246	254,170,426	229,143,042	98%

Rreth 92% e buxhetit të shpenzuar për "Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike" është realizuar nga kategoria "Subvencione dhe transfere" dhe shkalla e realizimit ishte 98% në këtë kategori. Pjesa tjetër e mjeteve të shpenzuara është bërë nga kategoria paga dhe meditje ku buxheti ishte realizuar 100% si dhe në kategorinë mallra dhe shërbime ku buxheti ishte realizuar 98%.

Shpenzimet për menaxhimin e pandemisë Covid-19 -Pakoja emergjente (00099), përkatësisht rreth 97% e tyre kanë të bëjnë me mjete të ndara dhe të shpenzuara për nevoja të Ministrisë së Shëndetësisë.

Tabela 18 – Pagesat për menaxhimin e pandemisë Covid-19 - Pakoja Emergjente (00099)) sipas kategorive ekonomike

Kategoria ekonomike	Buxheti 2022	Realizimi 2022	Realizimi 2021	Progresi
Paga dhe shtesa	270,537	188,727	68,740	70%
Mallra dhe shërbime	9,377,169	3,733,330	3,693,413	40%
Subvencione dhe transfere	50,000	44,542	695,812	89%
Investime kapitale	690,170	295,907	425,680	43%
Total	10,387,876	4,262,506	4,883,645	41%

6. Pasqyra e pasurive në para të gatshme dhe bilanceve të fondeve

Bilanci i parasë së gatshme në fund të vitit përfshinë shumat e pa shpenzuara të fondeve nga: paratë në llogarinë kryesore, fondi zhvillimor i mirëbesimit, paraja e gatshme transit, Kuota në Institucionet Ndërkombëtare Financiare (INF), llogaritë e Misioneve Diplomatike të Republikës së Kosovës, paratë e gatshme (arka) dhe avancet e hapura.

Fondet për qëllime specifike përbehen nga**:** Grantet e Përcaktuara të Donatorëve, të hyrat vetanake të bartura, fondi i mirëbesimit për zhvillim, të hyrat e dedikuara, të tjera (kryesisht lloje të ndryshme të depozitave) dhe Fondet e pa shpenzuara nga huamarrja gjatë vitit 2022 dhe të bartura në vitin 2023.

Qeveria i menaxhon fondet përmes përdorimit të Llogarisë së Vetme të Thesarit (LlVTh). Pjesa më madhe e llogarive mbahen në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK). Shuma totale e parasë së gatshme në llogarinë e buxhetit të Republikës së Kosovës më 31 dhjetor 2022 ishte 445,734,000.

Tabela 19 - Pasqyra e parasë së gatshme dhe bilanci i fondeve ('000 në €)

Llogaritë bankare të Buxhetit shtetëror	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020
Banka Qendrore e Kosovës	419,664	423,322	316,897
Kuotat në INF	8,210	3,734	1,741
Fondi zhvillimor i mirëbesimit	3,256	2,636	1,971
Paraja në transit	10,845	6,946	4,851
Para në llogaritë e Misioneve Diplomatike	2,527	2,068	1,751
Para të gatshme (arka)	1,233	3,484	2,744
A. Gjithsej: pasurit financiare ne PG	445,734	442,189	329,955
Bilanci i fondeve	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020
Garantët e përcaktuara të donatorëve	15,505	15,818	9,752
Të hyrat vetiake të bartura NQ	2,584	1,436	1,765
Të hyrat vetiake të bartura në NL	90,005	80,078	55,994
Fondi zhvillimor në mirëbesim	7,974	7,354	7,078
Të hyrat e dedikuara	2,285	467	52
Të hyrat tjera	24,807	19,812	15,894
Fondet e pa shpenzuara nga huamarrja	16,751	5,131	3,941
B. Fonde qëllime specifike	159,911	130,095	94,475
C. Të pashpërndara	285,824	312,094	235,480
Gjithsej fondet (B+C)	445,734	442,189	329,955

Bilanci i llogarive rrjedhëse të mbajtura në BQK është rritur në krahasim me vitin paraprak. Paraja e gatshme në fund të vitit 2022 është rritur për 3,545,000€ në krahasim me bilancin e vitit 2021.

Paraja e gatshme në Bankën Qendrore të Kosovës është 419,664,000€ apo 94% e totalit të parasë së gatshme.

Nga tabela më lartë shihet se bartja e të hyrave vetanake si të hyra të pa shpenzuara të nivelit lokal, po rritet nga viti në vit. Këtë vit krahasuar me vitin paraprak rritja ishte për 9,927,000€. Gjithashtu fondet e pashpenzuara nga huamarrja krahasuar me vitin paraprak kanë shënuar një rritje prej 11,620,000€.

7. Shënimet shpjeguese

7.1 Pasuritë jo financiare kapitale, jokapitale dhe stoqet

Rregullorja MF nr. 02/2013 mbi Menaxhimin e Pasurive në Organizata Buxhetore i obligon të gjitha organizatat të mbajnë regjistrat e pasurisë jo financiare që vazhdimisht të bëjnë ripërtëritjen ose azhurnimin e tyre, varësisht nga blerjet/përvetësimet e reja apo shqyrtimit sistematik të gjendjes së tyre të përdorimit. Pasuritë jo financiare sipas klasifikimit kontabël ndahen në:

- Pasuri kapitale që kanë afat të përdorimit më të gjatë se një vit, kanë vlerë financiare mbi 1,000€ dhe pronësia dhe kontrolli i përfitimeve mbetet te OB-ja;
- Pasuritë jo kapitale që kanë afat të përdorimit më shumë se një vit, kanë vlerë financiare më pak se 1,000€ dhe pronësia dhe kontrolli i përfitimeve mbetet te OB-ja; dhe
- Stoqet ose pajisjet rezervë dhe materiali për zyre.

Pasuritë jofinanciare kapitale dhe jo kapitale

Menaxhimi i pasurive bëhet përmes dy sistemeve të centralizuara: Regjistrit kontabël i SIMFK-së si sistem i integruar në kuadër të MFPT-së, ku evidentohen, mirëmbahen, vlerësohen dhe raportohen pasuritë kapitale që kanë vlerë mbi 1,000€, si dhe sistemi/aplikacionit “E - pasuria” që është një sistem i integruar në kuadër të MPB-së, ku të gjitha organizatat buxhetore duhet të evidentojnë, menaxhojnë dhe raportojnë për pasuritë jo kapitale nën 1,000€ dhe stoqet/pajisje rezervë dhe material zyre.

Rezultatet e auditimit tregojnë se shpalosjet mbi pasurit jo financiare në vitin 2022 nuk kanë ofruar siguri të mjaftueshme se organizatat buxhetore kanë kontrolle dhe monitorim të plotë mbi pasuritë dhe menaxhimin e tyre. Përveç kësaj, të dhënat e pasurive jo financiare në sistemet për menaxhimin e pasurive në SIMFK dhe e-pasuri, janë jo të plota. Praktika të njëjta të menaxhimit të pasurive janë duke vazhduar edhe më tutje si te institucionet e nivelit qendror ashtu edhe lokal, edhe pse vite më radhë janë dhënë rekomandime për përmirësimin e menaxhimit dhe shtimin e kontrolleve mbi pasuritë jo financiare.

Organizatat buxhetore, kanë raportuar vlera të ndryshme të pasurive në PFV-të individuale, shifra të cilat më pas janë konsoliduar në RVF. Me rastin e auditimit të pasqyrave individuale, janë vërejtur mospërputhje në mes shifrave të raportuara dhe vlerave të audituara.

Tabela 20 - Pasurit jofinanciare kapitale dhe jokapitale

Pasuritë	Institucionet	Vlera e pasurisë në RVF-BRK	Sipas Auditimit	Nënvlerësimet neto
Pasurië kapitale mbi 1,000€	Niveli Qendror	2,971,789,183	3,011,978,102	(40,188,919)
	Niveli Lokal	6,283,260,268	6,302,170,598	(18,910,330)
Pasuritë kapitale nën 1,000€	Niveli Qendror	35,975,101	36,201,877	(226,776)
	Niveli Lokal	21,722,392	21,735,002	(12,610)
Stoqet	NQ+NL	44,423,541	40,949,935	3,473,606
Total		9,357,170,485	9,413,035,514	(55,865,029)

Nga tabela e mësipërme vërejmë se pasuritë jo financiare në total ishin nënvlerësuar në vlerë prej 55,865,029€[12] (pasuritë mbi 1,000€ janë nënvlerësuar për 59,099,249€, pasuritë nën 1,000€ janë nënvlerësuar për 239,386€ si dhe stoqet janë mbivlerësuar për 3,473,606€). Edhe këtë vit sikurse edhe vitet paraprake gjendja e pasurisë është përcjellë me pasaktësi në raportimin e tyre (në vitin 2021 mbivlerësimi ishte 83,507,406€).

Vlen të theksohet se këtë vit në fushën e pasurive kishte edhe progres në korrigjimin e regjistrave të pasurisë siq ishte rasti i MMPHI-së e cila kishte korrigjuar gabimet në vlerë prej 71,801,641€ që kishin ndikuar në mbivlerësimin e tyre (pagesat e regjistruara ndër vite për mirëmbajtjen e rrugëve si pasuri). Po ashtu, edhe Ministria për Komunitet dhe Kthim kishte korrigjuar regjistrin e pasurisë duke i transferuar pasuritë në vlerë prej 21,415,168€ te përfituesit individual.

Niveli qendror

Nga auditimet individuale, ka rezultuar se disa organizata buxhetore nuk kanë përfshirë në regjistra pasuri të cilat i plotësojnë kriteret për tu konsideruar si pasuri, dhe si rezultat i kësaj, vlera neto e prezantuar në RVF-BRK është nënvlerësuar për 40,415,695€. Ministritë që kishin ndikim më të madh në këtë gabim ishte nënvlerësimi i pasurisë nga MMPHI për 53,022,764€, përderisa mbivlerësim më të lartë kishte ME për 10,000,000€ dhe MASHTI për 3,020,964€. Arsyet e këtyre diferencave të larta vijnë kryesisht nga shkaqet si në vijim:

- Mos regjistrimi i plotë i pasurive të cilat ishin në pronësi të organizatave buxhetore;
- Mbajtja e pasurive finale si investime në vijim përkundër pranimit teknik; dhe
- Aplikimi jo i duhur i normave të zhvlerësimit.

Gabimet e identifikuara apo mospërputhjet e gjendjes së pasurive kapitale dhe jo kapitale kanë rezultuar në mbivlerësimin/nënvlerësimin e pasurisë në 17 organizata të nivelit qendror (11 ministri dhe 6 Agjenci të Pavarura) ose 35% e institucioneve qendrore.

[12] Nënvleresime kapitale dhe jokapitale janë 78,064,670€ ndersa mbivleresimet janë 22,199,635€

Dobësi tjera në kontrolle dhe menaxhim të pasurive të cilat më së shpeshti janë hasur gjatë auditimeve individuale janë:

- Në 10 institucione nuk ishte kryer harmonizimi i të dhënave në mes raportit vjetor të inventarizimit dhe regjistrit të përgjithshëm të pasurisë përderisa në një rast nuk ishte kryer procesi i inventarizimit;
- Në 16 institucione nuk ishte përdorur sistemi e-pasuria; dhe
- Në 6 institucione kishte mangësi në regjistrimin e pasurive si investime në vijim.

Niveli lokal

Nga auditimet individuale, ka rezultuar se disa komuna nuk i kanë përfshirë në regjistrat e tyre një pjesë të pasurisë, dhe si rezultat i kësaj, vlera e pasurive e prezantuar në RVF-BRK është nënvlerësuar për 18,922,940€. Komunat që kishin ndikim më të madh në këtë gabim ishin komuna e Mitrovicës Jugore dhe Deçanit. Nënvlerësimi i pasurisë nga Komuna e Mitrovicës ishte për 12,161,440€ (sipas komisionit të vlerësimit nga Komuna), vlerë e cila nuk është prezantuar në regjistrat e pasurisë në SIMFK me çka rezultojnë si jo të plota. Po ashtu, disa nga pasuritë (toka dhe objektet të ndryshme), që ishin të listuara, por nuk janë vlerësuar nga Komuna, janë të shpalosura në PVF, por pa vlera, dhe të cilat mund të jenë me ndikim material. Ndërsa, nënvlerësimi i pasurisë te komuna e Deçanit ishte për 6,152,406€, që ka të bëjë kryesisht me ndërtimin e rrugëve dhe mirëmbajtjet investive.

Nga gjithsej 34 komunat e audituara, 15 prej tyre kanë mbivlerësuar /nënvlerësuar pasuritë e prezantuara, ose 44% e komunave të audituara nuk i kanë prezantuar saktë pasuritë kapitale dhe jo kapitale.

Dobësi tjera në kontrolle dhe menaxhim të cilat më së shpeshti janë hasur gjatë auditimit të pasurive tek komunat janë:

- Në 12 komuna kishte mangësi në zhvlerësimin e pasurive dhe mangësi në regjistrimin e pasurive si investime në vijim;
- Në 8 komuna kishte mangësi në inventarizimin e pasurisë (mos inventarizim i pasurive, inventarizim i pjesshëm dhe inventarizim me vonesë); dhe
- Në 6 komuna kishte mos harmonizim ndërmjet regjistrit të pasurive dhe raportit të inventarizimit dhe nuk ishte përdorë sistemi e-pasuria.

Stoqet për nivelin qendror dhe lokal

Stoqet ose pajisjet rezervë dhe materialet për zyre sipas RVF-BRK janë 44,423,541€, ndërsa sipas auditimeve individuale ishin 40,949,935€ me një mbivlerësim prej 3,473,606€. Ky mbivlerësim vjen si rezultat i raportimit të gabuar nga ShSKUK. Vlen të theksohet se në fund të vitit 2022, gjashtë komuna dhe një institucion i pavarur kanë raportuar stoqe me vlerë zero.

Rekomandimet për Qeverinë

- Qeveria përmes MFPT duhet të sigurojë trajnime të mjaftueshme për zyrtarët e pasurisë dhe ZKF-të lidhur me procesin e regjistrimit të pasurive dhe prezantimin e saktë të tyre në Pasqyra financiare individuale; dhe

- Qeveria përmes MPB-së duhet të sigurojë përdorimin e aplikacionit e-pasuria nga të gjitha organizatat buxhetore.

7.2 Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme (LLA) përfshijnë shumën e të drejtave të organizatave buxhetore kundër palëve për ofrimin e shërbimeve si rezultat i aktivitetit të tyre. Këto llogari burojnë nga shumat e faturuara e të pa arkëtuara nga të hyrat e organizatave.

Të arkëtueshmet paraqesin një zë të rëndësishëm për qëllime të menaxhimit financiar. OB-të janë të detyruara të mbajnë regjistra të cilët shërbejnë si bazë për raportimin financiar. Përderisa shënimet mbahen kryesisht në mënyrë manuale ato më pas konsolidohen si për nevoja të raportimit financiar të organizatave, edhe për pasqyrat e konsoliduara financiare.

Vlera e përgjithshme e prezantuar e llogarive të arkëtueshme në RVF-BRK ishte 840,946,133€ (nga këto 607,974,066€ të nivelit qendror dhe 232,972,067€ të nivelit lokal). Ndërsa, sipas auditimit vlera e llogarive të arkëtueshme është 842,833,639€, me një nënvlerësim prej 1,887,506€ (nënvlerësim për 2,096,414€ te niveli lokal dhe mbivlerësim për 208,908€ te niveli qendror).

Bazuar në RVF 2022 vlera e llogarive të arkëtueshme krahasuar me vitin paraprak ishte rritur për 62,897,519€, apo rreth 8%. Përderisa kishte një trend në rritje të këtyre llogarive, veprimet e ndërmarra për mbledhjen e tyre nuk ishin treguar mjaftueshëm efikas. Në anën tjetër, duhet theksuar faktin se vjetërsia e këtyre llogarive vështirëson gjasat për mbledhjen e tyre.

Tabela 21 - Përmbledhja e llogarive të arkëtueshme në tre vitet e fundit (në €)

Llogaritë e arkëtueshme	Sipas auditimit 2022	Sipas PFV të OB 2022	Sipas RVF -BRK			Krahasimi 2022-2021 në %
			2022	2021	2020	
Niveli qëndror	607,765,158	607,974,066	607,974,066	564,294,945	481,470,171	7.74%
Niveli lokal	235,068,481	232,972,067	232,972,067	213,753,696	213,018,462	8.99%
Total	842,833,639	840,946,133	840,946,133	778,048,640	694,488,633	8.08%

Llogaritë e arkëtueshme në nivelin qendror

Vlera e llogarive të arkëtueshme e prezantuar në RVF 2022 nga niveli qendror ishte 607,974,066€, përderisa sipas auditimit kjo vlerë ishte 607,765,158€ me një mbivlerësim prej 208,908€.

Vlerën e përgjithshme të llogarive të arkëtueshme rreth 97% e përbëjnë Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) në vlerë prej 525,307,512€, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe

Minerale (KPMM) në vlerë prej 36,842,200€ dhe Ministria e Punëve të Brendshme në vlerë prej 28,628,737€. Ndërsa krahasuar me vitin paraprak, llogaritë e arkëtueshme karakterizohen me një trend rritës rreth 8%.

Llogaritë e arkëtueshme në nivelin lokal

Vlera e llogarive të arkëtueshme të prezantuara në RVF 2022 për 34[13] komuna ishte 232,972,067€, përderisa sipas auditimit kjo vlerë ishte 235,068,481€, me një nënvlerësim për 2,096,414€.

Kjo diferencë është rezultat i prezantimit jo të drejtë të llogarive si dhe mangësive në mbajtjen e evidencave.

Llogaritë e arkëtueshme të nivelit lokal përbëhen në përgjithësi nga tatimi në pronë, taksat në biznes, taksat për shërbimet e mbeturinave, qiratë dhe tjera. Në totalin e LLA, komuna e Prishtinës merr pjesë me 30%, komuna e Pejës me 9%, komuna e Prizrenit me 8%, komuna e Ferizajt 7% etj. Ndërsa, krahasuar me vitin paraprak llogaritë e arkëtueshme karakterizohen me një trend rritës prej rreth 9%.

Në vijim janë të paraqitura komunat të cilat i kanë nënvlerësuar LlA në vlera më të larta (ndryshimet në mes të pasqyrave të konsoliduara dhe vlerës sipas auditimit):

- Komuna e Graçanicës për 1,418,765€ pasi ishin prezantuar vetëm shënimet e vitit 2022 duke mos përfshirë shënimet e akumuluara nga vitet e mëhershme; dhe
- Komuna e Ferizajit për 955,841€ e cila nuk kishte shpalosur shënimet e plota dhe mungesës së një baze me evidenca të sakta për LLA.

Në vijim janë të paraqitura komunat të cilat i kanë mbivlerësuar LlA në vlera më të larta (ndryshimet në mes të pasqyrave të konsoliduara dhe vlerës sipas auditimit):

- Komuna e Prishtinës për 152,231€ i ndikuar nga gabimet teknike dhe dyfishimit të shumave;
- Komuna e Gllogocit për 38,773€ për shkak të gabimeve gjatë ngarkesave në sistemin e menaxhimit të të hyrave; dhe
- Komuna e Vitisë për 32,761€ për shkak të mos azhurnimit të shënimeve në sistemin e tatimit në pronë pasi janë përfshirë edhe tre prona të cilat janë në pronësi të institucioneve të RK-së dhe janë të liruara nga tatimi në pronë,

Rekomandim për Qeverinë

Qeveria në koordinim me MFPT dhe MAPL duhet të rivlerësojë mekanizmat aktual për inkasimin e borxheve, strukturën e tyre, vjetërsinë si dhe gjasat për t'i inkasuar këto borxhe. Po ashtu, duhet siguroj raportimin dhe konsolidimin e plotë dhe të saktë të llogarive të arkëtueshme.

[13] Komunat Mitrovicë e Veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit nuk kanë raportuar llogari të arkëtueshme

7.3 Detyrimet e papaguara dhe kontingjente

Detyrimet e papaguara

Detyrimet e papaguara paraqesin faturat e pranuara për punët/shërbimet e përfunduara nga operatorët ekonomik, por të cilat nuk janë paguar. Për shkak të përdorimit të kontabilitetit në para të gatshme, gjendja e detyrimeve të papaguara vetëm mund të shpaloset në pasqyrat financiare, aq më tepër kur një qasje e tillë e mbledhjes së informatave jashtë SIMFK-së, lë hapësirë për gabime të mundshme në raportimin apo shpalosjen e tyre.

Ligji i buxhetit dhe rregullativa sekondare për shpenzimin e parasë publike, kufizon hyrjen e OB-ve në detyrime, meqë obligohen që porosinë e mallit/punëve (urdhërblerjen) ta bëjnë vetëm kur ka mjete në dispozicion. Por një gjë e tillë nuk respektohet çdo herë.

Detyrimet e papaguara sipas RVF-BRK janë 149,734,697€, ndërsa sipas auditimit janë 149,865,472€, si rezultat i kësaj kemi një nënvlerësim prej 130,775€. Krahasuar me vitin paraprak sipas RFV-2022 detyrimet janë zvogëluar për 41,098,513€, apo rreth 22%.
Shlyerja më e theksuar e detyrimeve ka ndodhur nga pagesat që janë bërë për shpronësimet e viteve të mëhershme në vlerë prej 13,313,645€ (pagesat më të larta ishin te Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në vlerë 12,008,026€), dhe nga vetë OB-të janë shlyer detyrime në vlerë prej 27,784,868€. Ky zvogëlimi ka ndodhur për faktin se Qeveria i kishte dhënë prioritet shlyerjes së obligimeve.

Tabela 22 - Detyrimet e papaguara në tri vitet e fundit

Detyrimet e papaguara	Sipas auditimit 2022	RFV-BRK 2022			Krahasimi 2022 - 2021/ në %
		2022	2021	2020	
Niveli qendror	129,155,623	129,448,861	160,143,779	325,769,202	-19%
Niveli lokal	20,709,849	20,285,836	30,689,431	34,085,635	-34%
Total	149,865,472	149,734,697	190,833,210	359,854,837	-22%

Detyrimet e papaguara të nivelit qendror

Sipas auditimit vlera e detyrimeve të papaguara në raport me RVF-BRK në nivelin qendror ishte mbivlerësuar për 293,228€.

Detyrimet e papaguara të nivelit lokal

Si rezultat i prezantimit të gabuar të detyrimeve në PFV individuale gabimet janë bartur edhe në totalin e detyrimeve të RVF-BRK-së. Sipas auditimit vlera e detyrimeve në raport me RVF-BRK në nivelin lokal ishte nënvlerësuar për 424,013€.

Komunat me detyrimet më të larta janë ajo e Gjilanit me 4,599,011€ apo 22% të borxheve të nivelit lokal si dhe Ferizaji me 3,102,831€ apo 15%.

Shpalosjet e pasakta të detyrimeve paraqesin një pasqyrë jo të drejtë të pozitës financiare të OB-ve dhe Qeverisë ku mund të rezultojnë me vendime joadekuate gjatë procesit të buxhetimit. Kontrollet

e dobëta me rastin e harmonizimit të të dhënave rrezikojnë identifikimin, raportimin e saktë dhe të plotë të detyrimeve duke vënë në pikëpyetje edhe kredibilitetin e pasqyrave.

Rekomandim për Qeverinë

MFPT duhet të vendos kontrolle përmes monitorimit të raporteve të detyrimeve të papaguara nga OB-të dhe aty ku vëren devijime nga afatet ligjore të ndërmerren masa.

Detyrimet kontingjente

Në pjesën e detyrimeve, shpalosen edhe detyrimet kontingjente të cilat paraqesin pretendime të ndryshme nga ana e paditësve, që kanë gjasa në të ardhmen të krijojnë detyrime për organizatat, varësisht prej vendimeve të gjykatës të cilat mund të jenë në favor të palëve paditëse. Këto kanë të bëjnë me kompensime për shpronësime, kompensim të borxhit, dëmit material, pagave dhe implikacioneve tjera financiare në lidhje me to.

Në RVF-BRK, detyrimet kontingjente për vitin 2022 janë gjithsej 347,003,930€, ndërsa sipas auditimit detyrimet kontingjente ishin në vlerë prej 330,917,544€. Bazuar në këto analiza rezulton se detyrimet kontingjente ishin të mbivlerësuara në total për 16,086,386€ mbivlerësimi total i detyrimeve kontingjente ishte 21,183,696€ kurse nënvlerësimi ishte 5,097,310€.

Në mbivlerësimin e kësaj kategorie kanë ndikuar gabimet në shpalosjen e tyre në PFV individuale si dhe mungesa e komunikimit të mirëfilltë në mes OB-ve dhe avokaturës së shtetit. Në raport me vitin paraprak sipas RFV-BRK kemi një rritje të këtyre detyrimeve prej 109,606,877€ apo rreth 46% Është shqetësues trendi i rritjes së këtyre detyrimeve dhe njëkohësisht pakujdesia dhe mos përkushtimi i duhur në raportimin e tyre.

Tabela 23 - Përmbledhje e detyrimeve kontingjente

Detyrimet kontingjnte	Sipas auditimit 2022	Sipas RFV-BRK-së 2022			Krahasimi 2022 - 2021/ në %
		2022	2021	2020	
Niveli qendror	194,228,186	197,233,674	180,476,478	165,869,909	9%
Niveli lokal	136,689,358	149,770,256	56,920,575	80,743,148	163%
Gjithsej	330,917,544	347,003,930	237,397,053	246,613,057	46%

Detyrimet kontingjente të nivelit qendror

Vlera e detyrimeve kontingjente të niveli qendror sipas RVF-BRK-së ishte 7,233,674€, ndërsa sipas auditimit 194,228,186€, me një mbivlerësim për 3,005,488€. Në vijim janë prezantuar institucionet të cilat kanë mbivlerësuar/nënvlerësuar detyrimet kontingjente në vlera më të larta:

- Ministria e Ekonomisë ka nënvlerësuar detyrimet kontingjente në vlerë prej 4,741,404€;
- Fondi i Sigurimit Shëndetësor, ka mbivlerësuar detyrimet kontingjente në vlerë prej 4,675,715€;

- Ministria e Punëve të Brendshme ka mbivlerësuar detyrimet kontingjente në vlerë prej 1,599,862€; dhe
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka mbivlerësuar detyrimet kontingjente në vlerë prej 1,422,109€.

Komunikimi jo efektiv në mes zyrtarëve përgjegjës të Ministrive dhe Avokaturës Shtetërore, gabimet në trajtimin e detyrimeve kontingjente si dhe kontrollet e dobëta rreth monitorimit mbarëvajtjes së lëndëve në procese gjyqësore ishin arsyet më të shpeshta të mbi apo nënvlerësimit të detyrimeve kontingjente.

Detyrimet kontingjente të nivelit lokal

Detyrimet kontingjente ndaj komunave janë të natyrave të ndryshme, duke filluar nga pretendimet për pagat jubilare e deri tek paditë për shpronësime. Vlera e detyrimeve kontingjente te niveli lokal sipas RVF-BRK-së ishte 149,770,256€, ndërsa sipas auditimit ishte 136,689,358€, me një mbivlerësim prej 13,080,898€.

Në vijim janë prezantuar komunat të cilat i kanë mbivlerësuar detyrimet kontingjente në vlera më të larta:

- Komuna e Prishtinës si pasojë e dyfishimeve i kishte mbivlerësuar detyrimet kontingjente për 11,847,843€. Kjo kishte ndodhur për shkak të veprimeve të ndryshme procedurale vit pas viti;
- Komuna e Graçanicës i kishte mbivlerësuar detyrimet kontingjente për 865,542€; dhe
- Komuna e Deçanit i kishte mbivlerësuar detyrimet kontingjente për 561,043€ si pasojë e mungesës së komunikimit brenda departamenteve të komunës.

Komunikimi jo efektiv mes sektorit të financave dhe përfaqësuesve ligjor të komunave, gabimet në trajtimin e detyrimeve kontingjente si dhe kontrollet e dobëta ishin arsyet më të shpeshta të mbivlerësimt të detyrimeve kontingjente te niveli lokal.

Shpalosja jo saktë e detyrimeve kontingjente ka ndikuar që të mos pasqyrohet gjendja e drejtë dhe e plotë. Kjo ka ndikuar që informacioni i shpalosur për këto detyrime të jetë çorientues për palët e interesit.

Rekomandim për Qeverinë

Që përmes Ministrisë së Drejtësisë (Avokaturës shtetërore) dhe në koordinim me zyret ligjore të organizatave buxhetore të verifikojë vlerën e saktë dhe të plotë të detyrimeve kontingjente në mënyrë që shpalosjet në RFV-të të jenë të sakta. Aty ku ekzistojnë mospërputhje të shënimeve, të identifikohen arsyet e këtyre gabimeve dhe të njëjtat të korigjohen.

7.4 Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore

Mbështetur në LMFPP, Neni 40, Pika 1, kur një gjykatë nxjerrë urdhër ose vendim me të cilin kërkohet nga një autoritet publik që të paguajë çfarëdo lloji të kompensimit monetar ndaj një personi, dhe urdhri ose vendimi nuk i nënshtrohet të drejtës së ankesës nga autoriteti publik ose autoriteti publik nuk e ka ushtruar këtë të drejtë me kohë, gjykata menjëherë i dërgon një kopje të urdhrit ose vendimit Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë përkatëse, për ekzekutimin e pagesës në fjalë.


Pagesat sipas vendimeve të gjykatave dhe vendimeve të përmbaruesve privat për vitin 2022 ishin në vlerë 46,349,349€. Në raport me vitin 2021, vlera e këtyre pagesave ka një rënie të lehtë prej 5,568,280€ apo 11%, mirëpo ende mbetet në nivel të lartë. Përderisa shkaktarët e kësaj gjendje janë pothuajse të njëjtë me vitet paraprake, mund të themi se trajtimi i këtyre shkaqeve nga përgjegjësit nuk ishte në nivelin e duhur.

Tabela 24 - Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore (në €uro)

Pagesat sipas kategorive	2022	2021	2020
Pagat dhe shtesa	16,075,491	19,998,545	73,976
Mallrat dhe shërbimet/komunalitë	5,142,784	10,697,725	12,881,930
Subvencione dhe transfere	1,274,649	1,237,288	259,151
Investimet kapitale	23,856,425	19,984,071	16,750,254
Total	46,349,349	51,917,629	29,965,311

Mos kryerja e detyrimeve me kohë nga ana e organizatave buxhetore, ka rezultuar me kosto shtesë për buxhetin e shtetit për shkak të kostove të procedurave gjyqësore (përmbarimore) dhe shpenzimeve të interesit. Këto kosto shtesë kanë dëmtuar buxhetet e këtyre OB-ve dhe rrjedhimisht edhe objektivat e parapara t'i realizonin me ato mjete. Marrë parasysh faktin se një pjesë të madhe të këtyre shpenzimeve e përbejnë investimet kapitale, rezulton që shumë projekte kanë mbetur pa u realizuar si rezultat i këtyre kostove.

Më poshtë, në mënyrë grafike, janë pasqyruar 12 organizata buxhetore tek të cilat janë ekzekutuar pagesa në vlera më të mëdha se 1milion€, e të cilat e përbëjnë mbi 81% të shumës së pagesave të kryera me vendime gjyqësore apo mbi 37 milion€.



Nga analiza e shpenzimeve të vendimeve gjyqësore në SIMFK dhe bazuar në auditimet individuale të OB-ve, është vërejtur se në shumicën e këtyre pagesave, Thesari nuk e ka bërë ndarjen e shpenzimeve të borxhit kryesor kundrejt shpenzimeve të procedurave përmbarimore gjyqësore, siç është e paraparë me planin kontabël.

Megjithatë, Thesari ka mbajtur evidenca tjera në lidhje me ndarjen e këtyre shpenzimeve jashtë SIMFK-së dhe bazuar në këto informata, vërehet se nga totali i pagesave me vendime gjyqësore/përmbarimore shpenzimet shtesë përtej borgjit kryesor ishin 7,467,532€, apo 16%.

Tabela 25 - Pagesat e vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore sipas nivelit të qeverisjes (në €)

Pagesat sipas kategorive	2022	2021	2020
Niveli qendror	9,887,292	20,010,276	15,324,361
Niveli lokal	36,462,057	31,907,353	14,640,950
Total	46,349,349	51,917,629	29,965,311

Pagesat e vendimeve gjyqësore të nivelit qendror

Pagesat për organizata të nivelit qendrorë ishin 9,887,292€, apo 21% e totalit të vendimeve gjyqësore. Pjesa më e madhe e këtyre vendimeve gjyqësore kryesisht kishin të bënin me pagesa të shpronësimeve si rezultat i ankesave të pronarëve që kanë qenë pjesë e procesit të shpronësimit dhe pjesa tjetër për kompensimin e punëtoreve për paga jubilare dhe përcjellëse të cilat ishin të parapara sipas kontratës kolektive por që nuk ishin buxhetuar nga kategoria e pagave.

Pagesat e vendimeve gjyqësore të nivelit lokal

Pagesat në nivelin lokal ishin në vlerë prej 36,462,057€ apo 79% e totalit të vendimeve gjyqësore. Pjesa më e madhe e këtyre vendimeve gjyqësore kryesisht kishin të bënin me kompensimin e punëtoreve për paga jubilare dhe përcjellëse të cilat ishin të parapara sipas kontratës kolektive por që nuk ishin buxhetuar nga kategoria e pagave dhe vonesa në pagesat e faturave nga ana e OB-ve për shkak të neglizhencës së zyrtarëve përgjegjës apo mungesës së mjeteve buxhetore.

Rekomandim për Qeverinë

Qeveria përmes institucioneve relevante të shqyrtoj obligimet dhe përgjegjësitë e OB-ve që burojnë nga marrëveshjet kolektive dhe të ndërmarrin veprimet përkatëse. Në varësi të këtyre obligimeve dhe mundësive buxhetore, të siguroj që organizatat buxhetore bëjnë planifikimin adekuat të buxhetit, në mënyrë që të shmangen shpenzime të panevojshme nga proceset eventuale gjyqësore. Po ashtu, përmes akterëve të përfshirë në procesin e shpronësimit të ndërmarrë masa në evitimin apo zgjidhjen e kontesteve të shumta gjyqësore.

Rekomandim për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve

Ministri në koordinim me drejtorin e Thesarit duhet të siguroj që gjatë ekzekutimit të pagesave bazuar në vendimet gjyqësore/përmbarimore, të bëhet ndarja e shpenzimeve shtesë të procedurave përmbarimore nga shuma e borxhit kryesor sipas kodeve ekonomike të parapara me planin kontabël.

7.5 Të dhënat e punësimit

Sipas Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2022, numri i planifikuar i të punësuarve për nivelin qendror dhe lokal ishte 87,311, përderisa numri i të punësuarve sipas RVF-BRK-së ishte prej 80,086. Bazuar nga të dhënat e sistemit të menaxhimit të pagave – Payrolli, vërehet se numri aktual i të punësuarëve në dhjetor 2022 ishte 82,277 apo 2,191 më shumë se numri i prezantuar në RVF-BRK.

Thesari në RVF-BRK kishte prezantuar vetëm numrin e të punësuarve sipas raportit të normave duke përjashtuar të punësuarit të cilët në listën e pagave për muajin dhjetor ishin me zero (stafi në pushim të lehonisë, pushim pa pagesë, rezervistët e FSK-së etj.). Po ashtu, në këtë numër ka përshtatje për stafin e komunave në sektorin e arsimit të cilët nuk kanë normë të plotë të orëve si dhe përshtatje varësisht nga data e fillimit apo largimit të punëtorëve nga sistemi i pagave.

Numri i të punësuarëve aktual sipas raportit të normave nuk prezanton numrin real të të punësuarëve në administratën publike që kanë marrëdhënie kontraktuale (të punësuar që janë pjesë e Payrollit) me organizatat buxhetore duke rezultuar në prezantim jo të drejtë dhe jo të saktë.

Të punësuarit jashtë listës së pagave

Sipas RVF-BRK-së për vitin 2022, numri i të punësuarve jashtë listës së pagave ishte 622 (niveli qendror 545 ndërsa niveli lokal 77). Numri më i lartë i të punësuarve jashtë listës së pagave ishte në SHSKUK 305, MFPT 38, Komuna e Gllogocit 32 etj.

Krahasuar me vitin paraprak numri i të punësuarve të kësaj kategorie ishte zvogëluar për 1,441. Rënia e numrit vjen kryesisht nga Ministria e Shëndetësisë pasi që më nuk kishte nevojë për staf për menaxhimin e pandemisë covid 19.

Të punësuarit përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta (MShV)

Sipas RVF-BRK për vitin 2022, numri i të angazhuarve përmes MShV-ve ishte 1,511. Krahasuar me vitin paraprak kemi një rënie të theksuar prej 62,372 e cila vjen si rezultat i stafit të angazhuar nga KQZ për zgjedhjet 2021.

Sipas raporteve individuale të auditimit për vitin 2022 angazhimi i stafit me MSHV ishte për detyra specifike por kishte raste edhe për plotësimin e pozitave të rregullta. Po ashtu, kishte raste kur nuk ishin aplikuar procedurat përkatëse për angazhimin e tyre.

Numri më i lartë i të angazhuarve me MSHV në nivelin qendor ishte në MFPT me 357 persona, prej tyre 344 të angazhuar si anketues në Agjencinë e Statistikave të Kosovës.

Përderisa në nivelin lokal kemi këto mangësi për këtë kategori të të punësuarve:

- Komuna e Prishtinës kishte angazhuar 201 punonjës përmes MSHV, pa aplikuar procedura të rregullta të rekrutimit. Pas skadimit të kontratave të para (me afat prej katër muajve), të njëjtëve ju kishin vazhduar kontratat edhe për katër muaj të tjerë;
- Komuna e Deçanit kishte angazhuar 103 punonjës përmes MShV në administratën komunale në drejtori të ndryshme si dhe në sektorin e shëndetësisë. Për këta punonjës komuna nuk ka zhvilluar as procedurë formale të rekrutimit as procedura të prokurimit për MShV, por janë angazhuar me vendime me kohëzgjatje gjashtë (6) mujore të përsëritura vit pas viti. Angazhimi i tyre nuk është bërë për shërbime të veçanta apo detyra specifike por për pozita të rregullta të punës; dhe
- Komuna e Vitisë kishte angazhuar 80 persona me MSHV për të mbuluar kryesisht pozita të rregullta në administratën komunale, për të cilat nuk kishte zhvilluar asnjë lloj procedure, qoftë përmes prokurimit, apo procesit të rregullt të rekrutimit.

Rekomandim për Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve

Ministri, duhet të sigurojë se raportimi i të punësuarve aktual prezanton numrin real të të punësuarëve në administratën publike duke përfshirë të gjithë nëpunësit të cilët kanë marrëdhënie kontraktuale me organizatat buxhetore përkatëse dhe janë pjesë e sistemit të menaxhimit të pagave (Payroll).

Kapitulli - II
PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE NGA AUDITIMET INDIVIDUALE – 2022

1. Përmbledhje e opinioneve, konkluzioneve dhe rekomandimeve

ZKA për vitin 2022, ka perfunduar 86[14] auditime financiare dhe të pajtueshmerisë për nivelin qendror dhe lokal. Auditimet janë kryer në bazë të metodologjisë së auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë në përputhje me me Standardet e Auditimit (SNISA-t). Në bazë të kësaj kemi dhënë opinionet e auditimit për Pasqyrat Financiare,dhe kemi dhënë konkluzione në lidhje me pajtueshmërinë me autoritetet për secilën Organizatë Buxhetore (OB).

Nga auditimi i 86 PFV individuale 53 kanë rezultuar me opinion të pamodifikuar dhe 33 me opinion të modifikuar/kualifikuar. Krahasuar me vitin 2021 vërehet një përmirësim në cilësinë e raportimit financiar, për faktin se për vitin 2021 janë dhënë 46 opinione të pamodifikuara, 42 të modifikuar dhe 2 të kundërta.

Në lidhje me konkluzionet për pajtueshmëri 41 raporte të auditimit kanë rezultuar me konkluzion se organizatat buxhetore kanë punuar në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi ndërsa 45 të tjera nuk kanë vepruar në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Po ashtu, krahasuar me vitin 2021 vërehet një përmirësim sa i përketë menaxhimit të shpenzimeve dhe të hyrave në pajtueshmëri me kornizën ligjore në fuqi për faktin se në vitin 2021 janë dhënë 35 konkluzione të pamodifikuara, 49 të modifikuara dhe 6 të kundërta.

Konkzluzioni i përgjithshëm është se organizatat buxhetore si në nivelin qendror ashtu edhe lokal kanë bërë përmirësime si në aspektin e raportimit financiar e ashtu edhe në aspektin e pajtueshmërisë me kornizën ligjore.

Tabela 26 - Numri i rekomandimeve sipas kategorive për vitin 2022

Nr.	Kategorit ekonomike	Niveli qendror	Niveli lokal	Totali
1	Pasqyrat Financiare Vjetore	10	6	**16**
2	Pagat dhe mëditjet	21	12	**33**
3	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalit	49	51	**100**
4	Çështjet e përbashkëta (MSh dhe IK)	7	22	**29**
5	Investimet kapitale	30	75	**105**
6	Subvencionet dhe transferet	8	31	**39**
7	Të hyrat	7	27	**34**
8	Obligimet e papaguara	13	18	**31**
9	Detyrimet Kontigjente	10	9	**19**
10	Llogaritë e arkëtueshme	10	40	**50**
11	Pasuritë	49	46	**95**
12	Auditimi i Brendshëm	5	15	**20**
	Total	**219**	**352**	**571**

Në raportet individuale të auditimit të OB-ve për vitin 2022 kemi dhënë 571 rekomandime për përmirësimin e secilës fushë ku janë identifikuar mangësi dhe gabime. Nga 571 rekomandime 244 janë rekomandime të reja, 271 të përsëritura dhe 56 pjesërisht të përsëritura. Kategoritë me nivelin më të lartë të rekomandimeve janë ajo e investimeve kapitale, mallrave e shërbimeve dhe pasurive.

[14] Komuna e Mitrovicës veriore, Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveqanit nuk janë audituar ne vitin 2022 dhe nuk janë të përfshira në këtë numër.

Fusha e prokurimit publik ka qenë në fokus të auditimit financiar dhe pajtueshmërisë për shkak se gjatë vitit 2022 janë lidhur 10,290 kontrata në vitin 2022, që krahasuar me vitin paraprak paraqet një rritje prej 4%. Vlera e kontratave të nënshkruara është mbi 559 milion euro ose 31% më e lartë se vitin paraprak. Gjithsej 162 autoritete kontraktuese (AK) ishin përfshirë në zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit që kanë çuar në lidhjen e këtyre kontratave. Agjencia Qendrore e Prokurimit ka zhvilluar aktivitete të prokurimit për 16 institucione të pavarura.

Organizatat buxhetore kanë nënshkruar 7,714 kontrata të prokurimit gjatë vitit 2022, që përbën 75% të numrit total të kontratave, ndërsa ndërmarrjet publike kanë nënshkruar 2,576 kontrata ose 25% të numrit total të kontratave. Rezultatet e auditimit që ndëridhen me këtë kategori të shpenzimeve dhe shpenzimeve tjera si dhe rekomandimeve për përmirësimin e mangësive të identifikuara janë paraqiturë në vijim ndaras për nivelin qendror dhe lokal.

2. Niveli Qendror

2.1 Opinionet e auditimeve dhe çështjet në modifikimin e tyre

ZKA-ja për vitin 2022, ka finalizuar 52 raporte të auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë për nivelin qendrorë, këtu përfshihen auditimet për ministritë dhe institucionet e pavarura.

Auditimet janë kryer bazuar në metodologjinë për auditimin financiar dhe të pajtueshmërisë, për të qenë në linjë me Standardet e Auditimit (SNISA-t). Prandaj, mbështetur në këtë bazë, ne kemi dhënë opinionet e auditimit për Pasqyrat financiare, në përputhje me SNISA-t, si dhe kemi dhënë konkluzione në lidhje me pajtueshmërinë me autoritetet për secilën OB. Opinionet e auditimit në lidhje me Pasqyrat Financiare Vjetore të OB-ve, të nivelit qendror janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 27 - Lloji dhe numri i opinioneve për nivelin qendror për vitin 2022

Subjektet e audituara	Opinion i pamodifikuar	Opinion i kualifikuar	Totali
Niveli Qendror[15]	9	14	23
Institucionet e pavarura	26	3	29
Total	35	17	52

Nga 52 PFV-të e nivelit qendror (përfshi edhe institucionet e pavarura) 35 kanë rezultuar me opinion të pamodifikuar dhe 17 me opinion të kualifikuar.

Çështjet kryesore të cilat kanë ndikuar në kualifikim të opinionit janë si në vijim:

- Klasifikimi dhe raportimi jo i duhur i shpenzimeve, i ndikuar kryesisht nga ndarjet e mjeteve me ligj të buxhetit në kategoritë jo adekuate;
- Informatat e pasakta për pasuritë kapitale dhe jokapitale, që janë reflektuar nga nënvlerësimi i tyre për shkak të mos regjistrimit adekuat ose mos regjistrimit në regjistrat kontabël të pasurive. Në anën tjetër, ka raste kur në regjistra të pasurisë janë të përfshira pasuri të cilat nuk janë në pronësi të OB-ve duke ndikuar në mbivlerësim;
- Edhe këtë vit ka vazhduar pagesa për punonjësit të sistemuar bazuar në marreveshjen e Brukselit. Si rezultat i kësaj në vitin 2022 vlera totale e këtyre pagesave ishte 792,955€ e cila ishte bërë në mungesë të vijueshmërisë së plotë në punë. Numri i të punësuarve për këtë kategori të punonjësve ishte 129 (MMPHI 64 punonjës, MPB 20, MKK 20 dhe MINT 25) të cilët janë paguar gjatë tërë vitit, përderisa 52 punonjës ishin paguar vetëm për gjysmën e parë të vitit 2022 (MASHTI kishte 32 punonjës të cilët në pjesen e dytë të vitit u kishte siguruar kushte dhe kishte vijueshmëri të të punësuarve si dhe MKRS për 20 punonjësit në gjysmën e dytë të vitit u kishte ndërprerë pagesat/pagat;
- Informata të pasakta për detyrime kontigjente që kanë reflektuar nga nënvlerësimi i tyre për shkak të mos evidentimit të plotë të tyre. Në anën tjetër ka raste të mbivlerësimit si pasoje e përfshirjes në regjistër të lëndeve të cilat kanë përfunduar; dhe
- Informata të pasakta për obligimet e papaguara si pasojë e mos përfshirjes së faturave të pranuara si obligime.

[15] Ne institucionet e nivelit qendror jane: 15 Ministri, ZKM, Zyra e Presidentit, Kuvendi I Kosoves, Fondi I Sigurimeve Shendetesore, SHSKUK, ATK, Dogana dhe RTK

2.2 Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre

Konkluzionet e pajtueshmërisë në lidhje me OB-të e nivelit qendror janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 28 - Lloji dhe numri i konkluzioneve për nivelin qendror për vitin 2022

Subjektet e audituara	Konkluzion i pamodifikuar	Konkluzion i kualifikuar	Totali
Niveli Qendror[16]	10	13	23
Institucionet e pavarura	27	2	29
Total	37	15	52

Nga 52 PFV të nivelit qendror (përfshi edhe institucionet e pavarura) 37 kanë rezultuar me konkluzion të pamodifikuar dhe 15 me konkluzion të kualifikuar.

Çështjet kryesore të cilat kanë ndikuar në kualifikim të konkluzioneve janë si në vijim:

- Vonesa në pagesën e obligimeve, me ç`rast faturat nuk ishin paguar brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Këto mangësi vinin si rezultat i mungesës së kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pagesës së faturave;
- Mos respektimi i hapave për procedim të pagesave siç kërkohet me rregulloren e 01/2023 Shpenzimi i parave publike duke pranuar faturat para zotimit të mjeteve dhe urdhër blerjes;
- Mos arsyetimi i shpenzimeve nga përfituesit e subvencioeneve sietimi i shpenzimeve nga përfituesit e subvencioeneve siç përcaktohet me marrëveshje;
- Përzgjedhja e operatorit ekonomik i cili nuk i kishte plotësuar në tërësi kriteret e përshtatshmërisë sipas dosjes së tenderit;
- Zhvillimi i procedurës së negociuar pa publikim për automjete transporti dhe vonesa në liferimin e mallit; dhe
- Mos respektimi i rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurim publik rreth menaxhimit të kontratave.

Çështjet e mësipërme kanë ndodhur si pasojë e mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme të organizatave buxhetore dhe papërgjegjësia në punë nga zyrtarët përkatës. Pajtueshmeria me ligjet dhe rregulloret në fuqi ka përmirësim në krahasim me vitin e kaluar pasi që nga 17 konkluzione të kualifikuara dhe një konkluzion i kundërt këtë vit janë dhënë 15 konkluzione të kualifikuara dhe asnjë i kundërt.

2.3 Çështje tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

Çështjet më të shpeshta dhe të përsëritura nga viti në vit në institucionet e nivelit qendror, në bazë të kategorive ekonomike, duke i përjashtuar çështjet të cilat kanë ndikuar në opinionin dhe konkluzion për pajtueshmëri janë paraqitur si më poshtë:

[16] Ne institucionet e nivelit qendror jane: 15 Ministri, ZKM, Zyra e Presidentit, Kuvendi I Kosoves, Fondi I Sigurimeve Shendetesore, SHSKUK, ATK, Dogana dhe RTK

Paga dhe shtesa

Mbajtja e pozitave të rregullta udhëheqëse me zëvendësues përtej afatit ligjor, si rezultat i mungesës së veprimeve konkrete të ministrive/agjencive përkatëse për hartimin e rregulloreve të reja për ri-organizim të stafit në përputhje me ndryshimet strukturore që kanë ndodhur.

Mallra dhe shërbime

Mangësi në procesin e vlerësimit të ofertave, përzgjedhja e ofertuesve si të përgjegjshëm nga komisioni i vlerësimit dhe shpërblimi i tyre me kontratë në mungesë të plotësimit të kritereve të vendosura në dosje të tenderit.

Investime kapitale

Vonesat në realizimin e punimeve të projekteve kapitale, si pasojë e mos realizimit të punimeve sipas planit dinamik, ku si arsye e këtyre vonesave ishin lidhja e kontratave pa u zgjidhur problemet me shpronësimin e tokave, mangësitë në hartimin e projekteve ekzekutive.

Subvencione dhe transfere

Përfituesit e pensioneve dhe ndihmave sociale nga personat e punësuar dhe pensionet e paguara pas vdekjes si dhe përfitimi i më shumë se një pensioni nga skemat pensionale, dukuri që vazhdon të paraqitet si e gjetur vit pas viti, megjithatë krahasuar me vitin paraprak ka një progres në zvogëlimin e këtyre pagesave të parregullta. Këto mangësi vazhdojnë të ndodhin si shkak i mungesës së interpretimit përfundimtar të ligjeve për skemat pensionale, si dhe fuzionimit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Pasuritë

- Mangësitë në procesin e inventarizimit të pasurisë, sikurse mos harmonizimi i regjistrave të pasurisë me raportin e inventarizimit, dhe në disa raste mos kryerja e procesit të inventarizimit. Si rezultat i këtyre mangësive, pasuritë jashtë përdorimit të cilat ishin identifikuar në raporte te inventarizimit, nuk ishin larguar nga regjistrat e pasurive, si dhe raportet e përgatitura shpeshherë ishin të mangëta duke mos përmbajtur të gjitha informacionet sipas kërkesës së rregullores së pasurive.

- Mos përdorimi i sistemit e-pasuria, me ç`rast disa organizata buxhetore vazhdonin që evidencat e pasurive jokapitale t`i mbajnë në regjistra të brendshëm. Kjo vjen si shkak i mos angazhimit të mjaftueshëm të organizatave buxhetore në funksionalizimin dhe përdorimin e sistemit e-pasuria.

Të hyrat

- Në Doganën e Kosovës, është identifikuar se ka pasur raste ku nuk kishte harmonizim të plotë të tarifave doganore në TARIK me sistemin ASYCUDA. Kjo pasi Dogana nuk kishte arritur të bëjë azhurnimin e listës së kodeve dhe nënkodeve tarifore mes dy sistemeve.

- Në ATK, është identifikuar se në 29 raste kishte pasur vonesa në trajtimin e kërkesave të tatim paguesve për kthim /rimbursim tatimor mbrenda afatit ligjor. Poashtu, procesi i mbledhjes dhe menaxhimit të të hyrave është përcjellë me mangësitë siç janë: procesi i pa

përfunduar i fiskalizimit dhe menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme/borxheve të vjetra.

Përkundër përpjekjeve të bëra nga ATK, fiskalizimi i plotë i të gjitha bizneseve mbetet ende sfidë. Numri i bizneseve që nuk janë fiskalizuar ende e që sipas legjislacionit në fuqi kërkohet të pajisen me arka fiskale në fund të vitit 2022 ishte 12,537 tatim pagues. Pjesën më të madhe prej 8,974 bizneseve pa arka fiskale e përbënin mikro bizneset me qarkullim vjetor deri në 5,000€. Në raport me vitin e kaluar kemi një ulje të numrit të tatim paguesve që janë pa arka fiskale (në 2021 numri i tatim paguesve që nuk kishin arka fiskale ishte 13,656).

2.4 Rekomandimet e dhëna

Në 52 raportet individuale të nivelit qendror, për vitin 2022 janë dhënë 219 rekomandime për përmirësimin e secilës fushë ku janë identifikuar mangësi dhe gabime. Nga 219 rekomandime 112 janë rekomandime të reja, 84 të përsëritura dhe 23 pjesërisht të përsëritura. Në tabelën më poshtë janë paraqitur rekomandimet e dhëna për tri vitet e fundit.

Tabela 29 - Numri i rekomandimeve për nivelin qendror për tri vite

Subjektet e audituara	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020
Niveli Qendror[17]	165	185	244
Institucionet e pavarura	54	55	43
Total	219	240	287

Të dhënat e paraqitura në tabelë tregojnë për zvogëlim të numrit të rekomandimeve krahasuar me vitin paraprak. Kjo tregon se këtë vit ka pasur një përmirësim të menaxhimit që ka rezultuar me një numër më të vogël të rekomandimeve të dhëna për vitin 2022. Institucionet të cilat kane zvogëlim të rekomandimeve krahasuar me vitin e kaluar janë: Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, Radio Televizioni i Kosovës etj.

[17] Ne institucionet e nivelit qendror jane: 15 Ministri, ZKM, Zyra e Presidentit, Kuvendi I Kosoves, Fondi I Sigurimeve Shendetesore, SHSKUK, ATK, Dogana dhe RTK

3. Niveli Lokal

3.1 Opinionet e auditimeve dhe çështjet në modifikimin e tyre

ZKA-ja për vitin 2022, ka finalizuar 34 raporte të auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë për nivelin lokal. Për katër (4) Komunat në veri të vendit, auditimi është iniciuar nga ZKA, por për shkaqe të rrethanave të krijuara në atë pjesë, nuk kishte kushte të përshtatshme për auditimin e tyre[18].

Auditimet janë kryer bazuar në metodologjinë për auditimin financiar dhe të pajtueshmërisë, për të qenë në linjë me Standardet e Auditimit (SNISA-t). Prandaj, mbështetur në këtë bazë, ne kemi dhënë opinionet e auditimit për Pasqyrat financiare, në përputhje me SNISA-t, si dhe kemi dhënë konkluzione në lidhje me pajtueshmërinë me autoritetet për secilën OB. Opinionet e auditimit në lidhje me PFV-të e OB-ve, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 30 - Lloji dhe numri i opinioneve për nivelin lokal për vitin 2022

Subjektet e audituara	Opinion i pamodifikuar	Opinioni i kualifikuar	Komunat e pa audituara	Gjithsejt
Komunat	18	16	4	38

Siç shihet nga tabela e mësipërme, auditimet individuale të OB-ve kanë rezultuar me 18 opinione të pamodifikuara, si dhe 16 opinione të modifikuara. Për komunat e audituara, shprehur në përqindje, 47% e opinioneve të auditimit janë të modifikuara, që krahasuar me vitin 2021 (opinione të modifikuara ishin 24 apo rreth 67%), atëherë mund të konkludojm se trendi pozitiv te opinionet e auditimit është për 20%. Kjo do të thotë se, një numër i konsiderueshëm i OB-ve kanë marrë parasysh rekomandimet që i kemi dhënë vitin e kaluar rreth përgatitjes së PFV-ve, megjithëkëtë, ende mbeten çështje me gabime në raportimin dhe shpalosjen e informatave të kërkuara në PFV-të në disa komuna.

Arsyet për modifikimin e opinioneve të auditimit ishin kryesisht:

- Klasifikimi dhe raportimi jo i duhur i shpenzimeve i ndikuar nga pagesat përmes vendimeve të gjykatave/përmbaruesve kryesisht për kompensimin e pagave jubilare dhe shujtat por edhe nga planifikimi jo i duhur i buxhetit për kategori të caktuara ekonomike;
- Informata të pasakta për pasuritë kapitale dhe jokapitale, që janë reflektuar nga nënvlerësimi i tyre për shkak të mos regjistrimit në regjistrat kontabël të pasurive. Në anën tjetër kishte raste edhe kur në regjistra të pasurisë janë të përfshira pasuri të cilat nuk janë në pronësi të komunës;
- Mbivlerësimi i llogarive të arkëtueshme për shkak të faturimit jo të drejtë ndaj obliguesve;
- Mbivlerësim i detyrimeve kontigjente të cilat janë dyfishuar apo raste të raportimit të gabuar; dhe
- Pagesa për punët e papërfunduara, raste kur pozicione të ndryshme brenda situacioneve për pagesa nuk janë përfunduar punët, derisa pagesat janë kryer në tërësi të situacioneve, apo raste kur pagesat janë kryer, derisa furnizimi i mallit nuk është pranuar.

[18] Komunat: Mitrovica Veriore, Leposaviçi, Zubin Potoku dhe Zveçani.

Në disa raste, modifikimi i opinionit ka rezultuar si pasojë e ndikimeve jashtë OB-ve për të cilat OB-të nuk kanë pasur mundësinë e korrigjimeve të duhura. Këto raste janë reflektuar nga keqklasifikimet e evidentuara në disa Komuna[19] lidhur me pagesën e pagave jubilare, bazuar në kontratën kolektive, kanë të bëjnë me pagesat që janë realizuar nga Thesari përmes vendimeve gjygjësore/përmbarimore, për të cilat komunat nuk kishin mundësitë buxhetore për pagesë për shkak të ose ndarjeve buxhetore për këtë qëllim apo mos planifikimit të duhur buxhetor nga ana e komunës. Ndërsa, çështjet tjera që kanë ndikuar opinionet janë si pasojë e kontrolleve jo të duhura në komuna lidhur me menaxhimin e projekteve apo të zyrtarëve që kanë përgjegjësi në identifikimin apo regjistrimet e nevojshme për llogari të caktuara për raportim të cilat janë reflektuar në PVF.

3.2 Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre

Për çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë, ZKA-ja për vitin 2022, për nivelin lokal ka dhënë 34 konkluzione të pajtueshmërisë. Konkluzionet e pajtueshmërisë, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 31 – Lloji dhe numri i konkluzioneve për nivelin lokal për vitin 2022

Subjektet e audituara	Konkluzioni i pamodifikuar	Konkluzion i kualifikuar	Komunat e pa audituara	Gjithsejt
Komunat	4	30	4	38

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme, nga 34 komuna të audituara, kanë rezultuar 30 konkluzione të kualifikuara dhe 4 konkluzione të pamodifikuara. Shprehur në përqindje, 88% e konkluzioneve të auditimit janë të kualifikuara, që nënkupton se pjesa më e madhe e komunave kanë probleme me pajtueshmërinë me autoritetet apo transkasionet e tyre nuk janë në pajtim me kërkesat ligjore.

Megjithatë, është më rëndësi të paraqesim faktin se në nivelin komunal, në këtë aspekt ka treguar një performancë më të mirë në vitin 2022, krahasuar me vitin paraprak. Derisa në vitin 2021, raportet e auditimit kanë pasur pesë (5) konluzione të kundërta, për vitin 2022 nuk kemi konkluzione të kundërta për pajtueshmërin me kornizën ligjore dhe rregulloret në fuqi. Çka do të thotë se, komunat kishin ndërrmar masa dhe vetem në raste të caktuara nuk ishin në perputhje me kornizen ligjore.
Arsyet për konkluzion të kualifikuar ishin kryesisht çështjet që kanë të bëjnë me:

- Angazhimin e zyrtarëve me marrëveshje për shërbime të veçanta pa udhëhequr procedurat e prokurimit;
- Mos verifikimi i 20% të pronave të tatueshme siç kërkohet me Ligj, si rezultat i mungesës së kapaciteteve të burimeve njerëzore;
- Dobësi në zhvillimin e procedurave të prokurimit, si specifikimet teknike jo të qarta në dosjet e tenderit, lidhja e kontratave përmes çmimit të poentuar (i gabuar), mos publikimi i kontratave në sistemin e-prokurimi si dhe mungesa e menaxhimit të kontratave përmes këtij sistemi;

[19] Komuna e Podujevës, Fushë kosovës, Gllokovci, Prizreni, Deçani, Gjakova, Vitia, Istogu, Mitrovica e Jugut.

- Dobësi në menaxhimin e kontratave, përfshirë: mos nënshkrimi i planeve të menaxhimit të kontratave, vonesat në dinamikën e projekteve, mos konfiskimi i sigurimit të tenderit, pagesat për punë të papërfunduara si dhe tejkalim në furnizim nga sasitë e kontraktuara dhe përdorimi i kontratave jo adekuate që kanë shkaktuar tejkalim të vlerës së tyre në raport me vlerën e parashikuar;
- Kosto shtesë përmbarimore janë paguar për mos kryerjen e obligimeve me kohë nga ana e Komunave. Kjo situatë ka rezultuar nga paditë që kanë bërë OE ndaj Komunës për shkak të mos pagesave për punët apo shërbimet e kryera;
- Mungesa e planeve vjetore për subvencionim të OJQ-ve, gabime në vlerësimin e aplikacioneve, procesi jo adekuat i përzgjedhjes së përfituesve duke mos përdor metoda apo kritere të përcaktuara;
- Menaxhim jo i duhur i regjistrimit të pasurive duke nënvlerësuar apo mbivlerësuar regjistrat e pasurive;
- Vonesa në pagesën e faturave (detyrimeve); dhe
- Zotimi i mjeteve financiare pas pranimit të faturave;

Çështjet e mësipërme kanë ndodhur si pasojë e mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme të komunave dhe papërgjegjësia në punë nga zyrtarët përkatës si dhe mos marrja e veprimeve konkrete nga ana e komunave për evitimin e çështjeve të identifikuara.

3.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

Përveç çështjeve që kane ndikuar opinionin financiar dhe konkluzionin e pajtueshmërisë, ZKA për vitin 2022 në raportet individuale për 34 Komuna ka ngritur edhe çështje rreth menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë.

Çështjet që janë identifikuar kanë të bëjnë me kategori të ndryshme ekonomike të cilat kryesisht janë identifikuar në raportet individuale të Komunave. Përveç çështjeve të specifikuara më poshtë, me rëndësi është të përmendim edhe trendin e rritjes së llogarive të arkëtushme prej vitit në vit, mos përdorimi i softverit të e-pasurisë dhe mos kryerja e procesit të inventarizimit të pasurive para përgatitjes së PFV-ve, mungesa e planeve të veprimit dhe niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve të NJAB-së si dhe mos funksionimi i komiteteve të auditimit.

Paga dhe shtesat

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuara dhe të prezantuara në raportet individuale të auditimit në kategorinë e pagave dhe mëditje janë:

- Dobësi në vlerësimin e përzgjedhjes së kandidatëve, ku janë identifikuar se komisionet e vlerësimit nuk kishin bërë përzgjedhjen e kandidatëve sipas rezultateve të treguara në testet me shkrim dhe intervistat. Komisionet e vlerësimit nuk i kishin vlerësuar drejt kandidatet si pasojë e kujdesit jo të duhur;
- Mbajtja e pozitave të punës me ushtrues detyre, përkundër kërkesës ligjore për përfundimin e marrëdhënieve të punës me ushtrues të përkohshëm të detyrës, kjo kërkesë ligjore ende nuk ishte zbatuar. Kjo kishte ndodhur për shkak që, menaxhmentet nuk kishin arritur që për pozitat e mbajtura me UD, të zhvillojnë procedura përzgjedhëse për punonjës me kontrata të rregullta;

- Zyrtarë jashtë listës së pagave, ka raste kur Komunat gjatë vitit 2022 (në fund të vitit) nuk kishin arritur që në listën e pagave të regjistrojnë të gjithë të punësuarit. Kjo ka ndodhur për shkak se në arsim ishte shtuar numri i paraleleve më shumë se sa ishin në planet për regjistrimin e nxënësve në klasat e 10-ta për vitin shkollor 2022/2023, që ka rezultuar nga mungesa me arsye të mësimdhënësve dhe pushimet e lehonisë; dhe
- Mungesa e autorizimeve për pagesat e zyrtarëve për punë jashtë orarit. Komunat, nuk kanë përcjellë rregullat për autorizim dhe nuk kanë mbajtur shënime të duhura lidhur me kryerjen e punëve jashtë orarit të punës.

Mallra dhe shërbime

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuara dhe të prezantuara në raportet individuale të auditimit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve janë:

- Inicimi i projekteve pa zotim të mjaftueshëm të mjeteve, në disa raste komunat kishin hyrë në obligime kontraktuale pa mjete të mjaftueshme të zotuara. Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit;
- Mosrespektim i hapave për procedimin e pagesave sipas kërkesës së Rregullës Financiare, ku fillimisht është sjellë situacioni për punët/ mallin dhe shërbimet e pranuara dhe fatura, e pastaj është lëshuar urdhërblerja. Kjo ishte si pasojë e dështimit të kontrolleve nga zyra e prokurimit me rastin e procedimit të urdhërblerjes;
- Tejkalim i sasive të kontraktuara mbi 30% e lejuar për kontratat publike kornizë. Tejkalimi ishte bërë me arsyetimin e mundësimit të kompletimit të projekteve sipas specifikave dhe nevojave të hasura në teren gjatë realizimit tyre;
- Përdorimi i procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë pa u përmbushur kriteret e kërkuara për këtë procedurë të prokurimit. Kjo ishte rezultat i pakujdesisë të zyrtarëve përgjegjës.

Investime Kapitale

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuara dhe të prezantuara në raportet individuale të auditimit në kategorinë e investimeve kapitale janë:

- Ndryshime mbi 10% të vlerës së kontratave pa aplikuar procedurat e prokurimit. Këto ndryshime kanë të bëjnë me sasitë e realizuara në pozicione të caktuara të cilat kryesisht ishin aprovuar nga zyra e prokurimit dhe Kryetari, pa aplikimin e procedurave të prokurimit. Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së njohurive lidhur me ndryshimet në rregullat e prokurimit publik;
- Komunat kishin filluar procedura të prokurimit dhe kishin lidhur kontrata për punë, pa hartuar paraprakisht projektet ekzekutive të ndërtimit. Zhvillimi i procedurave të prokurimit në mungesë të projekteve ekzekutuese ka ndodhur për shkak të neglizhencës së njësive kërkuese si dhe mos funksionimit efikas të kontrolleve;
- Në disa raste është identifikuar se Komunat në menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve, nuk e kanë mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit e-prokurimi. Kjo kishte ndodhur si rezultat i neglizhencës së menaxherëve të projekteve;
- Ekzekutimi i pagesave për projekte të caktuara nga buxheti i projekteve tjera. Në disa raste, Komunat kanë përdorë fondet e projektit për qëllime tjera nga ajo për çka ishin planifikuar. Në këto raste, nuk ka aprovim nga Kuvendi Komunal për ridestinim të mjeteve dhe rialokim të ndarjeve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër. Zyrtarët

nuk kanë ofruar ndonjë shpjegim për mos zbatim të kërkesës ligjore. Megjithëse, kjo situatë është përsëritur, veprimet e tilla janë të ndikuara nga planifikimi jo i mirë i projekteve dhe nga nevojat për mjete buxhetore;

- Përzgjedhja e operatorit ekonomik të papërgjegjshëm, pa u plotësuar kriteret e vendosura me dosjen e tenderit. Kjo ishte si pasojë e kontrolleve të brendshme jo efikase në procesin e vlerësimit të tenderëve, jo konform kritereve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë; dhe
- Te projektet për ndërtimin e rrugëve lokale, janë vërejtur vonesa në përfundimin e punëve. Në raportet përfundimtare të përgatitur nga mbikëqyrësit e projekteve, nuk janë dhënë informacione apo arsyetime për vonesat në realizim të projekteve. Kjo ishte si pasojë e mungesës së kontrolleve të mjaftueshme në menaxhimin e kontratave publike.

Subvencionet dhe transfereve

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuara dhe të prezantuara në raportet individuale të auditimit në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve janë:

- Komunat nuk e kishin përgatitur planin vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve për vitin 2022 ashtu siç parashihet me kërkesa ligjore;
- Kishte raste që ofruesit e mbështetjes financiare nuk kanë caktuar zyrtar përgjegjës i cili duhet kujdeset për monitorimin e implementimit të projektit. Po ashtu, ka raste që OJQ-të nuk kanë dorëzuar raporte financiare dhe narrative;
- Ndarje jo e duhur e detyrave, janë identifikuar raste kur në komisionet e vlerësimit të aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për klubet dhe shoqatat sportive dhe OJQ për vitin 2022, anëtari i komisionit ishte edhe zyrtari çertifikues. Komuna në këtë rast, nuk e ka konsideruar si konflikt interesi apo të kundërligjshme; dhe
- Subvencionimi i OJQ-ve pa thirrje publike, disa OJQ fituese të subvencioneve (për sport, kulturë dhe organizatë komunale e pensionistëve), janë përzgjedhur në bazë të Vendimeve të Kuvendit Komunal, pa shpallje paraprake të thirrjes publike.

Të gjeturat e mësipërme kanë ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve adekuate nga Komuna për të zbatuar kriteret sipas kërkesave ligjore.

Të hyrat

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuara dhe të prezantuara në raportet individuale të auditimit në kategorinë e të hyrave janë:

- Nga analizimi i bazës së tatimit në pronë të vitit 2022, kemi nxjerr përfundimet nga listat e tatimpaguesve, të cilat në shënimet e bazës ProTax, kanë numrin e letërnjoftimit gabim (zbrazet ose shifra tjera të gabuara). Po ashtu, në disa raste te këta tatimpagues, kriteri për vendbanimin parësor ishte aplikuar dy herë te tatimpaguesit e njëjtë. Kjo ka rezultuar nga mos përditësimi i informacionit të tatimpaguesve në sistem;
- Shfrytëzimi i pronave publike pa kompensim dhe me kontrata të skaduara. Rrjedhimisht, situata e tillë është për faktin e mos marrjes së veprimeve vit pas viti për trajtimin e kësaj çështje;
- Rastet kur tatimpaguesit kanë bërë ankesë lidhur me pasaktësinë e faturës së tatimit në pronë, shqyrtimi i tyre është bërë me vonesë, duke tejkaluar afatin ligjor për shqyrtim nga

një deri në tre muaj. Mos funksionimi i mirëfilltë i kontrolleve të brendshme, ka ndikuar që shqyrtimi i ankesave të mos jetë brenda afatit ligjor; dhe

- Komunat nuk kishin respektuar afatet ligjore për lëshimin e lejeve të ndërtimit. Janë identifikuar vonesa në shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi, për më tepër, vonesa kishte edhe në lëshimin e lejeve mjedisore. Komunat këtë e arsyetojn me faktin e numrit të lartë të kërkesave dhe mungesës së kapaciteteve njerëzore brenda drejtorisë së planifikimit strategjik (e sidomos sektori për lëshimi e lejeve mjedisore komunale) dhe drejtorisë së urbanizmit për shqyrtimin e kërkesave me kohë.

3.4 Rekomandimet e dhëna

Në raportet individuale të Komunave, për vitin 2022 janë dhënë 352 rekomandime për përmirësimin e secilës fushë ku janë identifikuar mangësi dhe gabime. Në tabelën e mëposhtme i kemi paraqitur rekomandimet e dhëna për tri vitet e fundit.

Tabela 32 - Numri i rekomandimeve për nivelin lokal për tri vite

Subjektet e audituara	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020
Komunat	**352**	**438**	**367**

Të dhënat e paraqitura në tabelë tregojnë për zvogëlim të numrit të rekomandimeve krahasuar me vitin paraprak. Kjo tregon se, këtë vit ka pasur një përmirësim të menaxhimit që ka rezultuar me një numër më të vogël të rekomandimeve të dhëna për vitin 2022.

Progresin më të theksuar në rekomandime kanë pasur Komunat si: Istogu, Peja, Mitrovica e Jugut, Prizreni, Shtime, Rahovec, Mamushë, Gjakovë, Kaçanik dhe Kamenicë.

Këtu, përmendim faktin se për katër komunat që nuk janë audituar, nuk janë të përfshira në këto të dhëna, ndonëse numri i rekomandimeve të dhëna për vitin 2021 për këto komuna ishte gjithsejtë 29.

4. Sistemi i auditimit të brendshëm

Auditimi i Brendshëm (AB) është funksion i rëndësishëm i sistemit i cili siguron menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Po ashtu, i ndihmon organizatës në përmbushjen e objektivave të saj duke sjellë një qasje sistematike, të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e efikasitetit të procesit të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes. Komiteti i Auditimit (KA) është organ këshillëdhënës i menaxhmentit të lartë të Subjekteve të Sektorit Publik (SSP), dhe mbështetës për auditorët e brendshëm duke siguruar pavarësinë e tyre, vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve dhe siguruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Në kuadër të objektivave të Strategjisë së Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike është avancimi i AB-së përmes zbatimit të programit për zhvillimin profesional, sigurimit të cilësisë për pajtueshmëri si dhe azhurnimit të kornizës ligjore.

Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm (NJQHAB) është koordinatore e gjithë procesit për auditim të brendshëm dhe ndër të tjera monitoron subjekte të sektorit publik për kontrollin e brendshëm të financave publike. Sa i përket veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti i OB-ve në zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm kemi vërejtur se 41% e rekomandimeve të dhëna kishin gjetur zbatim të plotë, përderisa pjesa tjetër ishin në proces apo të pazbatuara. Më tutje, niveli i auditimeve të realizuara në raport me të planifikuarat ishte prej 94%.

Rregullorja 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm përcakton kriteret që duhet plotësuar për themelimin e NjAB-së. Bazuar në këto kritere 60 nga 86 OB-të që ishin të obliguara të kenë NJAB kishin të themeluar njësin duke i përjashtuar këtu katër komunat në veri të vendit. Po ashtu, rregullorja e njejtë përcakton edhe numrin minimal të auditorëve që duhet të kenë OB-të. Bazuar në këtë kriter kemi identifikuar se 31 OB apo 52% kishin numër të auditorëve më pak se sa që e parasheh rregullorja.

Sfidë mbetet themelimi i Komiteteve të Auditimit (KA) në të gjitha organizatat. Nga 60 OB-të që e kishin NjAB-në, dy (2) prej tyre (MMPHI dhe Komuna e Shtërpces) nuk e kishin themeluar Komitetin e Auditimit, ndërsa dy (2) nuk e kanë funksional Komitetin e Auditimit (Komunat Skenderaj dhe Novo Bërd). Për më tepër, Komitetet e Auditimit në tetë (8) OB kishin mbajtur me pak se katër (4) takime apo jo në pajtueshmëri me kërkesat UA 01/2019. Po ashtu, tetë (8) KA, nuk e kishin dorëzuar raportin vjetor siç kërkohet me nenin 10 të UA. Kjo tregon se KA-të ende nuk janë mjaftueshëm efektive për të mbështetur plotësisht punën e NjAB-së apo dhënien e këshillave për OB përkatëse.

Auditimet e brendshme vazhdojnë të mbeten të orientuara drejt pajtueshmërisë dhe më pak të përqendruara në auditime të performancës dhe të sistemeve.

Sistemi i kontrollit të brendshëm ende nuk është në nivelin e kënaqshëm, për të përmbushur objektivat në tërësi për të siguruar menaxhmentin se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive dhe në parandalimin e gabimeve dhe parregullsive.

Rekomandimet për Qeverinë

- Që përmes MFPT (NJQHAB) të sigurojë se OB-të të cilat janë të obliguara të themelojnë NjAB-në, duhet ta formojnë këtë njësi, përmes së cilës do të sigurohet funksionimi efikas dhe efektiv i sistemit të kontrollit të brendshëm. Po ashtu, OB-të që nuk janë të obliguara të kenë NjAB-në, funksionin e auditimit të brendshëm ta përmbushin përmes mënyrave tjera të parapara me rregullore; dhe

- Që përmes MFPT (NJQHAB) të sigurojë se OB-të sipas kërkesave ligjore themelojnë Komitetet e Auditimit për të mbështetur realizimin e objektivave të NjAB-së, dhe që këto komitete të jenë efektive në mbajtjen e takimeve dhe të kontribuojnë në rritjen e llogaridhënies dhe forcimin e rolit të AB-së, po ashtu të hartojnë raportin vjetor siç kërkohet me UA.

Kapitulli - III
AUDITIMET E PERFORMANCËS, PROKURIMIT, TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE NDËRMARRJEVE PUBLIKE

1. Auditimet e Performances, Prokurimit dhe TI-së

Zyra Kombëtare e Auditimit, vazhdon me fokus të veçantë ndaj auditimeve të performancës, si faktor i rëndësishëm në ndryshimin dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve. Auditimet e performancës vlerësojnë se sa fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe efektive dhe në dobi të mirëqenies së qytetarëve. Përmes rezultateve të auditimit, Kuvendi dhe qytetarët do të jenë në gjendje që t'i mbajnë llogaridhënës administruesit e fondeve publike.

Për sezonin auditues 2022-2023 janë mbuluar fusha me rëndësi ekonomike, shëndetësore, mirëqenie sociale si dhe tema në fushën e prokurimit publik dhe sistemeve të teknologjisë së informacionit. Gjatë përzgjedhjes së fushave të auditimit janë marrë parasysh edhe qëllimet e Agjendës së Kombeve të Bashkuara për zhvillim të vazhdueshëm 2030.

Gjatë sezonit raportues, janë kryer 15 raporte të auditimit të performancës përfshirë prokurimin dhe teknologjinë e informacionit. Në këto raporte janë dhënë gjithsej 195 rekomandime. Në vijim, janë paraqitur raportet, temat dhe përmbajtja e tyre.

1.1 Auditimet e performancës

Përmes auditimeve të përformancës, Zyra Kombëtare e Auditimit synon të promovojë efikasitetin, llogaridhënien, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike. Në këtë fushë janë kryer pesë (5) auditime që përfshinë tema të ndryshme. Në kuadër të këtyre auditimeve janë dhënë 74 rekomandime për organizatata e audituara. Në vijim është paraqitur përmbajtja e këtyre raporteve, përfshirë qëllimin, gjetjet dhe mesazhet e auditimit.

Tema: Performanca financiare dhe operative NP Trepça Sh.A

Trepça Sh.A. është Ndërmarrje Publike Qëndrore në pronësi të Qeverisë së Kosovës me 80% të aksioneve dhe 20% të tjera ju takon punëtorëve të Trepçës. Duke marrë parasysh ndikimin dhe peshën e këtij resursi pasuror për Kosovën në zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik të vendit, gjenerimin e punësimit, rritjen e eksportit dhe BPV-në, Zyra Kombëtare e Auditimit ka audituar performancën financiare dhe operative të Trepça Sh.A. për periudhën 2019-2021 me fokus tek procesi i prodhimit.

Qëllimi i këtij auditimit ka qenë të vlerësojë nëse NP Trepça ka vendosur sisteme dhe kontrolle adekuate të cilat e mbështesin arritjen e performancës financiare dhe operative pozitive, me fokus në procesin e prodhimit. Nëse jo, cilët janë shkaktarët që ndikojnë në produktivitetin e ulët, mungesën e rentabilitetit respektivisht profitabilitetit.

Mesazhi i auditimit: *Trepça Sh.A. nuk ka arritur të vendosë sisteme dhe kontrolle adekuate të brendshme të cilat do ta mbështesnin arritjen e performancës financiare dhe operative pozitive, me theks në procesin e prodhimit. Si rezultat, nuk kishte arritur të jetë efikase dhe efektive në shfrytëzimin dhe përpunimin e burimeve minerare, me synim të tejkalimit të operimit me humbje mesatare mujore prej 620,307€ dhe arritjes së rentabilitetit.*

Trepça Sh.A nuk ka arritur që të krijojë parakushtet e duhura për operim të cilat do të siguronin shfrytëzim efikas dhe fitimprurës të burimeve minerare. Planet e prodhimit nuk ishin realizuar sipas planifikimit operativ dhe dinamik, planet e biznesit, raportet vjetore si dhe rregulloret e Njësisë

Biznesore Minierat me Flotacion Kopaonik-Leposaviç nuk ishin miratuar nga Bordi Mbikëqyrës. Teknologjia dhe infrastruktura e vjetërsuar në Trepça Sh.A dhe mungesa e investimeve kapitale ka ndikuar në produktivitet të ulët. Rrjedhjet (humbje) e mëdha të metaleve në steril gjatë procesit të flotimit të xehes ishin rezultat i teknologjisë së vjetërsuar dhe mungesës së investimeve kapitale dhe mos standardizimit të procesit të punës në flotacione. Gjithashtu, Trepça Sh.A. nuk kishte arritur të sigurojë menaxhim optimal të burimeve njerëzore në procesin e prodhimit.

Të hyrat nga qiraja në Agjencinë Kosovare të Privatizimit për periudhën 2012-2021

Agjencia Kosovare e Privatizimit është organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht autonome. AKP ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj dhe të padisë në emër të saj.
Qëllimi i këtij auditimi ka qenë të vlerësohet nëse Agjencia Kosovare e Privatizimit ka menaxhuar si duhet pronat dhe asetet tjera me qira në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Mesazhi i auditimit: *Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk kishte bërë përpjekje të mjaftueshme për të menaxhuar si duhet pronat dhe asetet shoqërore. Mungesa e veprimeve lidhur me menaxhimin e pronave të dhëna me qira nga Agjencia, tregon që sistemi i kontrollit të brendshëm nuk ishte në nivelin e duhur. Si rezultat i kësaj, Agjencia nuk kishte arritur të siguroj rritjen e të hyrave nga prona e dhënë me qira.*

Procesi i qiradhënies së pronave dhe aseteve tjera shoqërore nuk ishte zhvilluar në përputhje me qëllimin e ligjit të Agjencisë për ruajtjen dhe rritjen e vlerës së aseteve të administruara nga ana e sajë. Bazuar në aktet e brendshme, Agjencia në raste të caktuara kishte lidhur kontratë me uzurpuesit apo shfrytëzuesit e paligjshëm. Kishte raste kur ishin dhënë prona me qira pa e përcaktuar qëllimin e shfrytëzimit, ose si rezultat i mungesës së monitorimit prona e dhënë më qira ishte eksploatuar për qëllime të nxjerrjes dhe përpunimit të gurit gëlqeror duke e tjetërsuar në gjendje të pakthyeshme. Kontratat e qiradhënies ishin vazhduar me kushte dhe çmime të njëjta me vite të tëra. Çmimet e disa kontratave krahasuar me prona në zona përreth është vërejtur se ishin më të ulta. Pavarësisht se ishte në kuadër të kompetencave të sajë, Agjencia nuk kishte aplikuar metodën e negocimit direkt për të ndryshuar kushtet eventuale të kontratave, përfshirë çmimet e tyre. Në disa raste, Agjencia nuk kishte mbikëqyrje të pronave të cilat i kishte nën administrimin e saj, dhe si rezultat prona shoqërore ishte shfrytëzuar nga subjekte të cilat nuk kishin fare marrëdhënie kontraktuale me Agjencinë. Po ashtu, në rastet e përdorimit të procedurave të qiradhënies janë vendosur kritere të shpalljes publike jo në pajtim me rregulloren për qiradhënien e aseteve të ndërmarrjeve shoqërore.

Mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nga MINT/KIESA

Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) luajnë një rol shumë të rëndësishëm në ekonomi, dhe në shumicën e rasteve janë titulluar si motorë të rritjes dhe zhvillimit ekonomik të një vendi. Në vitin 2019 këto ndërmarrje në Bashkimin Evropian (BE) zënë vend rreth 99.8% të të gjitha ndërmarrjeve dhe punësonin rreth 64.4% të të punësuarve në ekonominë e BE-së. Në ekonominë e Kosovës ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme përbëjnë shtyllën kryesore të ekonomisë. Këto ndërmarrje përbejnë rreth 99.8% të të gjitha ndërmarrjeve në vend dhe zënë 75.5% të punësimit total në ekonomi të Kosovës.

Qëllimi i këtij auditimi ka qenë të vlerësojmë aktivitetet e MINT-it/KIESA-së për arritjen e rezultateve të duhura në përkrahjen dhe ngritjen e kapaciteteve të NMVM-ve dhe Zonave Ekonomike.

Mesazhi i auditimit: *MINT/KIESA nuk ka arritur rezultatet e duhura në përkrahjen dhe ngritjen e kapaciteteve të NMVM-ve dhe Zonave Ekonomike. Thirrjet publike nuk mbështeten në analiza për nevojat e NMVM-ve, po ashtu sistemi i thirrjeve, vlerësimi dhe monitorimi përcillet me mangësi të theksuara të cilat kanë nevojë për përmirësim. Për më tepër, Zonat Ekonomike të themeluara nuk arrijnë t'i përmbushin nevojat e ndërmarrjeve në vend duke i lënë investitorët të presin me vite për zgjerimin e hapësirave të biznesit dhe rritje të prodhimit dhe të punësimit.*

Mbështetja e ndërmarrjeve mikro, të vogla, dhe të mesme është bërë pa ndonjë analizë te tregut apo politika zhvillimore për përkrahjen e këtyre ndërmarrjeve nga akterët kompetent. Qeveria nuk ka arritur t'i funksionalizojë Zonat e Lira Ekonomike dhe Zonën e Veçantë Amerikane edhe pse i kishte themeluar me vendim. Këto zona janë themeluar nga Qeveria pa e bërë asnjë analizë dhe studim fizibiliteti me të cilat do të argumentonin krijimin e tyre. Thirrjet për mbështetjen e NMVM-ve nuk bazohen në analiza të nevojave dhe ka mangësi në procesin e vlerësimit të aplikacioneve. Projektet nuk monitorohen në vazhdimësi dhe nuk janë zbatuar kriteret e caktuara nga përfituesit si pasojë e mos koordinimit ndërmjet MINT dhe KIESA.

Ndikimi i investimeve kapitale në zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe zgjerimin e shërbimeve tek qytetarët nga KRU-të

Uji është njëri nga elementet kryesore dhe vitale për të gjithë format e jetës e po ashtu edhe për jetën e njeriut. Furnizimi me ujë të pastër, të sigurt dhe me cilësi të mirë është jetik për çdo shoqëri në zhvillim. Në vendin tonë furnizimi me ujë të pijshëm rregullohet përmes autoriteteve publike sikurse është Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit dhe Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit, si ofrues të licencuar për shërbimet e ujësjellësit dhe trajtimin e ujërave të ndotura.

Qëllimi i këtij auditimi ka qenë të vlerësojmë nëse Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit në koordinim me Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit kanë arritur të bëjnë një vlerësim të duhur të nevojave për të realizuar Investimet Kapitale me qëllim të zvogëlimit të humbjeve dhe përmirësimit të shërbimeve të ujit tek qytetarët. Njëkohësisht nëse janë marrë masa nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit dhe Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit se këto Investime Kapitale po realizohen dhe po arrijnë qëllimet e synuara.

Mesazhi i auditimit: *Procesi i planifikimit, realizimit dhe monitorimit të Investimeve Kapitale, nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit dhe Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit nuk është menaxhuar mirë duke ndikuar që objektivat e synuara të mos arrihen me kohë dhe në mënyrën e duhur. Madje, disa nga këto objektiva devijojnë nga ajo çfarë është planifikuar. Mungesa e planifikimit të bazuar në nevoja dhe arsyetim të detajuar, tregon dobësi në prioritizimin e investimeve. Për pasojë ka vonesa të theksuara dhe dështime në realizimin e projekteve duke rezultuar në shfrytëzimin joefektiv të tarifave të qytetarëve. Njëkohësisht si rezultat i kësaj edhe zgjerimi me shërbime të ujit dhe trajtimi i ujërave të ndotura nëpër zonat e shërbimit nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit, vazhdon të përcillet me probleme dhe me një performancë të dobët dhe për këtë qytetarët në zona të caktuara nuk marrin shërbime të ujit nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit. Humbjet e ujit janë evidente dhe nënkuptojnë humbje financiare.*

Kompanive Rajonale të Ujësjellësit iu mungon planifikim i duhur i Investimeve Kapitale, ndërsa Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit aprovon projektet kapitale pa një arsyeshmëri të detajuar dhe bindëse të projekteve dhe pa u caktuar prioritetet nga kompanitë. Tarifat e paguara nga qytetarët për Investimet Kapitale nëpër Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit nuk po shfrytëzohen në mënyrë e duhur. Përderisa, monitorimi i Investimeve Kapitale është në një nivel të ultë nëpër Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit.

Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje

Sipas konventave ndërkombëtare dhuna në familje është njëra nga format e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Dhuna në familje është dukuri që shumicën e rasteve ndodhë jashtë syve të publikut, por pasojat e saj prekin komunitetin më të gjerë dhe është shkaku themelor i një game më të gjerë anomalish sociale. Trajtimi i rasteve të dhunës në familje, bëhet nga një numër i institucioneve si: Policia e Kosovës, Zyra për mbrojtje dhe ndihmë viktimave, Prokuroria themelore, Gjykatat themelore, Qendrat për punë sociale dhe Strehimoret, të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme nëpër faza të caktuara.

Qëllimi i këtij auditimi ishte që të vlerësojmë nëse Institucionet përgjegjëse kanë ndërmarrë aktivitetet dhe masat e duhura për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

Mesazhi i auditimit: *Institucionet përgjegjëse publike kanë ndërmarrë një sërë veprimesh për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, megjithatë nuk janë arritur rezultate të kënaqshme për mbrojtjen e viktimave. Për të siguruar efektivitetin e shërbimeve të ofruara nevojitet një nivel dukshëm më i lartë i përkushtimit institucional. Sistemi shtetëror shfaq mangësi në angazhimin e mbrojtësve të viktimave, shqyrtimin e menjëhershëm të rasteve nga subjektet gjyqësore dhe regjistrimin e saktë të incidenteve të raportuara.. Për më tepër viktimave u mungon mbështetja thelbësore sociale, veçanërisht në aspektin ekonomik. Gjithashtu, ekziston një mungesë e programeve që synojnë trajtimin e shkelësve dhe nxitjen e ndërgjegjësimit të gjerë.*

Policia demonstron reagim të shpejtë gjatë ndërhyrjes dhe shërbimeve emergjente, megjithatë janë vërejtur disa mangësi në përfshirjen e hetuesve policorë, mungesë e procedurave për monitorimin e urdhrave mbrojtës, komunikim joadekuat me avokatët e viktimave dhe mangësi në dokumentacionin e rastit. Institucionet e drejtësisë, veçanërisht gjykatat, shfaqin vonesa në trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Baza e të dhënave kombëtare e destinuar për regjistrimin e rasteve të raportuara të dhunës në familje ende nuk është plotësisht funksionale. Për më tepër, ka një mangësi në këshillimin në grup, programet e trajtimit për kryesit e dhunës dhe udhëzimet për mbrojtjen e familjeve, gjë që ndikon në ndërgjegjësimin e përgjithshëm dhe sensibilizimin e shoqërisë.

1.2 Auditimet e prokurimit

Përmes auditimeve të përformancës me fokus në fushën e prokurimit, Zyra Kombëtare e Auditimit synon të promovojë efikasitetin, efektivitetin dhe në veçanti ekonomicitetin si dhe transparencën e administratës publike. Në këtë fushë janë kryer gjashtë (6) auditime që përfshinë tema të ndryshme. Në kuadër të këtyre auditimeve janë dhënë 57 rekomandime për organizatat e audituara. Në vijim është paraqitur përmbajtja e këtyre raporteve, përfshirë qëllimin, gjetjet dhe mesazhet e auditimit.

Prokurimet e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në vitin 2021

Praktika e nënshkrimit të kontratave aneks është një dukuri e shpeshtë në prokurimin publik, thuajse çdo kontrate për punë pasohet me kontratë aneks. Shpesh, përveç kontratës aneks, për t'u përfunduar një projekt në tërësi Autoriteti Kontraktues duhet të inicioj aktivitet të ri të prokurimit. Vetëm në vitin 2021 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) kishte kontraktuar afër gjashtë milion euro për 26 kontrata aneks, me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, ndërsa ne kemi audituar 13 kontratat aneks që me kosto mbi 4 milion euro. Ky auditim ka mbuluar procedurat e prokurimit për kontratat aneks të cilat MMPHI-ja i kishte lidhur në vitin 2021 si dhe për kontratat bazë të cilat i kishte lidhur në vitin 2018-2019.

Mesazhi i auditimit - *Kontratat aneks të lidhura nga MMPHI-ja nuk ishin të mjaftueshme për të përfunduar projektet që i kishte filluar*; *nuk kanë arritur të përfundohen brenda një kohe të arsyeshme; si dhe dy nga tri projektet që janë përfunduar nuk janë pranuar teknikisht edhe pse janë në dispozicion për qytetarët.*

Kostoja për 13 kontratat aneks që kemi audituar ishte mbi 4 milion euro, ndërsa vetëm për katër nga këto projekte, kostot shtesë e përllogaritur përtej vlerës së kontratave aneks është mbi 4.3 milion euro dhe nuk është definitive sepse ka edhe një projekt tjetër që ka nevojë për punë shtesë. Edhe pse ishin paraparë ditë të caktuara pune, nuk ishin përkufizuar ditët kalendarike brenda të cilave këto ditë pune do të duhej të zhvilloheshin. Kjo ka lënë hapësirë që këto projekte të mos zhvillohen me intensitetin e mundshëm. Projektet, në rastin më të mirë, kanë përfunduar brenda 2.8 viteve ndërsa rasti më të keq kanë kaluar më shumë se 3.8 vite dhe rruga ende nuk është përfunduar (ndërsa ishte planifikuar të përfundohej brenda 200 ditësh pune). Komisionet e pranimit kanë gjetur të meta të konsiderueshme në projektet e realizuara, prandaj ende nuk i kanë pranuar. Komisionet kanë kërkuar përmirësimin e të metave por deri më tani nuk është ndërmarrë asnjë veprim në këtë drejtim, me përjashtim të ndaljes së një shumë në pagesën e secilit situacion, që përbën 23% përkatësisht 15% të vlerës së kontratave.

Shkaqet kryesore që kanë sjellë këtë gjendje janë: pranimi i projekteve jo adekuate nga hartuesit e projektit ose nga komunat, mos rishikimi i mjaftueshëm nga ana e MMPHI; shqyrtime jo adekuate/mungesa e elaborateve gjeo-mekanike dhe gjeodezike për projektet/kontratat për ndërtimin e rrugëve; identifikimi jo i duhur i nevojave gjatë hartimit të projektit dhe ndryshimi i projekteve pas lidhjes së kontratës; dhe, mos caktimi i menaxherëve të përgjegjshëm dhe profesional në zbatimin e detyrave përkatëse të menaxherëve të kontratave.

Ekonomiciteti dhe efikasiteti në ndërtimin e shtëpive për të kthyerit

Republika e Kosovës në vazhdimësi është ballafaquar me shpërnguljen e shtetasve të saj, sidomos gjatë dekadave të fundit. Qëllimi është që Qeveria e Kosovës t'u ofrojë shtetasve të saj mundësi kthimi në vendlindje. Për integrim sa më të lehtë të tyre, hartohen politika të ndryshme të cilat kanë për qëllim krijimin e kushteve elementare për jetesë.

Një nga këto të drejta elementare është qasja në banim. Banimi është çështje vendimtare për stabilitet social, shëndet dhe zhvillim kualitativ të mirëqenies njerëzore. Banimi është e drejtë sociale e qytetarëve në shumicën e vendeve të zhvilluara.

Në bazë të së drejtës ndërkombëtare dhe kornizës ligjore të Republikës së Kosovës (RKS), personave të zhvendosur i 'u garantohet e drejta për t'u kthyer në vendin e origjinës.

Parakusht kryesor për sistemimin e personave të kthyer është ofrimi i përkrahjes që përfshin: rindërtimin e shtëpive (rindërtimin e plotë dhe riparimet e vogla), ndihmat në ushqim, artikujt higjienik, mobile themelore, asistencë për zhvillim ekonomik, gjenerim të të hyrave, punësimi si dhe përkrahja me materiale ndërtimore.

Auditimi ka përfshirë kontratat për ndërtimin e shtëpive nga Ministria për Komunitete dhe Kthim për periudhën 2017-2022 dhe shuma e tyre është mbi 8.2 milion euro. Auditimi përfshinë vlerësimin e nevojave, përcaktimin e vlerës së parashikuar të kontratës, arritjen e ekonomisë gjatë kontraktimit dhe ndërtimit të shtëpive dhe efikasitetin në përmbushjen e këtyre kontratave.

Mesazhi i auditimit -*Auditimi ka konkluduar që Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk ishte ekonomike në kontraktimin e ndërtimit të shtëpive. Mangësitë ishin evidente në vlerësimin real dhe të arsyeshëm të nevojave dhe nuk ishte bërë hulumtimi i çmimeve të tregut.*

Procedurat e prokurimit ishin filluar pa pasur informacionet e duhura për përfituesit dhe statusin e tyre të banimit. Praktika e tillë ishte përsëritur edhe në kontratën e dytë pavarësisht problemeve të hasura në kontratën e parë. Ministria ka kontraktuar ndërtimin e shtëpive për 832,033 euro më shtrenjtë se sa çmimet e tregut. Efikasiteti i përgjithshëm i Ministrisë në ndërtimin e shtëpive për të kthyerit nuk është arritur sepse nuk janë arritur rezultate optimale. Kombinimi i ndërtimeve jashtë planeve sipas projekteve kryesore, mospërputhjet në pozicione, pagesat për punët e papërfunduara dhe progresi i ngadaltë në përmbushjen e kontratës së dytë ka penguar aftësinë e Ministrisë për të siguruar strehim adekuat për të kthyerit.

Renovimi dhe rikonfigurimi i Stadiumit të qytetit në Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë

Infrastruktura sportive adekuate është kushti themelor për përmirësimin e cilësisë së aktiviteteve sportive si dhe ngritjen e sportit në nivelin e standardeve të pranueshme ndërkombëtare. Infrastruktura ka ndikim pozitiv në pjesëmarrje më aktive në sport e që si rezultat ka përmirësimin e shëndetit, produktivitetit dhe mirëqenien e të rinjve të cilët merren me sport. Përgjegjës për të krijuar kushte për aktivitete sportive, janë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve si dhe komunat e Republikës së Kosovës. Ky auditim ka mbuluar tri projekte të renovimit/rikonfigurimit të stadiumeve. Përmes këtij auditimi kemi vlerësuar nëse MKRS së bashku me Komunat e Mitrovicës, Gjilanit dhe Gjakovës ishin efikase në menaxhimin e projekteve për renovimin/rikonfigurimin e stadiumeve.

Mesazhi i auditimit: *Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve së bashku me Komunat Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë nuk ishin treguar efikase në menaxhimin e renovimit dhe rikonfigurimit të stadiumeve. Kjo kishte ndodhur për arsye se nuk ishin siguruar parakushtet e nevojshme me kohë.*

Gjatë renovimit dherikonfigurimit të këtyre stadiumeve nuk janë arritur qëllimet e përcaktuara, pasi që kanë kaluar disa vite (nga katër e deri në shtatë) që nga fillimi i procesit dhe ato përveç që ende nuk kanë përfunduar dhe sipas gjendjes në terren janë larg përfundimit dhe funksionalizimit të tyre. Mos përfundimi i tyre dhe për shkak të ngarkesës të stadiumit të vetëm i cili i përmbush kriteret e UEFA-së, rrezikon që Kombëtarja e Kosovës dhe klubet sportive të detyrohen që ndeshjet me karakter ndërkombëtar t'i zhvillojnë në një shtet të rajonit. Mangësitë kryesore kishin të bëjnë me krijimin e parakushteve siç janë probleme me projektet ideore dhe kryesore, mos shpronësimi me kohë, mos pajisja me leje të ndërtimit dhe mos kategorizimi i duhur.

Funksionimi i sistemit të Grantit të Performancës Komunale dhe menaxhimi i projekteve të financuara nga Donatorët për vitin 2021

Në vitin 2017, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) ishin pajtuar për krijimin dhe financimin e një sistemi të grantit të performancës për komunat. Qëllimi i përgjithshëm i Grantit të Performancës Komunale është nxitja e komunave për të përmirësuar proceset e qeverisjes, të cilat së bashku me kornizën e politikave të përmirësuara çojnë në ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët.

Auditimi ka vlerësuar funksionimin e sistemit të shpërndarjes së granteve përgjatë viteve 2018-2021 dhe zbatimin e projekteve të vitit 2021. Në auditim janë përfshirë MAPL dhe komunat: Drenas, Vushtrri, Skenderaj dhe Lipjan, Mitrovicë e Jugut, Leposaviq, Shtërpcë, Prizren dhe Pejë.

Mesazhi i auditimit: *Auditimi ka konkluduar se funksionimi i Grantit të Performancës Komunale i ndarë në dy qasje (dy burime të financimit) ka rezultuar me mangësi të cilat duhet të ju kushtohet vëmendje. Mjetet e ndara nga MAPL kërkojnë miratim shtesë, regjistrimi i dyfishtë i projektit si investim në vijim, kthimi i mjeteve si suficit dhe mungesa e kritereve për caktimin se cila komunë nga cili burim do të përfitoj. Aktivitetet e prokurimit për projektet e financuara nga Donatorët gjatë vitit 2021 ishin përcjellë me dobësi të ndryshme.*

Mos përfshirja e projekteve në plan të prokurimit, ndarja e tenderëve në LOT-e e cila ka rezultuar me çmime më të larta, mos konfiskim i sigurisë së tenderit, nënshkrimi i kontratave pa caktuar vend punimin paraprakisht dhe dobësi të ndryshme në menaxhimin e kontratave janë disa nga dobësitë që kanë përcjellë zbatimin e projekteve të financuara për vitin 2021. Më tutje, edhe pse rezultatet e synuara për projektet e realizuara janë arritur, komunat nuk kanë dëshmuar mjaftueshëm se kanë integruar grupet e margjinalizuara në këto nisma, përveç në politika lehtësuese e strategji të komunave.

Efikasiteti dhe efektiviteti i Programit për Trajtimin e Pacientëve Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike

Programi për trajtimin e Pacientëve jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike është dizajnuar me qëllim të përkrahjes financiare për qytetarët në shërbimet shëndetësore të cilat nuk mund të ofrohen në institucionet shëndetësore publike. Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e performancës për këtë Program, ku objektiva e auditimit ishte të vlerësoj funksionimin e menaxhimit financiar dhe praktikat e qeverisjes së Fondit për Sigurime Shëndetësore dhe të identifikohen shkaqet rrënjësore të problemeve të përsëritura. Subjekt i Auditimit ishte Fondi për Sigurime Shëndetësore dhe është audituar procesi që nga aplikimi i pacientit e deri te barazimi financiar i pagesës për vitet 2019-2022.

Mesazhi i auditimit - *Fondi për Sigurime Shëndetësore së bashku me Bordin Ekzekutiv nuk ishin efektiv në procesin e menaxhimit të komplet ciklit të subvencionimit të pacientëve për trajtim jashtë institucioneve shëndetësore publike.*

Pacientët nuk ishin trajtuar në mënyrë të barabartë, as në procesin e aplikimit, atë të aprovimit e as në rastet e pagesave në shërbimet shëndetësore që i kanë kryer. Kishte praktika të ndryshme dhe jo konsistente në vlerësimin dhe trajtimin e pacientëve, duke filluar nga aplikimi i kritereve të ndryshme për rastet e njëjta e deri te shuma e ndarë për trajtim. Kishte vonesa edhe në aprovim të lëndëve mirëpo edhe në pagesa të tyre. Obligimet e papaguara dhe detyrimet kontigjente nuk ishin menaxhuar dhe raportuar si duhet dhe nuk ishin bërë të gjitha barazimet financiare me institucionet shëndetësore. Si rezultat i këtyre çështjeve, Fondi së bashku me Bordin Ekzekutiv nuk kishin trajtuar të gjithë pacientët në mënyrë të barabartë, kishte limituar ofrimin e shërbimeve vetëm në institucione/shtete specifike dhe nuk kishte arritur të menaxhoj siç duhet dhe në mënyrë optimale buxhetin.

Shkaqet kryesore që kanë shpi Fondin në këtë gjendje janë: mungesa e kontrolleve adekuate të brendshme, ndryshimet e vazhdueshme organizative dhe mos qartësimi i kornizës ligjore.

Auditimi përcjellës i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit të performancës të publikuara gjatë vitit 2018

Institucionet Supreme të Auditimit (ISA-të) luajnë rol jetik në kërkim të llogaridhënies nga Qeveria në raport me administrimin e fondeve publike. Përveç kësaj, këto të fundit ndihmojnë edhe në ngritjen e transparencës së aktiviteteve të qeverisë.

Qëllimi i rekomandimeve në auditimet e performancës është përmirësimi i procesit të zbatimit dhe funksionimit efektiv të sistemeve, programeve dhe aktiviteteve qeveritare. Rekomandimet i adresohen subjekteve të audituara dhe zbatimi i tyre shërben si mekanizëm për sanimin e këtyre dobësive dhe bërjen e sistemeve më efikase dhe efektive në arritjen e objektivave.

Përmes këtij auditimi kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimeve të performancës të publikuara gjatë vitit 2018 dhe nëse rekomandimet kanë ndikuar në përmirësimin e gjendjes së identifikuar përmes auditimit.

Ky auditim përcjellës fokus kishte fushëveprim 7 raportet e auditimit të performancës të publikuara në vitin 2018. Në këto auditime janë përfshirë 39 subjekte të audituara me 99 rekomandime të dhëna.

Mesazhi i auditimit: *Zbatimi i disa rekomandimeve në nivel individual të subjekteve të audituara në tre nga shtatë raportet e auditimit të performancës ka ndikuar në përmirësimin e gjendjes së identifikuar. Megjithatë, duke e pasur parasysh që rekomandimet për këto raporte janë dhënë në vitin 2018, pra kanë kaluar rreth pesë vite nga gjendja e konstatuar aso kohe, angazhimet e subjekteve të audituara për të zbatuar rekomandimet e dhëna nuk janë të mjaftueshme.*

Auditimi përcjellës ka shpalosur se niveli i zbatimit të plotë të rekomandimeve për shtatë raportet e auditimit të performancës ishte 37%, ndërsa 25% e rekomandimeve janë trajtuar dhe janë në faza të ndryshme të zbatimit të tyre ndërsa pjesa tjetër ose nuk janë zbatuar, nuk janë më të aplikueshme ose edhe nuk kemi mundur t‘i vlerësojmë sepse subjektet e audituara nuk kanë kthyer përgjigje. Nga 123 rekomandime të dhëna, 45 prej tyre janë zbatuar, shtatë janë në fazën finale të zbatimit, dhjetë rekomandime janë duke u zbatuar, pesë rekomandime nuk kanë filluar të zbatohen, 14 rekomandime nuk janë më të aplikueshme për subjektet e adresuara (për 9 nga to përgjegjësitë kanë kaluar në subjekte tjera derisa pesë nuk janë të aplikueshme më), ndërsa për 42 rekomandime nuk kemi marrë përgjigje fare nga subjektet e audituara për të kuptuar nëse është marrë ndonjë veprim apo jo për zbatimin e atyre rekomandimeve.

1.3 Auditimet e TI-së

Zyra Kombëtare e Auditimit po i kushton rëndësi të veçantë edhe auditimeve të teknologjisë së informacionit. Këtë sezonë janë përfshirë sisteme të informacionit me ndikim në institucionet publike dhe shërbimet ndaj qytetarëve. Janë kryer katër (4) auditime në këtë fushë dhe janë dhënë 64 rekomandime për organizatatat e audituara. Në vijim është paraqitur përmbajtja e këtyre raporteve, përfshirë qëllimin, gjetjet dhe mesazhet e auditimit.

Sistemet e Informacionit në Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit-Prishtina

Kompania Rajonale e Ujësjellësit Prishtina është ofruesi më i madh i shërbimit të ujit në Kosovë dhe mbulon rreth 37% të totalit të konsumatorëve në të gjithë Kosovën. Me qëllim të zhvillimit të veprimtarisë së kompanisë dhe arritjes së objektivave të saj, KRU Prishtina ka investuar në vazhdimësi në teknologjinë e informacionit si dhe ka zhvilluar disa aplikacione, duke filluar nga aplikacionet e kontabilitetit, faturimit, faturimit mobil, etj.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e Teknologjisë së Informacionit në Kompania Rajonale e Ujësjellësit Prishtina, me qëllim që të vlerësoj nëse strukturat udhëheqëse të ndërmarrjes sigurohen se burimet e teknologjisë së Informacionit mbështesin qëllimet dhe strategjinë e ndërmarrjes duke ofruar një mjedis efektiv për të ruajtur integritetin e të dhënave dhe vazhdimësinë e sistemeve të TI-së.

Mesazhi auditimit: *Ndërmarrja nuk ka siguruar një mjedis efektiv të kontrollit për të ruajtur integritetin dhe vazhdimësinë e sistemeve të TI-së, duke ndikuar negativisht në arritjen e plotë të qëllimeve të ndërmarrjes dhe duke zbehur besueshmërinë e sistemeve te ndërmarrjes.*

Qeverisja e teknologjisë së informacionit në Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit Prishtina nuk ka rezultuar të jetë efektive. Mungon planifikimi strategjik i TI-së, politikave dhe procedurave si dhe nuk ka vendosur strukturë organizative të TI-së adekuate. Lidhur me sigurinë e informacionit, Ndërmarrja nuk ka ndërmarrë masat dhe nuk ka zhvilluar mekanizmat e duhur në mënyrë që të siguroj se informacioni të mos ekspozohet ndaj kompromet imit dhe zbulimeve të paautorizuara.

Poashtu, ndërmarrja nuk ka siguri të mjaftueshme se mund të vazhdojë operimin e saj duke përdorur teknologjinë e informacionit dhe asetet e saj në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore apo të ngjashme.

Kontrollet hyrëse të aplikacionit nuk janë të vendosura krahas rregullave të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) duke lejuar të futen të dhëna jo të sakta dhe të plota si dhe mungon ndërlidhje mes sistemeve. Aktivitetet e përdoruesve (gjurmët audituese) nuk ishin të plota nëpër sisteme si dhe nuk kishte monitorim të vazhdueshëm të këtyre aktiviteteve.

Menaxhimi i Projekteve për Sistemet e Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit

Agjencia e Shoqërisë së Informacionit është organ qendror i administratës shtetërore që ka përgjegjësi për zhvillimin, zbatimin, mbikëqyrjen e proceseve të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në institucionet e Republikës së Kosovës.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e Teknologjisë së Informacionit për të vlerësuar se si Agjencia e Shoqërisë së Informacionit menaxhon projektet e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe sa është efektive në vlerësimin e projektit përfshirë procesin e inicimit, planifikimit, zbatimit dhe monitorimit. Agjencia e Shoqërisë së Informacionit në vazhdimësi ka zhvilluar projekte të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit me qëllim të digjitalizimit të shërbimeve dhe lehtësimit në qasjen e tyre për institucionet shtetërore dhe qytetarët.

Mesazhi i auditimit: *Procesi i zhvillimit të projekteve të teknologjisë së informacionit nuk është menaxhuar mirë nga Agjencia. Kjo ka ndikuar në mosrealizimin e shërbimeve, në mostrajtimin e duhur të sigurisë së informacionit, duke ndikuar edhe në shpenzime të pa nevojshme dhe dëmtim të buxhetit. Mangësitë e zbatimit të projekteve që janë të ndërlidhura në mes veti si dhe ndërmjet institucioneve kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve për këtë fushë në nivel vendi.*

Menaxhmenti i Agjencisë nuk ka siguruar qeverisje të mirë të teknologjisë së informacionit**.** Nuk ka bërë një analizë të mjaftueshme për të identifikuar nevojat dhe zgjidhur problemet me projektet e reja dhe me prioritet. Ka mungesë të planit të menaxhimit të rrezikut, vonesa në zbatimin e projekteve, orientim jo të mirë të buxhetit dhe është ekspozuar ndaj rrezikut me ndaljen e shërbimeve të internetit për institucionet e Republikës së Kosovës.

Në zhvillimin e projekteve Agjencia ka mangësi në monitorimin dhe komunikimin me palët e interesit në institucionet e Republikës së Kosovës, si dhe nuk ka bërë një vlerësim të rreziqeve dhe planifikim të veprimeve për t'i parandaluar apo zvogëluar ato. Kjo ka ndikuar në mosrealizimin e shërbimeve sipas planit të projektit, si dhe ka paguar rreth 506 mijë euro për shërbime dhe licenca që nuk janë realizuar dhe shfrytëzuar.

Agjencia nuk e ka trajtuar me kujdes sigurinë e informacionit, duke shkaktuar paqartësi në raste te klasifikimit të informacioneve dhe shpalosjen e tyre pa i vlerësuar dhe deklasifikuar ato paraprakisht. Nuk ka specifikuar kërkesën për kufizimin e trafikut nga interkoneksionet rajonale të pasigurta për vendin tonë. Gjithashtu, nuk ka zbatuar nënshkrimin e deklaratës së konfidencialitetit për të gjithë stafin e operatorëve ekonomik që kanë qasje në informacionin dhe infrastrukturën shtetërore të teknologjisë së informacionit.

Sistemi elektronik E-prokurimi

Zhvillimi i sistemit të prokurimit publik është një nga prioritet strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës si pjesë e reformave Kombëtare strukturore dhe në kuadër të Reformës së Administratës Publike. Përdorimi i teknologjisë informative për sektorin publik, e në veçanti për sistemin e prokurimit është një element shtytës për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetetit gjatë zbatimit të ligjit të prokurimit.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e teknologjisë së informacionit, me qëllim që të vlerësoj nëse Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka menaxhuar me efektivitet operacionet e TI-së, që të sigurohet se sistemi elektronik "E-Prokurimi" mbështet në vazhdimësi procesin e prokurimit publik si dhe ruan integritetin e tij.

Mesazhi i auditimit: *Sistemi elektronik "E-Prokurimi" ka ndihmuar në rritjen e efikasitetit, efektivitetit dhe transparencën e zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit publik. Megjithëatë, janë vërejtur mangësi në operacionet e teknologjisë së informacionet të cilat ndikojnë në ruajtjen e vazhdueshme të qëndrueshmërisë dhe integritetit të këtij sistemi.*

Qeverisja dhe operacionet e e-prokurimit. KRPP-ja ka mungesë të burimeve njerëzore profesionale të TI-së si dhe nuk ka ndarje të duhur të detyrave të zyrtarëve ekzistues të TI-së. Kryerjen e detyrave të rëndësishme për funksionin e sistemit e ka të mbuluar me operator ekonomik të jashtëm. Kjo rrezikon që të krijoj varësi ndaj palëve të treta si dhe ekziston një rrezik i brendshëm i humbjes së njohurive të biznesit. Poashtu, nuk ka një regjistër elektronik të problemeve dhe incidenteve të cilat ndodhin, me qëllim të identifikimit dhe mundësinë e trajtimit të tyre.

Kontrollet e hyrëse dhe siguria, në modulet e sistemit e-prokurimi nuk ishin të vendosura kontrollet apo kufizimet e nevojshme si dhe ndërlidhjet me sistemet bazë të Republikës së Kosovë, për parandalimin e procedimit të të dhënave të pasakta, e në veçanti të dhënat e përdoruesve.

Politikat për siguri të informacionit nuk ishin të plota sa i përket menaxhimit të llogarive elektronike. Llogaritë e pa vlefshme apo fiktive nuk identifikoheshin që të pasivizohen apo mbyllen, ndërsa fjalëkalimet ndryshoheshin shumë rrallë nga përdoruesit. Poashtu, përdoruesit në vend të e-mailave zyrtare kishin përdorur emaila private. Rreth 50% e përdoruesve nuk iu janë përmbajtur kushteve dhe termave për përdorimin e sistemit të prokurimit elektronik si dhe udhëzimeve administrative për llogarit elektronike zyrtare.

Për më tepërt, llogarit elektronike si dhe aktivitetet që realizoheshin nga këto llogari nuk monitoroheshin as nga autoritetet kontraktuese që e kanë obligim mirëmbajtjen e përdoruesve të tyre si dhe as nga KRPP-ja si pronare e kësaj platforme.

Hapja e panevojshme e përdoruesve, mungesa e mbylljes së përdoruesve pasiv si dhe mungesa e monitorimit të llogarive të përdoruesve ndër të tjera dobëson punën e platformës së prokurimit elektronik, rrit rrezikun e kërcënimeve të sigurisë së informacionit si dhe rrit mundësinë e keqpërdorimit të llogarive për aktivitete jashtë rregullave të prokurimit publik.

Menaxhimi i sistemeve të informacionit në Institutin Bujqësor të Kosovës

Në pesë vitet e fundit (2017-2022), Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka zhvilluar projekte në Institutin Bujqësor të Kosovës që kanë përfshirë teknologjinë e informacionit dhe komunikimit me qëllim të krijimit të sistemit dhe bazës së të dhënave për inventarizimin e tokave bujqësore, si kërkesë e Institutit.

Instituti Bujqësor i Kosovës (IBK) është institucion publik i cili funksionon nën kontrollin dhe monitorimin e drejtpërdrejt të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Instituti do të jetë subjekt i autorizuar për kryerjen e analizave dhe testeve me qëllim të certifikimit zyrtarë të prodhimeve bujqësore dhe prodhimeve që kanë të bëjnë me bujqësi në Kosovë.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e Teknologjisë së Informacionit për të vlerësuar se si Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përkatësisht Instituti Bujqësor i Kosovës i menaxhon resurset dhe proceset e zhvillimit të projekteve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, për të arritur përmbushjen e qëllimit të Institutit Bujqësor të Kosovës për digjitalizimin e proceseve të saj.

***Mesazhi i auditimit**: Ministria dhe Instituti nuk kanë menaxhuar si duhet projektet e teknologjisë e informacionit në vlerë të përgjithshme 700,766 euro, duke dështuar në përfshirjen e profesionistëve të TI-së në planifikimin, zhvillimin dhe pranimin e projekteve. Rrjedhimisht, janë zhvilluar dy sisteme të ndara në vlerë 567,406 euro për të njëjtin qëllim, për më tepër ato nuk po përdoren. Mungesa e sigurimit të cilësisë, mangësitë në konfigurimin e sistemit dhe mangësitë në sigurinë dhe vazhdimësinë e sistemit të informacionit kanë rezultuar në disa shpenzime të panevojshme dhe dëmtime buxhetore.*

Qeverisja e teknologjisë së informacionit nga Ministria dhe Instituti nuk ka qenë efektive. Ka mangësi të konsiderueshme në identifikimin dhe planifikimin e kërkesave për projektet e TI-së, duke rezultuar në dyfishim të sistemeve të informacionit për inventarizimin e tokës bujqësore dhe një rritje të trefishtë të vlerës së parashikimit të çmimit në krahasim me vlerën e planifikuar. Struktura e TI-së mbetet e papërcaktuar dhe rregulloret për organizimin e brendshëm dhe rolin dhe funksionimin e IBK-së nuk janë përditësuar. Për më tepër, angazhimi i stafit të TI-së në zhvillimin e projekteve të TI-

së është neglizhuar. Për shkak të mungesës së planifikimit të duhur të investimeve, në kuadër të kontratave të ekzaminuara janë bërë shpenzime të panevojshme, së paku 98 mijë euro.

Në zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve Instituti ka mangësi në menaxhimin e kontratës. Menaxheri i kontratës ka miratuar produktet e TI-së që nuk përmbushin specifikimet minimale teknike të përcaktuara në kontratë. Për më tepër, ka mungesë të komisioneve profesionale të pranimit të produkteve të TI-së dhe mungesë të testeve të sigurimit të cilësisë. Menaxhimi i konfigurimeve të sistemeve të informacionit në Institutin Bujqësor të Kosovës gjithashtu ka mangësi në përmbushjen e kërkesave teknike, pasi nuk i kanë respektuar standardet e TI-së për konfigurim dhe siguri të informacionit. Përveç kësaj, nuk është siguruar mbajtja e njohurive të biznesit duke pasur varësi të plotë nga Operatorët Ekonomik. Rrjedhimisht, për shkak të keq menaxhimit të TI-së ka sisteme jofunksionale në Institutin Bujqësor të Kosovës që janë të papërdorshme dhe nuk arrijnë të përmbushin qëllimin e blerjes dhe zhvillimit të tyre.
Siguria e informacionit dhe Plani për vazhdimësinë e biznesit për projektet e TI-së në Institutin Bujqësor të Kosovës nuk ishin trajtuar nga Ministria dhe Instituti. Nuk kanë siguruar mekanizma për ruajtjen e të dhënave dhe vazhdimësinë e funksionimit të sistemeve të informacionit. Kanë mungesë të kontrolleve të qasjes fizike dhe mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore ose të shkaktuara nga njeriu. Për më tepër, ata nuk mbajnë kopje rezervë të sistemeve të informacionit, gjë që rrit ndjeshëm rrezikun e ndërprerjes së sistemit dhe humbjes së të dhënave.

Rekomandojmë Qeverinë

T’i analizojnë rekomandimet të cilat kanë rezultuar nga auditimet e performancës, prokurimit dhe teknologjisë së informacionit si dhe të përgatisin dhe monitorojnë planet e veprimit për zbatimin e tyre. Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve duhet të bëhet duke caktuar dhe mbajtur përgjegjës funksionet përkatëse në organizatë përmes raportimit të rregullt për veprimet përmirësuese.

2. Auditimet e Ndërmarrjeve Publike

Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2022 ka audituar Pasqyrat Financiare Vjetore të 11 Ndërmarrjeve Publike (NP). Prej tyre, shtatë (7) ishin ndërmarrje publike qendrore dhe katër (4) ndërmarrje publike lokale.

Në vitin 2022, Korporata Energjetike e Kosovës sh.a është audituar për herë të parë nga ZKA, ndërsa 10 NP-të e tjera janë audituar edhe gjatë viteve paraprake. Kriteret e përzgjedhjes për auditim të këtyre ndërmarrjeve ishin: madhësia e buxhetit/të hyrave, numri i punëtorëve, kompleksiteti i veprimtarisë së shërbimeve, gjendja jo e mirë financiare, interesi i publikut, etj. Për shkak të përfshirjes së Korporatës Energjetike të Kosovës në planin e auditimit për 2022 dhe kufizimeve në burimet njerëzore, krahasuar me vitin e kaluar nuk janë përfshirë në 2022 nuk janë audituar KRU “Hidroregjioni Jugor”, sh.a dhe KRU “Hidromorava” sh.a.

Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli në ndërmarrjet publike ka nevojë për përmirësime, marrë parasysh që në 10 prej tyre pasqyrat financiare për 2022 përmbanin keqdeklarime materiale dhe si rezultat kemi modifikuar opinionin e auditimit. Po ashtu konkluzioni lidhur me pajtueshmërinë është modifikuar për shkak se ndërrmarjet e audituara në raste të caktuara nuk kishin kryer trankasionet në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Megjithatë, duhet të theksojmë që përkundër mangësive të identifikuara, ndërrmarjet publike kanë bërë progres si në cilësinë e raportimit financiar, përmirësuar performancën financiare dhe kanë zbatuar rekomandimet e auditimit në nivel të kënaqshëm.

Për të përmirësuar proceset ekzistuese të përgatitjes së pasqyrave financiare dhe praktikat aktuale të menaxhimit të Ndërmarrjeve Publike, ne kemi dhënë një numër të konsiderueshëm të rekomandimeve, të cilat janë prezantuar në raportet individuale të auditimit dhe janë adresuar tek personat e ngarkuar me qeverisje të NP-ve, si dhe tek aksionarët e tyre. Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, po ashtu monitoron veprimtarinë e tyre operative gjatë vitit, por edhe aspektin e raportimit financiar, dhe në baza të rregullta informon Qeverinë me situatën e tyre të përgjithshme.

2.1 Opinionet e auditimit dhe çështjet në modifikimin e tyre

Opinionet e auditimit në lidhje me Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të NP-ve, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 33 - Opinionet e dhëna për pasqyra financiare për Ndërmarrjet Publike

Nr.	Subjektet e audituara	NP	Opinioni i auditimit		
			2022	2021	2020
1	Posta e Kosovës. sh.a	Qendror	Pamodifikuar	Kualifikuar	Kundërt
2	Korporata Energjetike e Kosovës sh.a	Qendror	Kualifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
3	Hekurudhat e Kosovës - InfraKos, sh.a	Qendror	Kundërt	Kundërt	Kualifikuar
4	NPH "Ibër - Lepenc" sh.a - Prishtinë	Qendror	Kualifikuar	Kundërt	Kualifikuar
5	Hekurudhat e Kosovës - TrainKos, sh.a	Qendror	Kualifikuar	Kundërt	Kualifikuar
6	Telekomi i Kosovës, sh.a	Qendror	Kualifikuar	Kundërt	Kundërt
7	KRU "Prishtina" sh.a - Prishtinë	Qendror	Kualifikuar	Kundërt	Kundërt
8	KRM "Pastrimi", sh.a - Prishtinë	Lokal	Kualifikuar	Kundërt	Kundërt
9	KRM " Uniteti" sh.a - Mitrovicë	Lokal	Kundërt	Kundërt	Mohim i opinionit
10	Ndërmarrja Publike Banesore sh.a- Prishtinë Prishtinë	Lokal	Kualifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
11	Ndërmarrja Publike "Termokos" sh.a Prishtinë	Lokal	Kundërt	Kundërt	Pamodifikuar

Prej 11 NP-të të audituara në vitin 2022, PFV individuale të tyre kanë rezultuar: një (1) me opinion i pamodifikuar dhe 10 opinione të modifikuar (7 opinione të kualifikuara dhe 3 opinione të kundërta). Krahasuar me vitin 2021, ku opinionet e këtyre NP-ve ishin, 8 të kundërt, 2 të kualifikuar dhe një i pamodifikuar, vërejmë që PFV-të janë të një cilësie më të mirë, për më tepër nga 8 opinione sa ishin të kundërta, këtë vitin janë vetëm tri (3). Pavarësisht që kemi përmirësime, edhe më tutje, PFV-të e NP-ve kanë pasur gabime në raportim dhe shpalosje të informatave të kërkuara në PFV.

Çështjet kryesore që kanë ndikuar në modifikim të opinionit te NP-të qendrore janë:

- Në fushën e pasurive ishin: mos rivlerësimi periodik i pasurive afatgjata, prezantim i pasaktë i pasurive, rezervën e rivlerësimit, investimeve në vijim dhe stoqeve si mungesë e dokumenteve burimore apo e të dhënave kontabël, nënvlerësim i pasurive fikse afatgjata, mos përditësimi dhe mos harmonizimi i regjistrit të pasurive me raportin e inventarizimit.
  Mos rivlerësimi i pasurive kishte ndodhur për shkak se ndërmarrja nuk kishte arritur të nënshkruaj kontratë për rivlerësim të pronave. Ndërsa mos korrigjimi i rezervës së rivlerësimit ka ndodhur në mungesë të informacioneve të plota nga rivlerësimi i fundit të pasurive. Ndërsa mos regjistrimin dhe mos harmonizimin e pasurive, ishin për shkak të mungesës së qarkullimit të informacioneve në mes të departamenteve brenda NP-ve si dhe mos koordinimit në pranimin e dokumentacionit nga donatorët.

- *Në fushën e hyrave operative ishin:* mos zbritja e pagesave të konsumatorëve përkatës për obligimet e paguara si dhe trajtim i gabuar i të hyrave.

Kjo kishte ndodhur në pamundësi për të identifikuar se cilit konsumator mund t'i ngarkohen si dhe dobësive në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ana e zyrtarëve me rastin e regjistrimit dhe prezantimit të tyre.

- *Te të hyrat e shtyra nga grantet ishin:* mos regjistrimi dhe mos prezantimi i granteve, mangësi në pasqyrimin e granteve qeveritare dhe shpalosjeve, si dhe prezantimi jo i saktë i të hyrave të shtyra nga grantet.
  Dobësitë kishin ndodhur për shkak të mos komunikimit të informacioneve ndërmjet njësisë për implementim të projektit dhe zyrës së financave.

- *Tek Pasqyrat Financiare Vjetore ishte:* prezantimi jo i plotë i informacioneve shpjeguese për detyrimet kontingjente dhe mos prezantim i saktë i pasqyrës së rrjedhës së parasë.
  Këto kishin ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve nevojshme të brendshme gjatë procesit të përgatitjes së PFV-ve.

- *Ndërsa te llogaritë e arkëtueshme dhe obligimet e papaguara ishin:* njohje në periudhë të gabuar e llogarive të arkëtueshme për të hyrat nga interesi, si dhe mos përputhje e detyrimeve tatimore në regjistrat kontabël me gjendjen e obligimeve tek furnitorët.
  Këto kishin ndodhur për shkak të mos vëmendjes së mjaftueshme me rastin e regjistrimit të faturave të shitjes në periudhat e duhura kontabël dhe të mos harmonizimit periodik të gjendjes së llogarive të pagueshme më furnitorët.

Çështjet kryesore që kanë ndikuar në modifikim të opinionit te NP-të lokale janë:

- *Në fushën e pasurive:* mungesa e dëshmive mbështetëse për pasuritë afatgjata, prezantimi jo i saktë i Rezervës së rivlerësimit, nënvlerësimi i pasurive afatgjata, njohja e investimeve në vijim si pasuri në përdorim, mos regjistrimi i pasurive të pranuara nga donatorë, mos harmonizimi i regjistrit të pasurive me raportin e inventarizimit, dhe mos rivlerësimi i pasurive të ndërmarrjes.
  Dobësitë në menaxhimin e pasurive kishin ndodhur për shkak të njohurive të pa mjaftueshme të trajtimit të pasurive, mos aplikimit të drejtë të standardeve të kontabilitetit dhe në mungesë të informacioneve të plota nga rivlerësimi i fundit të pasurive.

- *Në fushën e llogarive e arkëtueshme tregtare:* mungesa e dëshmive të llogarive të arkëtueshme si dhe mos barazimi i shënimeve kontabël me të dhënat analitike dhe letër konfirmimeve, mungesa e rregullores si dhe mos provizionimi i llogarive të arkëtueshme, prezantimi i llogarisë së arkëtueshme si borxh i ngrirë.
  Shkaqet kryesore të dobësive në llogaritë e arkëtueshme ishin mungesa e inventarizimit/harmonizimit të gjendjeve të llogarive të arkëtueshme me klientë në baza periodike. Madje trajtimi i një pjese të llogarive të arkëtueshme si borxh i ngrirë, ka ndodhur për shkak të një vendimi në të kaluarën që nuk është i bazuar mbi standardet e trajtimit dhe prezantimit të tyre të saktë dhe të drejtë. Sipas shpjegimeve të zyrtarëve përgjegjës, diferencat/mos konfirmimet rezultojnë nga kontestet gjyqësore në mungesë të dëshmive, kontestit për pronësi, titullarin e borxhit.

- Te llogaritë e pagueshme tregtare ishte mospërputhja në mes të shënimeve kontabël të llogarive të pagueshme dhe letër konfirmimeve.
  Si shkaktar ishte mos aplikimit të harmonizimeve në baza periodike dhe komunikimit jo të mjaftueshëm të kompanisë me furnitorët e saj.

2.2 Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre

Përveç aspektit financiar, ne kemi audituar edhe aspektin e pajtueshmërisë nëse proceset dhe transaksionet janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit dhe kemi dhënë edhe konkluzione të pajtueshmërisë për të gjitha NP-të e audituara.

Konkluzionet e pajtueshmërisë në lidhje me NP-të, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 34 - Konkluzionet e dhëna të pajtueshmërisë për Ndërmarrjet Publike

Nr	Subjektet e audituara	NP	Konkluzioni i pajtueshmërisë		
			2022	2021	2020
1	Posta e Kosovës. sh.a	Qendror	Pamodifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
2	Korporata Energjetike e Kosovës sh.a	Qendror	Kualifikuar	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet
3	Hekurudhat e Kosovës - InfraKos, sh.a	Qendror	Kualifikuar	Kualifikuar	Nuk aplikohet
4	NPH “Ibër - Lepenc” sh.a - Prishtinë	Qendror	Pamodifikuar	Kualifikuar	Nuk aplikohet
5	Hekurudhat e Kosovës - TrainKos, sh.a	Qendror	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
6	Telekomi i Kosovës, sh.a	Qendror	Kualifikuar	Kundërt	Kundërt
7	KRU “Prishtina” sh.a - Prishtinë	Qendror	Kualifikuar	Kundërt	Kundërt
8	KRM “Pastrimi”, sh.a - Prishtinë	Lokal	Kualifikuar	Kundërt	Kundërt
9	KRM “ Uniteti” sh.a - Mitrovicë	Lokal	Kualifikuar	Kualifikuar	Nuk aplikohet
10	Ndërmarrja Publike Banesore sh.a - Prishtinë	Lokal	Kualifikuar	Kualifikuar	Nuk aplikohet
11	Ndërmarrja Publike “Termokos” sh.a - Prishtinë	Lokal	Kualifikuar	Kundërt	Nuk aplikohet

Nga 11 NP-të e audituara, dy (2) konkluzione janë të pamodifikuara (Posta e Kosovës. sh.a dhe NPH “Ibër - Lepenc” sh.a) ndërsa nëntë (9) konkluzione të modifikuara. Sipas tabelës vërehet se rreth 82% të OB-ve kanë konkluzion të modifikuar që tregon se kanë probleme me pajtueshmërinë me autoritetet, apo transaksionet financiare nuk janë në pajtim me kërkesat ligjore.

Vlen të theksohet, që nga krahasimi i të dhënave në tabelën sipër, shihet se Posta e Kosovës sh.a dhe NPH “Ibër - Lepenc” sh.a ka bërë një progres pozitiv në përmirësimin e parregullsive ligjore, duke marrë konkluzion të pamodifikuar. Gjithashtu, vlen të theksohet që Telekomi i Kosovës, sh.a, KRM “Pastrimi”, sh.a, Ndërmarrja Publike “Termokos” sh.a dhe KRU “Prishtina” sh.a po ashtu kanë bërë progres duke marr konkluzion kualifikuar, e që vitin e kaluar kishin konkluzion të kundërt.

Referuar konkluzioneve të pajtueshmërisë, konkluzioni i auditimit është se shumica e ndërmarrjeve publike përkundër progresit gjatë vitit 2022 edhe më tutje kanë pasur parregullsi ligjore kryesisht në fushat për të hyrat operative, pasuritë, shpenzimet e pagave si dhe shpenzimet operative për mallrat dhe shërbime.

Çështjet kryesore që kanë ndikuar modifikimin e konkluzionit të pajtueshmërisë te NP qendrore janë:

- *Në fushën e të hyrave operative janë:* dobësia në menaxhimin e kontratave të qiradhënies; mungesa e instalimit të ujëmatësve, regjistri i konsumatorëve jo në përputhje me rregullat e ARRU-së, mungesa e kontratave me konsumatorë.
  Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së veprimeve konkrete ndër vite nga menaxhmentet e ndërmarrjeve dhe Bordeve Drejtuese, ndërsa shkaku ishte pamundësitë që

të bëjnë instalimin e ujëmatësve për të gjithë konsumatorët, dobësive në regjistrimin e konsumatorëve dhe vështirësive në identifikimin e tyre me rastin e shkarkimit të pagesave nga llogaria bankare.

- *Në fushën e shpenzimet operative dhe shpenzimet e pagave janë:* planifikimi dhe realizimi jo i duhur i planit të prokurimit, nënshkrimi i kontratave pas kryerjes së punëve dhe shërbimeve, mos pagesa e kontributeve pensionale, tatimit në të ardhurat personale dhe obligimeve tatimore, dhe mos përditësimi i kontratave të stafit konform kategorizimit të pagave.
  Shkaqet e dobësive në planifikimin e prokurimeve kanë ndodhur si pasojë e planifikimit jo të duhur nga njësitë kërkuese, shkëputjes së kontratave dhe mungesës së mjeteve për inicimin e procedurave me vlera të mesme dhe të mëdha ashtu siç ishin planifikuar. Po ashtu si shkaqe tjera ishin vështirë financiare të ndërmarrjeve për të paguar obligimet.

- *Te llogaritë e pagueshme ishte* mungesa e identifikimit të pagesave të pranuara nga klientët/konsumatorët e pa identifikuar. Sa i përket shkaqeve te mungesa e identifikimit të pagesave të pranuara nga klientët/konsumatorët e pa identifikuar, kjo kishte ndodhur si pasojë e vështirësive në identifikimin e konsumatorëve me rastin e shkarkimit të pagesave nga llogaria bankare.

Çështjet që kanë ndikuar në modifikimin e konkluzionit të pajtueshmërisë te NP-të lokale janë:

- *Në fushën e Pasqyrave Financiare Vjetore dhe të pasurisë janë:* mos përgatitja e Planit të Biznesit, shitja e pasurive jashtë përdorimit si dhe regjistri i pasurisë jo në përputhje me rregullore.
  Kjo kishte ndodhur në mungesë të vëmendjes së zyrtarëve të ndërmarrjes, mungesës së kontrollit nga niveli menaxherial si dhe pa kujdesia në zbatimin e rregulloreve të brendshme.
- *Te shpenzimet operative dhe shpenzimet e pagave janë*: oferta fituese jo në përputhje me kërkesat/specifikat e kërkuara në dosjen e tenderit, tejkalimi i numrit të punonjësve dhe shpenzimeve të pagave të planifikuara sipas planit të biznesit, punësimi i punonjësve me kontrata me afat të caktuar për punë dhe detyra specifike, pa zhvillim të procedurave të rekrutimit.

  Dobësia në aktivitetet e prokurimit ishin për shkak të dështimit të kontrollit në zyrën e prokurimit dhe për shkak të pa kujdesisë së komisionit të vlerësimit të cilët nuk e kanë trajtuar ofertën sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, dhe nuk ishin trajtuar në mënyrë e duhur.

- *Sa i përket të hyrave operative* është mungesa e kontratave me konsumatorë. Kjo gjendje është bartur ndër vite dhe ekziston për shkak të mos bashkëpunimit të mjaftueshëm nga ana e konsumatorëve të cilat kanë neglizhuar vazhdimisht kërkesat e kompanisë për nënshkrimin e kontratave dhe sjelljen e një kopje në arkivin e kompanisë.

2.3 Obligimet e Ndërmarrjeve Publike për Raportimin Vjetor Financiar

Gjatë këtij sezoni audites kemi evidentuar se 3 nga 11 ndërmarrjet publike të audituara, nuk i kanë përgatitur me kohë Pasqyrat Vjetore Financiare, respektivisht nuk i kanë pasur pasqyrat e aprovuara nga Bordet e tyre drejtuese brenda afatit ligjor 15 mars. Vonesat përtej afateve ligjore në dorëzimin e Pasqyrave Financiare përfundimtare në ZKA ishin nga 9 deri në 48 ditë, dhe pasqyrohen si vijon:

- Ndërmarrja Publike Banesore - Prishtinë, 9 ditë;
- KRU "Prishtina" sh. a. - Prishtinë, 48 ditë; dhe
- Korporata Energjetike e Kosovës sh. a., 42 ditë.

Shpjegimet e menaxhmentit lidhur me vonesat e mësipërme në dorëzimin e pasqyrave ishin për shkak që kompanitë nuk kishin arritur të finalizonin me kohë raportet e inventarizimit të pasurive dhe detyrimeve dhe si rrjedhojë e saj janë bërë korrigjimet e nevojshme në pasqyrat financiare vjetore.

Këto vonesa janë raportuar në të gjitha raportet individuale dhe shpresojmë se viteve në vijim raportimi do të bëhet sipas kuadrit të përcaktuar ligjor.

Analiza e Gjendjes Financiare e Ndërmarrjeve Publike

Ndonëse gjendja financiare e ndërmarrjeve publike më hollësisht mund të kuptohet nga pasqyrat e bashkëngjitura në raportet individuale, në këtë kapitull në mënyrë përmbledhëse janë paraqitur treguesit kryesor të performancës financiare dhe gjendjes së tyre të fund vitit 2022. Për qëllime analize, janë marrë në shqyrtim të hyrat, shpenzimet, rezultati financiar, detyrimet afatshkurtëra dhe detyrimet afatgjata.

Tabela 35 - Treguesit kryesor financiar të ndërmarrjeve publike të audituara për vitin 2022

Nr	Subjektet e audituara	Të hyrat	Shpenzimet	Fitimi/ Humbja	Detyrimet afatshkurtër	Detyrimet afatgjata
1	KEK "Korporata Energjetike e Kosovës" sh. a.	309,655,000	204,538,000	105,117,000	74,840,000	189,432,000
2	Telekomi i Kosovës, sh.a.	52,859,000	56,647,000	(3,789,000)	46,094,000	22,421,000
3	Posta e Kosovës, sh. a. - Prishtinë	10,330,503	11,740,865	(1,410,361)	1,739,778	2,147,607
4	Hekurudhat e Kosovës – Infrakos sh.a.	3,104,732	3,219,394	(114,662)	26,478,741	34,013,896
5	Hekurudhat e Kosovës - Trainkos sh.a.	2,467,692	3,315,936	(848,244)	2,049,681	1,865,352
6	NPH "Ibër - Lepenc" sh. a. – Prishtinë	9,645,079	9,266,006	379,073	2,687,727	3,999,824
7	KRU "Prishtina" sh. a. - Prishtinë	17,295,033	15,829,672	1,465,362	6,796,198	38,703,825
8	KRM " Uniteti" sh. a. - Mitrovicë	2,323,893	2,285,904	37,988	2,726,510	///
9	KRM "Pastrimi", sh. a. - Prishtinë	8,375,937	9,837,459	(1,461,522)	3,524,395	///
10	Ndërmarrja Publike Banesore, sh. a. - Prishtinë	2,692,473	6,997,561	(4,305,089)	193,824	1,321,595
11	NP "Termokos", sh. a. - Prishtinë	9,984,077	8,081,175	1,902,901	2,702,187	35,840,460

Rezultati financiar (fitimi/humbja) - Nga tabela më sipër shihet se nga 11 ndërmarrje publike të audituara, pesë (5) prej tyre kanë operuar me një total të fitimeve prej 108.9 milionë euro. Pra, tre (3) NP te niveli qendror, dy (2) te niveli lokal, ndërsa gjashtë (6) tjerat kanë treguar një total të humbjeve prej 11.9 milionë euro. Pra, me humbje rezultuar katër (4) te niveli qendror, dy (2) te niveli lokal.

Pjesën më të madhe të fitimit e kishte NP te niveli qendror Korporata Energjetike e Kosovës në shumën prej 105 milionë euro apo 96% të totalit të fitimeve, kurse humbjen më të madh e kishte realizuar te niveli lokal Ndërmarrja Publike Banesore dhe te niveli qendror Telekomi i Kosovës në shumën prej 4.3 përkatësisht 3.7 milionë euro apo rreth 68% nga totali i humbjeve.

Sidoqoftë, krahasuar me vitin paraprak në 4 NP vërehet një trend pozitiv në uljen e humbjeve përveç NPB-së, e cila në vitin 2021 kishte performuar me fitim prej 1,013,073 Euro, ndërsa në 2022 ka rezultuar më humbje prej 4,305,089 Euro.

Ndërmarrjet publike që nuk kanë treguar elemente të rritjes materiale të nivelit të humbjes:

- Telekomi i Kosovës, pavarësisht rezultatit më humbje, performanca e tij tregon progres të dukshëm. Ajo ka arritur të zvogëloj humbjen për 6,918,000€, nga 10,707,000€ sa ishte humbja në vitin 2021 (PFV të rishikuara), këtë vit ka rënë në rreth 3,789,000€;
- Iber Lepenci nga 2,961,713€ humbje sa kishte në vitin 2021, këtë vit ka operuar me fitim prej 379,073€;
- KRU Prishtina nga 919,156€ që kishte humbje në vitin 2021 (PFV të rishikuara), këtë vit ka operuar me fitim 1,465,362€.
- Infrakos nga 214,047€ humbje, këtë vit është 114,662€ me humbje, pra me një zvogëlim prej 99,385€.

Detyrimet afatshkurtër - janë obligime financiare që duhet të paguhen brenda një viti dhe klasifikohen si detyrime qarkulluese. Detyrimet afatshkurtër janë: llogaritë e pagueshme, tatimet e pagueshme, kreditë afatshkurtër, dhe detyrimet tjera me afat pagese brenda një viti.

Për 11 ndërmarrjet e audituara, detyrimet afatshkurtër kapin shumën prej 169 milionë euro, që si të tilla duhet të paguhen brenda vitit 2023. Shumicën e këtyre detyrimeve (rreth 86%) e përbëjnë ndërmarrjet publike te niveli qendror: (1) Korporata Energjetike e Kosovës me 74.8 milionë apo 44.1%; (2) Telekomi i Kosovës me 46 milionë apo 27.1%; dhe (3) Infrakos me 26.4 milionë ose 15.6%. Ndërsa pjesën e mbetur prej 22 milionë apo 13.2% e përbëjnë detyrimet afatshkurtëra të 8 subjekteve tjera.

Likuidimi i këtyre detyrimeve, veçanërisht nga HK Infrakos dhe KRM Uniteti është vështirë i arritshëm, për shkak se të hyrat e tyre vjetore janë dukshëm më të vogla se totali i detyrimeve afatshkurtëra. Po ashtu, sipas shifrave të prezantuara në tabelë, të gjitha kompanitë do të kenë sfida serioze në likuidimin e detyrimeve afatshkurtëra.

Detyrimet afatgjata - janë obligime financiare ose detyrime jo qarkulluese të cilat listohen në bilancin e gjendjes si obligime që afatin e pagesës e kanë më të gjatë se një vit. Këtu bëjnë pjesë kreditë për mjete themelore, detyrimet ndaj letrave me vlerë, detyrimet ndaj pengjeve apo hipotekave dhe detyrimet tjera që duhet të paguhen në afat më të gjatë se një vit.

Detyrimet afatgjata për 11 subjektet e audituara në fund vitin 2022 ishin afër 329 milionë euro, apo rreth 48.5% më të larta se detyrimet afatshkurtëra. Meqenëse pasqyra e shpalosjeve përmban shumë mangësi të informatave, ne nuk ishim në gjendje të sigurojmë të dhëna analitike se brenda sa vitesh duhet të kthehen këto detyrime, sa është shuma e tyre që duhet të kthehet gjatë vitit 2023 dhe informata të tjera për kohën e amortizimit të tyre.

Në bazë të rezultateve nga auditimet individuale dhe nga sa u tha më lart, del se problemet te ndërmarrjet publike janë evidente dhe gjendja e tyre financiare është e vështirë. Çështjet kryesore për vëmendje dhe që kërkojnë trajtim janë:

- *Mos respektimi i afateve ligjore për raportim financiar –* Nga 11 ndërmarrjet e audituara gjatë vitit 2022 janë identifikuar vonesa në përgatitjen dhe dorëzimin me kohë të pasqyrave financiare nga ana e menaxhmentit dhe aprovimi i tyre nga Bordet drejtuese. Vonesat e tilla kanë ndikuar edhe në rishikimin e planeve për auditim;

- *Rezultatet e pavolitshme financiare -* Gjashtë (6) ndërmarrje publike kanë pasur rezultat negativ financiar, respektivisht humbje në shumën prej 11.9 milionë euro, kurse pesë (5) kanë arritur rezultat pozitiv financiar me një fitim prej 108 milionë. Fitimet e raportuara më shumë janë rezultat i përshtatjes së pasqyrave në fund të vitit, sesa i ndonjë afarizmi të qëndrueshëm financiar;

- *Shumat e larta të detyrimeve të pa paguara* - Detyrimet totale të pa paguara të këtyre ndërmarrjeve kapin shumën mbi 499 milionë euro, prej të cilave detyrime afatshkurtëra që duhet të paguhen brenda një viti janë rreth 169 milionë euro. Marrë parasysh faktin se të hyrat totale ishin rreth 428 milionë euro, pagesa eventuale e këtyre detyrimeve afatshkurtëra duket mjaft e vështirë. Kur kësaj i shtohen edhe kështet e kredive afatgjata dhe detyrimet tjera që krijohen gjatë vitit 2023, gjendja mund të bëhet edhe më e komplikuar.

2.4 Çështjet tjera të Menaxhimit Financiar dhe të Pajtueshmërisë

Bazuar në raportet e auditimit gjatë këtij sezoni janë identifikuar disa dobësi në fushën e menaxhimin financiar të ndërmarrjet publike. Çështjet të cilat kanë ndikuar te menaxhimi financiar dhe i pajtueshmërisë te ndërmarrjet publike niveli qendror janë:

- *Në fushën e pasurive janë çështjet si,* pronësia e pa definuar e pasurive fikse, trajtim jo i duhur i investimeve në vijim. Kjo kishte ndodhur për shkak të kontesteve pronësore dhe mungesa e vëmendjes së duhur.
- *Në fushën e llogarive të arkëtueshme si:* në tre ndërmarrje kemi vërejtur dobësi në prezantimin e llogarive të arkëtueshme, dhe në një rast kemi vërejtur mos harmonizim periodik me klientët dhe mungesa e dokumenteve burimore. Kjo kishte ndodhur për shkak se ndërmarrja nuk kishte bërë harmonizimet periodike me klientët, dhe për shkak të bartjeve të faturimeve gjatë vitit në mënyrë manuale nga sistemi i departamentit të hyrave në sistemin e kontabilitetit.
- *Në fushën e shpenzimeve janë kryesisht çështjet si:* mbulimi i pozitave me ushtrues detyre, mos pagesa e punonjësve me gradë të njëjtë për pozitën e njëjtë, sistematizimi i punonjësve të kompanisë sipas rregullores së pa aprovuar nga Bordi i Drejtorëve. Si shkak ishte nevoja e mbulimit të vendeve vakante të punës me personel dhe në pamundësi të zhvillimit procesit të rekrutimit si pasojë e procesit të ristrukturimit të ndërmarrjes.

- *Në fushën e prokurimit çështjet kanë të bëjnë me:* procesin e planifikimit të prokurimit, si dhe aktivitete të shpeshta të prokurimit me vlerë minimale. Kjo kishte ndodhur për shkak dobësime në procesin e planifikimit të prokurimit dhe të mos konsolidimit të kërkesave prej njësive kërkuese.

Çështjet kryesore të cilat kanë ndikuar te menaxhimi financiar dhe i pajtueshmërisë te ndërmarrjet publike niveli lokal janë:

- *Në fushën e pasurive janë çështjet si:* mospërputhje në mes të evidencave kontabël të pasurive me raportin e komisionit të inventarizimit të pasurisë. Këto dobësi kishin ndodhur për shkak të mos harmonizimit të shënimeve kontabël me gjendjen pas regjistrimit të pasurive.
- *Në fushën e llogarive të arkëtueshme janë çështjet s*i: faturimi i klientëve pa emërtim të saktë, dobësi në prezantimin e llogarive të arkëtueshme, mungesa e emërtimit te konsumatorëve. Shkaku ishte se për llogarite e arkëtueshme nuk ishin bërë harmonizimet periodike me klientët në baza periodike.
- *Në fushën e shpenzimeve janë kryesisht çështjet si:* pranim-dorëzim i shërbimeve jo me dëshmi përcjellëse, mangësi në menaxhimin e procedurave të konkursit publik dhe dobësi tjera në menaxhimin e personelit, dhe mbulimi i pozitave me Ushtrues Detyre. Shkaku ishte se nuk kishte caktuar zyrtar për mbikëqyrjen e të pranim dorëzim të shërbimeve dhe nuk kishte zhvilluar procedura të rekrutimit për të mbuluar pozitat e rregullta.
- *Në fushën e prokurimit janë kryesisht çështjet si:* ndarje e tenderëve dhe mos aplikimi i procedurës së hapur të prokurimit, si dhe prokurimi i mallrave të përdorura. Kjo ka ndodhur për shkak se ishte mungesa e kërkesave nga njësitë kërkuese, Ndërsa lidhur me procedura të blerjeve të kamionëve të përdorur, ishin realizuar në mungesë të mjeteve financiare etj.

2.5 Rekomandimet e vitit paraprak dhe niveli i zbatimit

Në raportet individuale të 11 NP-ve për vitin 2022, kemi dhënë 134 rekomandime për përmirësimin e secilës fushë ku janë identifikuar mangësi dhe gabime.

Tabela 36 - Numri i rekomandimeve të dhëna të NP-ve në 2022

Ndërmarrjet publike të audituara në vitin 2022	Rekomandime të reja	Rekomandime të përsëritura	Rekomandime pjesërisht të përsëritura	Total rekomandime
Niveli Qendror	32	24	2	58
Niveli Regjional	18	25	1	44
Niveli Lokal	9	21	2	32
Total	59	70	5	134

Në vitin 2022 vërejmë që prej totalit të rekomandimeve të dhëna, 59 janë rekomandime janë të reja, 70 të përsëritura dhe pesë (5) pjesërisht të përsëritura. Kjo tregon që 52% e rekomandimeve janë të përsëritura nga viti i kaluar. Për dallim nga kjo, në raport me vitin e kaluar kemi dhënë 53 rekomandime me pak apo 28%. Në tabelën e mëposhtme i kemi paraqitur rekomandimet e dhëna në vitin 2021 dhe mënyrën e zbatimit të tyre.

Tabela 37 - Numri i rekomandimeve të dhëna të NP-ve në 2021

Ndërmarrjet publike të audituara	Rekomandime të zbatuara	Rekomandime të përsëritura	Rekomandime pjesërisht të përsëritura	Rekomandime të mbyllura	Viti 2021
Niveli Qendror	44	24	2	5	75
Niveli Regjional	41	25	1	1	68
Niveli Lokal	19	21	2	2	44
Total	104	70	5	8	187[20]

Të dhënat e paraqitura në tabelë, tregojnë që ndërmarrjet publike po e kuptojnë rëndësinë e auditimit duke përmirësuar shkallën e zbatimit të rekomandimeve. Nga 187 rekomandime sa janë vitin e kaluar, 58% janë zbatuar, 39% janë të përsëritura dhe 3% janë pjesërisht të përsëritura. Është për të theksuar se progres të dukshëm në zbatimin e rekomandimeve kanë treguar në veçanti 3 ndërmarrje publike, si: Posta e Kosovës me 89% të zbatueshme, Ndërmarrja Publike Banesore 77%, dhe Telekomi i Kosovës 76%.

Rekomandime për Qeverinë, dhe Komisionet e Aksionarëve të NP-ve

- Që t'i forcojnë masat e llogaridhënies ndaj Bordeve Drejtuese dhe menaxhmentit, ku me rastin e shqyrtimit të pasqyrave financiare, të rishikojnë në detaje përmbajtjen e informatave në pasqyrat financiare, dhe të sigurohen se ato janë pa gabime, janë të mbështetura me evidencat kontabël dhe se i përmbushin të gjitha kërkesat e kornizës e zbatueshme të raportimit financiare.
- Që përmes Bordeve Drejtuese ndërmerren masa që procesi i rivlerësimit të kryhet brenda një afati optimal. Duke qenë se arsyeja kryesore për mos kryerje të vlerësimit ishte mungesa e fondeve, Qeveria dhe komunat duhet ta mbështesin financiarisht këtë proces.

Rekomandimet për Qeverinë, dhe Komisionet e Aksionarëve

- Që përmes Bordeve Drejtuese të sigurojnë se raportet vjetore, përfshirë edhe atë financiar, miratohen deri më 15 mars të vitit vijues, të përcaktuara me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, dhe të njëjtën ditë pasqyrat financiare duhet të jenë të gatshme për auditim nga auditori i jashtëm.
- Që përmes Bordeve Drejtuese të sigurojë se të analizohen shkaqet që kanë shkaktuar humbjet e deritanishme, dhe varësisht nga faktorët e identifikuar, të propozohen politikat dhe masat përmirësuese, si dhe të analizohet shuma e detyrimeve të pa paguara, dhe ato të paguhen në mënyrë që të shmangen ankesat/procedurat gjyqësorë nga furnitorët.

[20] Vitin e kaluar janë dhënë 207 rekomandime në të cilat janë përfshirë edhe rekomandimet e KRU "Hidroregjioni Jugor" (8 rekomandime), sh.a dhe KRU "Hidromorava" sh.a (12 rekomandime).

Rekomandimet për Qeverinë

- Që përmes Bordeve Drejtuese të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura/ligjore në mënyrë që të qartësohet statusi i pronave të cilat shfrytëzohen nga ndërmarrjet publike, si dhe të procesi i planifikimit të prokurimit të jetë më gjithëpërfshirës. Po ashtu të siguroj që për pozitat me Ushtrues Detyre të zhvilloj procedura te rekrutimit me qëllim që të plotësohen me kontrata të rregullta dhe të fuqizoj kontrollet e brendshme në mënyrë që të pamundësojnë që punonjësit në pozitat e njëjta të paguhen me grada të ndryshme si dhe respektimin e kërkesave ligjore gjatë zhvillimit të proceduarve të konkursit publik.

Rekomandimet për Qeverinë, Komisionin Komunal të Aksionarëve

- Që përmes Bordeve Drejtuese të sigurojë se pasuritë e ndërmarrjeve harmonizohen me raportet e komisioneve te inventarizimit, të mbikëqyrë në mënyrë pro aktive të procesin e ekzekutimit të kontratave, të ndërmerr veprime korrigjuese që faturimi i klientëve të bëhet saktë. Po ashtu, të analizohet struktura dhe vjetërsia e llogarive të arkëtueshme.

Rekomandime për Qeverinë, dhe Komisionet e Aksionarëve

- Që përmes Bordeve Drejtuese të marrin masat e përgjegjësisë së menaxhmentit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit, me fokus të veçantë përcaktimin e qartë të një plani të veprimit, afatin kohor dhe stafin përgjegjës për adresimin e të gjitha rekomandimeve të ZKA-së.

Kapitulli IV
ZBATIMI I REKOMANDIMEVE

Përmbledhje për zbatimin e rekomandimeve

Rëndësia e raporteve të auditimit qëndron në identifikimin e dobësive në sistemet e qeverisjes, veçanërisht të sistemeve financiare, ndërsa zbatimi i rekomandimeve të auditimit shërben si një mekanizëm për sanimin e këtyre dobësive dhe bërjen e sistemeve më efikase dhe efektive në arritjen e objektivave. Analizat në këtë fushë kanë rezultuar se niveli aktual i zbatimit të rekomandimeve të auditimit nuk është i kënaqshëm.

Pas pranimit të RVA-së për vitin 2021, Qeveria kishte përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

Në nivel të auditimeve individuale, shumica e organizatave buxhetore nuk zbatojnë proces sistematik për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve. Krahasuar me vitin 2021, numri rekomandimeve të dhëna në raportet individuale të organizatave buxhetore është zvogëluar, megjithatë, niveli i zbatimit të rekomandimeve mbetet përafërsisht i njëjtë, ku numri i rekomandimeve të zbatuara plotësisht është në nivel prej 49%, pjesa tjetër e rekomandimeve janë në proces të zbatimit ose nuk janë zbatuar ende.

Ngecjet në zbatimin e plotë të rekomandimeve ndikojnë në përsëritjen e dobësive dhe mangësive të kontrollit dhe përsëritjen sistematike të parregullsive nga viti në vit.

Ndikimi i auditimit, matet me nivelin e zbatimit të rekomandimeve dhe është treguesi më i mirë nëse menaxhmenti po përmirëson proceset ekzistuese dhe kontrollet në fushat ku janë identifikuar parregullsitë. ZKA-ja, përmes auditimeve individuale bën edhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vitin paraprak, duke i pasqyruar qartë fushat në të cilat janë marrë masa dhe veprime përmirësuese, si dhe fushat ku nevojiten veprime shtesë për përmirësime të mëtutjeshme.

Në Raportin Vjetor të Auditimit për RVF-BRK 2022 janë dhënë gjithsej 29 rekomandime, prej tyre 22 për Qeverinë dhe 7 për Qeverinë/Bordet drejtuese /Komisionet e Aksionarëve.

Shtojca I e raportit ofron informata të plota mbi progresin e rekomandimeve të dhëna në RVA-2021, ndërsa Tabela 38 dhe 39 paraqesin statistikat e rekomandimeve për organizatat individuale.

1. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në RVA për vitin 2021

Qeveria e Kosovës në shtator 2021 kishte aprovuar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, ku janë obliguar të gjitha organizatat buxhetore (OB) për zbatimin e tij. I njëjti është dërguar edhe në Kuvendin e Kosovës/KMFP për shqyrtimin e progresit të rekomandimeve.

Në bazë të informatave të mbledhura gjatë procesit të auditimit për pasqyrat e buxhetit si dhe nga auditimet individuale, kemi vërejtur se veprimet e ndërmarra nga ana e Kuvendit të Kosovës, Qeverisë dhe institucioneve tjera, nuk kanë qenë të mjaftueshme për të siguruar një

nivel të kënaqshëm të zbatimit të rekomandimeve.

Nga gjithsej 36 rekomandime të dhëna në RVA-në 2021, prej tyre 5 janë zbatuar, 3 ishin në proces të zbatimit, 21 nuk ishin zbatuar dhe 7 nuk aplikohen më (të njëjtat janë fuzionuar me rekomandime tjera apo nuk janë relevante). Shtojca i paraqet të dhëna të detajuara për rekomandimet e dhëna në RVA 2021.

Moszbatimi i rekomandimeve ka ndikuar që dobësitë dhe parregullsitë e caktuara të përsëriten veçanërisht në fushat, si:

- Mangësitë në përgatitjen e PVF-ve;
- Dobësi në procedurat e prokurimit;
- Mangësi në menaxhimin e pasurisë;
- Mangësi në menaxhimin e të hyrave, shpenzimeve, obligimeve; detyrimeve kontigjente;
- Dobësi në procedurat e subvencioneve; dhe
- Funksionimi jo i mirë i Komiteteve të auditimit dhe NJAB-ve;

2. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale për vitin 2021

Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve është pjesë e procesit të përhershëm të auditimit. Vlerësimi se si dhe sa janë zbatuar ato, bëhet për secilën organizatë buxhetore gjatë auditimit të rregullt dhe rezultatet për vitin paraprak, paraqiten në raportet e auditimit për vitin vijues.
Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur të dhënat për gjendjen e rekomandimeve të vitit 2021 dhe 2020, të cilat janë të kategorizuara sipas organizatave të audituara.
Organizatat e audituara janë ndarë në: Institucione të nivelit qendror[21], Institucione të pavarura[22] dhe Institucione të nivelit lokal (38 Komuna).
Në vijim është paraqitur tabela me numrin e rekomandimeve të dhëna dhe përqindjet e zbatimit të tyre.

[21] Kuvendi i Kosovës, Zyra e Presidentit, Zyra e Kryeministrit, Ministritë, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, Administrata Tatimore e Kosovës, Dogana e Kosovës, fondi i Mirëbesimit dhe ShSKUK.

[22] Në institucionet e pavarura janë përfshirë Universiteti i Prishtinës dhe 28 institucione

Tabela 38 - Zbatimi i rekomandimeve të AP-së për vitin 2021

Subjektet e audituara	Nr. i rekomandimeve në 2021	Rekomandimet që nuk janë të aplikueshme më[23]	Rekomandimet përzbatim	Të zbatura		Pjesërishtë zbatuara		Të pazbatuara	
	Nr.	Nr.	Nr	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Institucionet e nivelit qendror	185	5	180	88	49%	20	11%	72	40%
Institucionet e pavarura	55	1	54	39	72%	3	6%	12	22%
Institucionet e nivelit lokal	409	3	406	186	46%	33	8%	187	46%
Gjithsej rekomandimet	649	9	640	313	49%	56	9%	271	42%

Tabela 39 - Zbatimi i rekomandimeve të AP-së për vitin 2020

Subjektet e audituara	Nr. total i rekomandimeve në 2020	Rekomandimet që nuk janë të aplikueshme më	Rekomandimet për zbatim	Të zbatura		Pjesërishtë zbatuara		Të pazbatuara	
	Nr.	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Institucionet enivelit qendror	**237**	28	209	123	59%	14	7%	72	34%
Institucionet e pavarura	**46**	2	44	31	71%	1	2%	12	27%
Institucionet enivelit lokal	**371**	8	363	152	42%	15	4%	196	54%
Gjithsej rekomandime	654	38	616	306	50%	30	5%	280	45%

Siç shihet edhe nga tabelat më lart, niveli i zbatimit të rekomandimeve në vitin 2021 në raport me vitin 2020 është afërsisht i njëjtë.

Në përgjithësi, organizatat buxhetore përgatisin plane të veprimit për zbatim të rekomandimeve, megjithatë nuk ndjekin ndonjë proces formal të monitorimit, vlerësimit apo raportimit mbi shkallën e progresit. Kjo pasqyron mungesën e përgjegjësisë për të siguruar që rekomandimet zbatohen me kohë dhe pengesat për veprim, identifikohen dhe adresohen.

Në mënyrë që situata të përmirësohet, nevojitet rritje e përkushtimit dhe llogaridhënies nga personat përgjegjës dhe monitorimi i rregullt i zbatimit të rekomandimeve nga të gjitha OB-të.

[23] Rekomandimet që nuk janë të aplikueshme më – rrjedhin si rezultat i fuzionimit të tyre apo ndryshimeve të akteve ligjore

3. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna OB-ve nga KMFP për vitin 2021

Komisioni për mbikqyrjen e financave publike (KMFP) kishte dhënë rekomandime për 10 raporte të auditimit të shqyrtuara. ZKA ka trajtuar zbatimin e këtyre rekomandimeve të dhëna nga Komisioni, ku nga 34 rekomandime të dhëna, 9 ishin zbatuar, 6 në proces të zbatimit dhe 19 nuk ishin zbatuar. Shtojca II paraqet të dhëna të detajuara për rekomandimet e dhëna nga KMFP.

Rekomandim për Qeverinë


Qeveria duhet të vendos një proces efektiv të monitorimit të zbatimit të rekomandimeve. Me OB-të, t'i diskutoj të gjitha masat efektive që mund ta përmirësojnë procesin, në veçanti fuqizimin e masave që forcojnë llogaridhënien dhe parandalojnë ngecjet në zbatimin e rekomandimeve.

Shtojca I: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në RVA 2021

Legjenda: 

I zbatuar | Pjeserisht i zbatuar | I Pazbatuar | Nuk është i aplikueshëm

	Institucioni përgjegjës	Rekomandimet e dhëna në RVA-në 2021	Statusi
1	Kuvendi i Kosovës	Të forcojë kontrollet mbikëqyrëse kundrejt Qeverisë, para se të miratojë Ligjin vjetor të ndarjeve buxhetore për vitin vijues, në mënyrë që të sigurohet se të gjitha shpenzimet janë planifikuar në kategoritë ekonomike adekuate, sipas kërkesave të LMFPP-së dhe SNKP-ve.	Nuk është i aplikueshëm  *Është fuzionuar në rekomandimin te nënkapitulli nr. 5.2.1.*
2	Qeveria e Kosovës	Përmes MFPT-së të sigurojë se janë përmbushur kërkesat për raportim të saktë dhe të vërtetë edhe në pasqyrat e shpalosjeve.	I pazbatuar 
3	Qeveria e Kosovës	Përmes MFPT-së të vazhdojë forcimin e kontrolleve buxhetore, në mënyrë që të pamundësoj keqklasifikimet buxhetore.	I pazbatuar 
		Analiza e buxhetit të shtetit	
4	Qeveria e Kosovës	Të sigurojë përmes MAPL-së vendosjen e mekanizmave për zbatimin e ligjeve për mbledhjen e të hyrave për komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, dhe Zubin Potok. Inkasimi i këtyre të hyrave do të mundësonte realizimin e më shumë projekteve, rrjedhimisht edhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve të komunave përkatëse.	Nuk është i aplikueshëm  *Për vitin 2022 nuk janë audituar këto komuna për të vlerësuar.*
5	Qeveria e Kosovës	Qeveria duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për angazhimin e të punësuarëve duke siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë, si dhe monitorim të vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.	Pjesërisht i zbatuar 
6	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Ministri duhet të siguroj që pas ratifikimit të marrëveshjeve në Kuvendin e Kosovës, me rastin e bartjes së fondeve në SIMFK, numri i huamarrjes së ratifikuar të lidhet me kod të projektit, në mënyrë që pagesat për projektin përkatës të jenë të dallueshme dhe të evitohen tejkalimet e shpenzimeve dhe raportimet jo të drejta në PFV.	I zbatuar 
7	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Të sigurojë që planifikimi i projekteve kapitale i nënshtrohet një analize të kapaciteteve të organizatës për menaxhimin e projekteve në përputhje me planet fillestare. Kontrollet në planifikimin e projekteve dhe realizimin e buxhetit duhet të forcohen me qëllim të realizimit të projekteve me kohë dhe arritjes së objektivave. Një harmonizim i rrjedhës së parasë me planifikimin e projekteve është i domosdoshëm për të adresuar nivelet e ulëta të realizimit financiar të projekteve ka pitale	I pazbatuar 

8	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Në koordinim me Ministrat të instalojnë mekanizma mbikëqyrës për të siguruar zbatimin e projekteve dhe raportimin në MFPT konform kërkesave ligjore në lidhje me ecurinë e realizimit të projekteve me financim nga huamarrja.	Nuk është i aplikueshëm  *Është fuzionuar te rekomandimi i nënkapitullit nr. 4.*
		Analiza e Shënimeve Shpjeguese	
9	Qeveria e Kosovës	Qeveria duhet të siguroj që para se të merren vendimet për huamarrje, të bëhen analiza të hollësishme nëse ekzistojnë të gjitha parakushtet dhe janë bërë përgatitjet e duhura për inicimin e procesit të huamarrjes dhe shfrytëzimin sa më efikas të këtyre fondeve. Po ashtu, duhet të shqyrtoj në baza të rregullta raportet vjetore të MFPT-së për borxhet publike dhe t'i përdor ato në diskutimet gjithëpërfshirëse kur vlerëson rezultatet dhe pengesat në proces.	I pazbatuar 
10	Qeveria e Kosovës	Ngecjet apo dështimi në mos fillimin apo mos realizimin e projekteve, duhet të jenë subjekt i shqyrtimeve të vazhdueshme me organizatat zbatuese të projekteve përkatëse ku analizohen shkaqet dhe arsyet që pasqyrojnë ndërmarrjen e veprimet konkrete në reduktimin/eliminimin e tyre në mënyrë që të njëjta të realizohen dhe të rezultojnë me përfitime publike në dobi të qytetarëve.	I pazbatuar 
11	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Bazuar në raportet tremujore të Thesarit, MFPT-ja në bashkëpunim me ministritë e linjës duhet t'i adresoj të gjitha sfidat e identifikuara, në zbatimin e projekteve që financohen nga huamarrjet. Në çfarëdo kohe dhe në të gjitha rastet kur vlerësohet e nevojshme, MFPT-ja duhet t'i sugjeroj Qeverisë masat e duhura për tejkalimin e këtyre sfidave.	I pazbatuar 
12	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Të ofroj udhëzime të qarta për organizatat buxhetore për përfshirjen e planeve të investimeve kapitale që do të financohesn nga huamarrjet. Miratimi i projekteve duhet të bëhet vetëm nëse ato kanë kryer të gjitha përgatitjet dhe ofrojnë siguri të mjaftueshme dhe të dokumentuar se realizimi i këtyte projekteve do të bëhet në kohën dhe mënyrën e duhur.	I pazbatuar 
		Pasuritë	
13	Qeveria e Kosovës	Qeveria përmes MFPT duhet të siguroj trajnime të mjaftueshme për zyrtarët e pasurisë dhe ZKF lidhur me procesin e regjistrimit të pasurive dhe prezantimin e saktë të tyre në Pasqyra financiare individuale.	I pazbatuar 
14	Qeveria e Kosovës	Qeveria përmes MPB duhet të siguroj mirëmbajtjen e vazhdueshme të sistemit e-pasuria në mënyrë që sistemi të jetë funksional duke siguruar përditësimin e plotë dhe të saktë të pasurive	I zbatuar 
15	Qeveria e Kosovës	Qeveria përmes MFPT/Thesarit duhet të siguroj kontrolle formale në veçanti lidhur me raportimin e pasurive kapitale dhe jo kapitale dhe për diferenca të theksuara të kërkoj sqarime shtesë nga organizatat buxhetore.	I zbatuar 
		Llogaritë e Arkëtueshme	
16	Qeveria e Kosovës	Qeveria në koordinim me MFPT dhe MAPL duhet të rivlerësojë mekanizmat aktual për inkasimin e borxheve, strukturën e tyre, vjetërsinë si dhe gjasat për t'i inkasuar këto borxhe duke krijuar mekanizma efektiv për mbledhjen e tyre. Po ashtu, duhet siguroj raportimin dhe konsolidimin e plotë dhe të saktë të llogarive të arkëtueshme.	I pazbatuar 
		Detyrimet e Papaguara dhe ato Kontigjente	

17	Qeveria e Kosovës	MFPT duhet të vendos kontrolle përmes monitorimit të raporteve të detyrimeve të papaguara nga OB-të dhe aty ku vëren devijime nga afatet ligjore të ndërmerren masa.	I pazbatuar
18	Qeveria e Kosovës	Që përmes Ministrisë së Drejtësis (Avokaturës shtetërore) dhe në koordinimin me zyret ligjore të organizatave buxhetore të verifikoj vlerën e saktë dhe të plotë të detyrimeve kontingjente në mënyrë që shpalosjet në RFV-të të jetë të sakta. Aty ku ekzistojnë mospërputhje të shënimeve, të identifikohen arsyet e këtyre gabimeve dhe të njëjtat të korigjohen.	I pazbatuar
		Pageasat Sipas Nenit 39.2 të LMFPP	
19	Qeveria e Kosovës	Që përmes institucioneve relevante të shqyrtoj obligimet dhe përgjegjësitë e OB-ve që burojnë nga marrëveshjet kolektive dhe të ndërmarrin veprimet përkatëse. Në varësi të këtyre obligimeve dhe mundësive buxhetore, të siguroj që organizatat buxhetore bëjnë planifikimin adekuat të buxhetit, në mënyrë që të shmangen shpenzime të panevojshme nga proceset eventuale gjyqësore si pasojë e mos përmbushjes së obligimeve eventuale që burojnë nga këto marrëveshje.	I pazbatuar
20	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Ministri në koordinim me drejtorin e Thesarit duhet të siguroj që gjatë ekzekutimit të pagesave bazuar në vendimet gjyqësore/përmbarimore, të bëhet ndarja e shpenzimeve shtesë të procedurave përmbarimore nga shuma e borxhit kryesor sipas kodeve ekonomike të parapara me planin kontabël.	I pazbatuar
		Sistemi i Auditimit të Brendshëm	
21	Qeveria e Kosovës	Që përmes MFPT (NJQHAB) të sigurojë se OB të cilat janë të obliguara të themelojnë NjAB-në sipas rregullores QRK-nr. 01/2019, duhet ta formojnë këtë njësi, përmes së cilës do të sigurohet funksionimi efikas dhe efektiv i sistemit të kontrollit të brendshëm. Po ashtu, OB-të që nuk janë të obliguara të kenë NjAB-në, shërbimet e auditimit të brendshëm t'i realizojnë përmes mënyrave tjera të parapara me këtë rregullore.	I pazbatuar
22	Qeveria e Kosovës	Po ashtu, përmes MFPT (NJQHAB) të sigurojë se OB-të sipas kërkesave ligjore themelojnë Komitetet e Auditimit për të mbështetur realizimin e objektivave të NjAB-së, dhe që këto Komitete të jenë efektive në mbajtjen e takimeve, në raportime vjetore siç kërkohet me UA dhe të kontribuojnë në rritjen e llogaridhënies dhe forcimin e rolit të AB-së.	Pjesërisht i zbatuar
		Prokurimi	
23	Kuvendi i Kosovës	Kuvendi përmes mekanizmave mbikëqyrës të siguroj se aktivitetet e prokurimit ofrojnë konkurrencë dhe transparencë në mesin e ofertuesve sipas kërkesave ligjore dhe përdorimit të procedurave adekuate të prokurimit për të siguruar kontrata më ekonomike.	Nuk është i aplikueshëm
		Çështjet e Ndërlidhura me Shpenzimet për Menaxhimin e Pandemisë COVID -19	
24	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Thesari të siguroj se OB-të respektojnë rregullat me rastin e përgatitjes së PFV- ve për vitin 2022 duke i përfshirë shpenzimet për menaxhimin e pandemisë Covid-19.	I zbatuar
		Auditimet e Performancës	
25	Kuvendi i Kosovës	Përmes Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike komisioneve relevante për fusha përkatëse, të shqyrtojnë raportet e auditimit të performancës, prokurimit dhe teknologjisë së informacionit dhe të mbajnë llogaridhënës krerët e institucioneve publike për zbatimin e	I zbatuar

		rekomandimeve të auditimit.	
26	Qeveria, kuvendet komunale	T'i analizojnë rekomandimet të cilat kanë rezultuar nga auditimet e performancës dhe teknologjisë e informacionit si dhe të përgatisin dhe monitorojnë planet e veprimit për zbatimin e tyre. Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve duhet të bëhet duke caktuar dhe mbajtur përgjegjës funksionet përkatëse në organizatë përmes raportimit të rregullt për veprimet përmirësuese	I pazbatuar 
		Ndërmarrjet Publike	
27	Bordet Drejtuese dhe Komisionet e Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike	Bordet drejtuese dhe menaxhmenti, duhet që me saktësi t'i përmbahen nenit 31.3 të Ligjit nr. 03/L-87 për Ndërmarrjet publike i cili përcakton se: "30 ditë pas pranimit të raportit vjetor, Bordi i Drejtorëve duhet ta shqyrtojë, ndryshojë dhe siç e sheh të arsyeshme ta miratojë raportin vjetor". Kjo nënkupton se raportet vjetore, përfshirë edhe atë financiar, duhet që nga ana e Bordeve të miratohen deri më 15 mars, dhe të njëjten ditë pasqyrat financiare duhet të jenë të gatshme për auditim nga auditori i jashtëm.	I pazbatuar 
28	Bordet Drejtuese dhe komisionet e Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike	Bordet drejtuese, me rastin e shqyrtimit të Pasqyrave financiare, të rishikojnë në detaje përmbajtjen e informatave në pasqyrat financiare, dhe të sigurohen se ato janë pa gabime, janë të mbështetura me evidencat kontabël dhe se i përmbushin të gjitha kërkesat e kornizës së raportimit financiar.	I pazbatuar 
29	Bordet Drejtuese dhe Komisionet e Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike	Komisionet përkatëse të aksionarëve duhet t'i forcojnë masat e llogaridhënies ndaj Bordeve Drejtuese dhe manaxhmentit se përse Pasqyrat financiare nuk përgatiten dhe aprovohen me kohë, dhe përse raportimi financiar nuk ishte në pajtim me standardet përkatëse. Komisionet e aksionarëve, po ashtu, duhet që pa vonesë t'i plotësojnë vendet pozitat e antarëve të përkohshëm të Bordeve drejtuese dhe menaxherëve të lartë në mënyrë që të evitohen të gjitha boshllëqet në strukturat drejtuese të ndërmarrjeve	Nuk është i aplikueshëm  *Është fuzionuar në rekomandimin te kapitulli III pika 2.*
30	Qeverinë, Bordet Drejtuese dhe Komisionet e Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike	Të ngriten masat e përgjegjësisë së menaxhmentit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit, me fokus të veçantë rekomandimeve me prioritet të lartë.	Pjesërisht i zbatuar 
31	Bordet Drejtuese dhe Komisionet e Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike	Të analizohet performanca financiare dhe shkaqet që kanë shkaktuar humbjet e deritanishme, dhe varësisht nga faktorët e identifikuar, të propozohen politikat dhe masat përmirësuese.	I pazbatuar 
32	Bordet Drejtuese dhe Komisionet e Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike	Të analizohet struktura e detyrimeve të pa paguara, duke vendosur prioritetet e pagesave varësisht nga vjetërsia e detyrimeve, rëndësia e furnitorëve strategjik për kompaninë si dhe nevoja për të hyrë në detyrime të reja. Qeveria dhe aksionarët tjerë (komunat) ka nevojë të intervenojnë me subvencione shtesë për t'i shpëtuar këto ndërmarrje nga falimentimi, pasi të njëjtat ofrojnë shërbime publike vitale për qytetarët.	Nuk është i aplikueshëm  *Është fuzionuar në rekomandimin te kapitulli III pika 2.* .
33	Bordet Drejtuese dhe Komisionet e Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike	Të analizohet në hollësi struktura e llogarive të arkëtueshme, vjetërsia e llogarive, veprimet e marra për inkasim, aftësia e klientëve për të paguar, si dhe të bëhet pastrimi i llogarive të dyshimta që mbahen në evidenca prej shumë vitesh, dhe nuk kanë gjasa të inkasohen. Gjithsesi përparësi duhet të ketë inkasimi i faturimeve brenda 12	I pa zbatuar 

		muajve të fundit, sepse po që se procedurat përmbarimore nuk janë filluar më heret, gjasat për inkasimin e borxheve më të vjetra se një vit, janë minimale dhe si të tilla kanë rrezik të jenë parashkruar dhe të mos inkasohen kurrë.	
34	Bordet Drejtuese dhe Komisionet e Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike	Të ndërmerren masa që procesi i rivlerësimit të kryhet brenda një afati optimal. Duke qenë se arsyeja kryesore për mos kryerje të vlerësimit ishte mungesa e fondeve, Qeveria dhe komunat duhet ta mbështesin financiarisht këtë process.	I pazbatuar 
		Zbatimi i rekomandimeve	
35	Kuvendin e Kosovës	Të siguroj që plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve i përgatitur nga Qeveria, është shqyrtuar nga KMFP-ja. Këto plane duhet të përcaktojnë saktë veprimet, afatet kohore dhe personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve dhe monitorimin e tyre. Po ashtu, të siguroj që së paku dy herë në vit KMFP-ja ka shqyrtuar progresin e arritur në zbatimin e rekomandimeve të dhëna.	Nuk është i aplikueshëm 
36	Qeverinë e Kosovës	Qeveria duhet të vendos një proces efektiv të monitorimit të zbatimit të rekomandimeve. Me OB-të, t'i diskutoj të gjitha masat efektive që mund ta përmirësojnë procesin, në veçanti fuqizimin e masave që forcojnë llogaridhënien dhe parandalojnë ngecjet në zbatimin e rekomandimeve.	I pazbatuar 

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga KMFP pas shqyrtimit të raporteve të auditimit

	Institucioni përgjegjës	Rekomandimet e dhëna nga Komsioni për Mbikqyrjen e Financave Publike	Progresi në zbatimin e rekomandimeve
		Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të MASHTI-it për vitin 2020	
1	MASHTI & MFPT	MASHTI dhe MFPT të analizojë mundësitë e pavarësimit të përgjithshëm të gjashtë Universitetet Publike dhe të Qendrës së Studentëve, të cilat akualisht funksionojnë si programe në kuadër të MASHTI-it.	I pazbatuar
2	MASHTI & MPB	MASHTI dhe MPB të përmbyllin punët për të gjitha projektet, për të cilat kanë ekzistuar paraprakishtë marrëveshje të bashkëpunimi me MPB-në.	I pazbatuar
3	MASHTI	MASHTI të hartojë listën e zezë të operatorëve ekonomik të cilët nuk kanë përmbushur obligimet e tyre kontraktuale dhe si pasojë në shumë projekte ka patur vonesa të mëdha. Kjo listë të ndahet me AQP dhe me të gjitha OB-të në nivel vendi.	I pazbatuar
4	MASHTI	Të krijohet mekanizëm më i koordinuar mbikqyrës me komunat në lidhje me investimet kapitale në veçati tek ndertimet e shkollave.	I pazbatuar
5	MASHTI	Përmirësimi dhe avansimi i sistemit aktual SMIAL (aspekti teknologjik) në menyre që mos të mund të nderhyhet ne sistem ose të mbesin gjurme se kush ka bere nderhyrje në system	I pazbatuar
6	MASHTI	Porosia e librave të bëhet me kohë dhe mos të ketë vonesë gjithmonë duke u bazuar në numrin e nxënësve të regjistruar në sistemin SMIAL si dhe të ketë fond rezervë deri 10% të librave.	I pazbatuar
		Shqyrtimi i raportit të auditimit për Pasqyrat vjetore financiare-të të RTK=së për vitin 2021	
1	RTK	RTK të ndaloj kontraktimin e produksionit të jashtëm për lloje të emisioneve që mund ti mbulojë me staf të brendshëm.	I zbatuar
2	RTK	Bordi i RTK-se te definoje qarte ne rregullore avancimin, shperblimin e puntoreve duke u bazuar ne kritere te qarta te vleresimit te performances.	I pazbatuar
3	RTK	Bordi i RTK - se dhe drejtori duhet te forcojne mekanizmin ligjor dhe financiar sepse ne mungese te zyrtareve ligjor RTK rrezikon që si pale e paditur te humb miliona euro.	I zbatuar

		Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të UP-së për vitin 2021	
1	UP	Planifikimi buxhetor që bëhet për investimet kapitale në UP, procesi të jetë gjithëperfshires për të gjitha njesitë akademike e që përfshin zhvillimin e buxhetit nga poshtë-lartë dhe se kërkesat buxhetore duhet t'i paraprijë një analizë e mirfilltë. Të përfshihet në planin strategjik orientimet për investimet kapitale në Universitetin e Prishtinës i cili i skadon afati në vitin 2022. Ka qenë planifikimi për vitet (2020-2022	I zbatuar
2	UP	Rektorati i Universitetit të Prishtinës ti angazhojë të gjitha kapacitetet ligjore, nese ka mungesë të angazhojë ekspert të jashtëm ose ta angazhojë Avokatin e Popullit në mënyrë që të bëjë përfaqësim kualitativ ligjor në seancat gjygjësore në lidhje me çështjen e Kishës Ortodokse Serbe e ndërtuar në Kampusin e UP-së.	I pazbatuar
3	UP	Rektori duhet ti intensifikojë punët dhe të kërkojë raportim 6 mujor nga komisioni i formuar, nëse është nevoja të themelohet edhe komision i ri ndërinstitucionalë në menyrë që të definohet pronësia e pronave të UP-së me Komunën e Prishtinës, kufijtë kadastral, kalimi i atyre pronave në pronësi të UP-së, si dhe regjistrimi në gjeoportalin shtetëror.	I pazbatuar
		Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të NPH "Ibër Lepenci" sha për vitin 2021	
1	NPH Ibër Lepenci sha	NPH "Ibër - Lepenc" sh. a duhet të bëjë publikimin e të gjitha raporteve financiare dhe atyre të auditimit të ndërrmarrjes, prej vitit 2008 e deri tani.	I zbatuar
		Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Fondit për Sigurime Shëndetësore për vitin 2021	
1	MSH & FSSH	Ministri i Shëndetësisë dhe Bordi drejtues i FSSH-ë, të shikojë mundësinë e ndryshimit të udhëzimit administrativ 03/2017, për trajtimin mjekësor të pacientëve jashtë institucioneve publike shëndetësore. Të forcohen mekanizmat mbikëqyrës të FSSH-së me qëllim të përditësimit të kritereve, shërbimeve shëndetësore, çmimores, listës së llojeve të sëmundjeve si dhe rregullimit të mënyrës së raportimit, duke filluar nga komisionet konziliare të SHSKUK-së, Komisioni vlerësues dhe Bordit Ekzekutiv të Fondit për Sigurime Shëndetësore.	Pjesërisht i zbatuar
2	FSSH	Menaxhmenti i FSSH-së, të bëjë barazimet e rregullta të pagesave me spitalet private, brenda dhe jashtë vendit, si dhe të krijohet një data bazë në lidhje me Institucionet të cilat nuk japin informacione kthyese për trajtim të pacientëve, në mënyrë që të ketë një listë të zezë të institucioneve shëndetësore që nuk japin informacione kthyese.	Pjesërisht i zbatuar

3	FSSH	Bordi drejtues dhe menaxhmenti i FSSH-së të kenë evidencë të saktë të obligimeve të papaguara me spitalet si brenda ashtu edhe jashtë vendit.	I pazbatuar 
4	FSSH	Bordi drejtues të ndërtojë mekanizma për zvogëlim apo eliminimin e tërësishëm të listës së pritjes së pacientëve.	Pjesërisht i zbatuar 
5	MSH & FSSH	Ministri i Shëndetësisë dhe Bordi drejtues i FSSH-së të rregullojë, komunikimin ndërinstitucionalë, dhe të vendos linjë të rregullt të komunikimit zyrtar me të gjitha institucionet shëndetësore ofruese të shërbimeve, dhe të zhvillojë forma elektronike për të monitoruar rrjedhën e shpenzimit të mjeteve financiare.	Pjesërisht i zbatuar 
6	FSSH	Komisioni i barazimeve të merret me barazimet e të dhënave me spitalet si brenda ashtu edhe jashtë vendit.	I zbatuar 
7	FSSH	Të shikohet mundësia e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit të Prokurimit Publik që ka të bëjë me shërbime shëndetësore private, në mënyrë që për këto shërbime të konkurrohet sipas çmimit më të lirë, dhe në momentin që ka ofertë me të lirë MSH-së të bëjë kontratë dhe FSSH-ja të mbajë kontakte të rregullta, kur trajtohen pacientët	Pjesërisht i zbatuar 
		Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës për vitin 2021	
1	MSH	Ministria e Shëndetësisë të sigurojë që emërimi i anëtarëve të Bordit të bëhet në pajtueshmëri të plotë me Ligjin Nr. 04/L-125 për Shëndetësi.	I zbatuar 
2	SHSKUK	Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori i Përgjithshëm të sigurojë kontrolle të shtuara, sa i përket përgatitjes dhe paraqitjes së pasqyrave vjetore financiare. Bordi dhe Drejtori i Përgjithshëm të sigurojë që zyrtari kryesor financiar të ketë përgatitjen profesionale, njohuritë dhe trajnimet e nevojshme, për të kuptuar dhe zbatuar drejt kërkesat e raportimit financiar. Pasqyrat vjetore financiare duhet t'i nënshtrohen një kontrolli të mirëfilltë nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Bordi i Drejtorëve.	Pjesërisht i zbatuar 
3	MSH dhe SHSKUK	Planifikimi i investimeve kapitale në spitalet rajonale, SHSKUK dhe identifikimi i nevojave për resurse njerëzore të bëhet në harmoni të plotë dhe bashkëpunim të ngushtë me MSH-në.	I zbatuar 
		Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2021	
1	MSH	Ministria e Shëndetësisë, ta ketë një fokus të veçantë në zbatimin e rekomanimeve që ka dhënë ZKA, në lidhje me Raportin e auditimit për pasqyrat financiare të MSH, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021	I zbatuar 
		Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore	

		financiare të NP Telekomi i Kosovës sha për vitin 2021	
1	Telekomi i Kosovës	Bordi i Drejtorëve të bëjë plan strategjik 2- vjeçar, për përmirësim të performancës financiare, për zhvillim strategjik të kompanisë, për zbatim të planeve dhe arritje të rezultatit pozitiv financiar	I pazbatuar
2	Telekomi i Kosovës	Të forcohen kapacitet e zyrës ligjore, në përfaqësim ligjor të kompanisë, nëse ka nevojë edhe angazhim të ekspertëve ligjorë ndërkombëtarë	I zbatuar
3	Qeveria	Qeveria të vazhdojë mbështetjen financiare për Telekomin, në harmoni me planin strategjik dhe nga Bordi të kërkohen raporte financiare 6- mujore, për rezultate konkrete financiare.	I pazbatuar
		Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të ndërmarrjes KRM Pastrimi sha për vitin 2021	
1	KRM Pastrimi	Bordi i Drejtorëve të KRM PASTRIMI në koordinim të plotë me bordin e aksionarëve (Komuna e Prishtinës, Drenasi, Podujeva, Fushë-Kosova dhe Lipjani) ta zbatojnë Ligjin 04/L-060 i ndryshuar me Ligjin NR. 08/L-071. Pra, operatoret për menaxhimin e mbeturinave janë të detyruar të nxjerrin planin e veprimit për menaxhimin e mbeturinave dhe po ashtu ky plan i menaxhimit nxjerrët nga operatoret në periudhë 5 vjeçare.	I pazbatuar
2	KRM Pastrimi	KRM ‘’PASTRIMI, në koordinim me aksionarët të harmonizojë investimet kapitale, blerjen e makinerisë, shtimin e pikave grumbulluese të mbledhjes së mbeturinave në harmonizim të plotë me planin e veprimit të menaxhimit të mbeturinave dhe atë për periudhën 5 vjeçare	I pazbatuar
3	KRM Pastrimi	Bordi i Drejtorëve duhet ta bëjë një strategji afatgjate për përpunimin dhe riciklimin e mbeturinave, në kuadër të planit të veprimit për menaxhim të mbeturinave të bëhet parandalimi i hedhjes së mbeturinave Ky proces të bëhet në harmonizim të plotë me komunat, siç kërkohet me Ligjin 04/L-060 i ndryshuar me Ligjin NR. 08/L-071.	I pazbatuar
		Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Përgjithshëm për Raportin Vjetor Financiar të Qeverisë për vitin 2021	
1	MFPT	Qeveria përkatësisht, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) dhe Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), të bëjnë rishikimin funksional të sistemeve si E-pasurisë, SIMFK, PIP dhe SZHMB, në mënyrë që të shikohet mundësia e fuzionimit të tyre, ose të rritet mundësia e komunikimit dhe e shkëmbimit më të mirë të informatave ndërmjet këtyre sistemeve.	I pazbatuar
2	MFPT	Qeveria përkatësisht, MFPT, të ushtrojnë ndikimin e vetë ligjor, që institucionet t’i bëjnë funksionale Njësitë e Auditimit të Brendshëm me staf të mjaftueshëm dhe Komitetet e Auditimit sipas kritereve të dhëna me Rregulloren 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm dhe sipas Udhëzimi Aadministrativ 01/2019 për Komitetet e Auditimit	I pazbatuar

3	MFPT	OB të zbatojnë në përpikëri ligjin e buxhetit për obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak në mënyrë që të bëhen ndryshimet e nevojshme në tabelat e ligjit të buxhetit dhe të mos fillohet me krijimin e obligimeve të reja pa i realizuar obligimet paraprake.	I pazbatuar 
4	MFPT	Qeveria e Republikës së Kosovës me rastin e përgatitjes së kërkesave të huamarrjes fillimisht me ministritë e linjës duhet të përgatisë në detaje të gjitha dokumentet ligjore dhe procedurale me qëllim që me rastin e sigurimit të huamarrjes mos të ketë ngecje në implementim e projekteve.	I pazbatuar 

Shtojca III: Llojet e opinioneve për OB-të e audituara në tri vitet e fundit

Tabela nr. 40 – Opinionet e auditimit të nivelit qendror për tri vite

Nr.	Subjektet e audituara	Opinioni i auditimit		
		2022	2021	2020
1	Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
2	Zyra e Presidentit	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
3	Zyra e Kryeministrit	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
4	Ministria e Financave, Punës the Transfereve	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
5	Dogana e Kosovës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
6	Administrata Tatimore e Kosovës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
7	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
8	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	Kualifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
9	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
10	Ministria e Shëndetësisë	Pamodifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
11	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
12	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
13	Ministria për Komunitete dhe Kthim	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
14	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	Kualifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
15	Ministria e Ekonomisë	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
16	Ministria e Punëve të Brendshme	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
17	Ministria e Drejtësisë	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
18	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diaspora	Pamodifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
19	Ministria e Mbrojtjes	Kualifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
20	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar I Kosovës	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
21	Ministria e Zhvillimit Rajonal	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
22	Fondi i Sigurimit Shëndetësor	Kualifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
23	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
24	Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
25	Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
26	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
27	Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës	Kualifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
28	Agjencia Kosovare e Privatizimit	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
29	Organi Shqyrtues i Prokurimit	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
30	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
31	Universiteti i Prishtinës	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar

32	Gjykata Kushtetuese	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
33	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
34	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
35	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
36	Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
37	Këshilli Prokurorial i Kosovës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
38	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
39	Agjencia për Menaxhimin e Kompleksеve Memoriale	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
40	Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror	Pamodifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
41	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
42	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
43	Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
44	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
45	Komisioni i Pavarur për Media	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
46	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Kualifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
47	Insitucioni i Avokatit të Popullit	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
48	Akademia e Drejtësisë	Pamodifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
49	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Pamodifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
50	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
51	Radio Televizioni i Kosovës	Kualifikuar	I kundërt	n/a
52	Fondet në Mirëbesim	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
53	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	n/a	n/a	Kualifikuar

Tabela nr. 41 – Opinionet e auditimit të nivelit lokal për tri vite

Nr. rend	Komuna	Opinioni i auditimit		
		2022	2021	2020
1	Gllogoc	Kualifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
2	Fushë Kosovë	Kualifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
3	Lipjan	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
4	Obiliq	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
5	Podujevë	Kualifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
6	Prishtinë	Kualifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
7	Shtime	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
8	Graçanicë	Kualifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
9	Dragash	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
10	Prizren	Kualifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
11	Rahovec	Pamodifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
12	Suharekë	Pamodifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
13	Malishevë	Pamodifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
14	Mamushë	Pamodifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
15	Deçan	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
16	Gjakovë	Kualifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
17	Istog	Kualifikuar	I kundërt	Kualifikuar
18	Klinë	Kualifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
19	Pejë	Pamodifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
20	Junik	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
21	Mitrovicë	Kualifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
22	Skenderaj	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
23	Vushtrri	Pamodifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
24	Gjilan	Kualifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
25	Kaçanik	Pamodifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
26	Kamenicë	Kualifikuar	Pamodifikuar	Kualifikuar
27	Novo Bërd	Pamodifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
28	Shtërpcë	Pamodifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
29	Ferizaj	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
30	Viti	Kualifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
31	Partesh	Pamodifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
32	Hani i Elezit	Pamodifikuar	Kualifikuar	Pamodifikuar
33	Kllokot	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
34	Ranillug	Pamodifikuar	Pamodifikuar	Pamodifikuar
35	Zubin Potok	/	Kualifikuar	Kualifikuar
36	Zveçan	/	Kualifikuar	Kualifikuar
37	Mitrovica Veriore	/	Kualifikuar	Kualifikuar
38	Leposaviq	/	Kualifikuar	Kualifikuar

Shtojca IV: Shpjegimi i llojeve të ndryshme të opinioneve dhe konkluzioneve të aplikuara nga ZKA

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinioni i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinioni

Opinion i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar

transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave;

b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose

c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe i përhapur.

Konkluzionet e auditimit

- **Konkluzioni i Pamodifikuar** - Paraqet opinionin e auditorit se proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtim të plotë me kriteret e përcaktuara të auditimit;
- **Konkluzioni i Kualifikuar** - Paraqet opinionin e auditorit se proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtim të plotë me kriteret e përcaktuara të auditimit, përveç ndonjë çështjeje të caktuar e cila përshkruhet te baza për konkluzion të pajtueshmërisë;
- **Konkluzioni i kundërt** - Paraqet opinionin e auditorit se proceset dhe transaksionet përcjellëse nuk janë në pajtim me kriteret e përcaktuara të auditimit; dhe
- **Mohimi i konkluzionit** - Paraqet gjendjen kur auditori për shkak të pamundësisë për marrjen e dëshmive të duhura dhe pa pajtueshmërive të përhapura në shumë fusha, nuk është në gjendje të nxjerrë konkluzion lidhur me pajtueshmërinë.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin ‘Theksim i çështjes’ ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç’pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

lShtojca V: Letër Konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarsvo za Finansije, Rada i Transfera – Ministry of Finance, Labour and Transfers

LETËR E KONFIRMIMIT PËR ZYRËN KOMBËTARE TË AUDITIMIT

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese konfirmoj se:

- Kam pranuar draft-raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit Vjetor Financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës, për vitin e përfunduar më 31.12.2022 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- Nuk pajtohem me disa nga gjetjet dhe rekomandimet në përmbajtjen e Raportit. Gjetjet për disa pjesë janë jo-materiale kurse për disa të tjera janë probleme historike e të cilat nuk janë pasqyruar si të tilla. Detajet lidhur me këto mospajtime janë bërë të ditura përmes komenteve me shkrim të dërguara nga Ministria;
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe institucionet përgjëgjëse për zbatimin e tyre.



Hekuran Murati

Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

Datë: 28 Gusht 2023, Prishtinë

Shtojca VI: Pasqyrat kryesore financiare të Qeverisë

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për Qeverinë e Përgjithshme

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022

	Shënim	2022 Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €	2021 Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €	2020 Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €
PRANIMET				
Tatimet Direkte				
Tatimi në të ardhura të korporatave	2	159,942	113,946	85,279
Tatimi në të ardhura personale	3	215,560	189,521	157,966
Tatimi në pronë	4	34,554	36,258	22,707
Tatime tjera direkte	5	3,773	2,440	1,294
		413,829	342,165	267,247
Tatimet Indiekte				
Tatimi mbi vlerën e shtuar	6	1,220,007	1,038,218	770,145
Detyrimi doganor	7	132,663	124,606	101,618
Akciza	8	517,264	501,295	398,072
Tatime tjera indirekte	9	313	565	2,900
		1,870,248	1,664,685	1,272,735
Kthimet tatimore				
Kthimet tatimore	10	-67,069	-58,912	-32,999
		-67,069	-58,912	-32,999
Të hyrat jo-tatimore				
Taksa,ngarkesa dhe tjera nga OB-të Qeveria Qendrore	11	149,311	129,563	103,486
Taksa,ngarkesa dhe tjera nga OB-të Qeveria Lokale	12	55,596	57,271	42,716
Taksa koncesionare	13	18,404	16,972	2,651
Renta minerare	14	29,857	19,235	29,362
Të hyrat nga interesi (kreditë për NP)	15	3,365	3,074	2,986
Të hyrat nga dividenta	16	-	10,000	-
		256,532	236,116	181,201
Huamarrja				
Huamarrja e jashtme shtetërore	17	98,198	117,334	211,389
Pranimet për shërbimin e nënhuazimeve	18	8,149	8,005	7,688
Huamarrja e brendëshme shtetërore	19	5,854	144,247	169,955
		112,201	269,586	389,031
Grantet dhe ndihmat				
Grantet e përcaktuara të donatorëve	20	9,738	16,800	9,048
Grantet për mbështetje buxhetore	21	10,250	-	34,030
		19,988	16,801	43,078
Pranimet tjera				
Fondi i depozitave	22	5,548	4,462	1,018
Kthimet e kredive nga ndërmarrjet publike	23	11,387	11,387	11,387
Të hyrat e dedikuara	24	5,888	4,645	2,473
Financimi i njëhershëm i AKP-së	25	-	39	71,476
Gjithsej Pranimet		**2,628,552**	**2,490,973**	**2,206,647**
PAGESAT				
Operacionet				
Paga dhe shtesa	26	653,436	668,124	661,343
Mallëra dhe shërbime	27	337,414	306,255	280,007
Shërbime komunale	28	25,952	25,287	22,168
		1,016,802	999,666	963,518
Transferet				
Subvencione dhe transfere	29	1,065,195	842,897	868,480
Shpenzimet kapitale				
Prona,impiantet, pajisjet,transferet	30	422,579	423,941	384,471
Pagesat tjera				
Pagesa e borxhit / kryegjëja dhe interesi	31	83,322	111,192	115,713
Kredidhënia për ndërmarrjet publike	32	35,724	-	-
Kthimet nga fondet e depozitave	33	1,386	1,044	2,761
Gjithsej Pagesat		**2,625,008**[1]	**2,378,740**	**2,334,943**
Rritje/(Zbritje) në para të gatshme		3,544	112,233	(128,295)
Para të gatshme në fillim të vitit	**34**	442,189	329,955	458,251
Para të gatshme në fund të vitit	**34**	**445,734**	**442,189**	**329,955**

[1] Përfshihen shpenzimet nga vendimet gjyqesore dhe përmbarimore në shumë prej 46.3 milion euro, detajet sipas kategorive ne shenimet 26 deri 30.

Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të buxhetit me realizimin për Qeverinë e Përgjithshme

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022

		2022				2021	2020
	Shënim	Realizimi A '000 €	Buxheti përfundimtar B '000 €	Buxheti fillestar C '000 €	Ndryshimet buxhetore D=B-A '000 €	Realizimi '000 €	Realizimi '000 €
RRJEDHA HYRËSE E PARASË SË GATSHME							
Tatimet direkte		413,829	392,600	399,000	-21,229	342,165	267,247
Tatimet indirekte		1,870,248	1,837,800	1,763,000	-32,448	1,664,685	1,272,735
Kthimet tatimore		-67,069	-61,500	-59,000	5,569	-58,912	-32,999
Të hyrat jo-tatimore		256,532	239,100	239,000	-17,432	236,116	181,201
Grantet dhe ndihmat[2]		19,988	22,500	23,000	2,512	16,801	43,078
Huamarrja		112,201	543,000	503,000	430,799	269,586	389,031
Pranimet tjera[3]		22,823	37,000	37,000	14,177	20,533	86,355
Gjithsej Pranimet		**2,628,552**	**3,010,500**	**2,905,000**	**381,948**	**2,490,973**	**2,206,647**
RRJEDHA DALËSE E PARASË SË GATSHME							
Paga dhe shtesa		652,641	683,206	671,000	30,565	667,312	660,768
Mallra dhe shërbime		333,374	397,840	373,000	64,466	302,410	276,995
Shpenzime komunale		25,950	30,430	31,000	4,480	25,287	22,168
Subvencione dhe transfere		1,064,068	1,114,919	895,000	50,851	842,570	867,794
Shpenzime kapitale		419,253	698,686	704,000	279,433	419,807	379,713
Rezerva		-	1,920	21,000	1,920	-	-
Interesi		35,039	41,000	41,000	5,961	30,881	27,505
Të tjera[4]		94,684	190,870	179,500	96,186	90,473	100,000
Gjithsej Pagesat	35	**2,625,008**	**3,158,870**	**2,915,500**	**533,862**	**2,378,740**	**2,334,943**
Rritja/(Zbritja) e parasë së gatshme		**3,544**	**(148,370)**	**(10,500)**	**(151,914)**	**112,234**	**(128,295)**

[2] Te planifikimi buxhetor (kolona B dhe C) përfshihen grantet e përcaktuara të donatorëve (12 milionë euro) si dhe grantet për mbështetje buxhetore (10.5 milionë euro, përkatësisht 11 milionë euro si buxhet fillestar), si fonde të planifikuara për pranim në vitin 2022.

3 Përfshihen, të hyrat e dedikuara, kthimet e kredive nga ndërmarrjet publike, financimi i njëhershëm nga AKP dhe pranimet nga depozitat.

4 Përfshihen pagesat e kryegjësë, nen-huazimeve, granteve te përcaktuara të donatorëve, diskonti i letrave me vlerë, pagesat për antarësim në IFN dhe kthimet nga fondet e depozitave (neto). Nuk përfshihet transaksioni për kuota ne IFN i cili përbën ndryshim të formës se pasurisë (nga paraja e gatshme ne instrument financiar – kuota/aksione), përkatesisht referuar ndarjeve buxhetore te vitit 2022 dhe te prezantuar ne kolonën B dhe C.

Pasqyra e konsoliduar e pasurive financiare dhe bilanceve të fondeve për Qeverinë e Përgjithshme

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022

	Shënim	2022 Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €	2021 Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €	2020 Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €
Pasuritë financiare - paraja e gatshme				
Banka Qendrore e Kosovës	36	419,664	423,322	316,897
Kuotat në IFN	37	8,210	3,734	1,741
Fondi në mirëbesim për zhvillim	38	3,256	2,636	1,971
Paratë e gatshme në transit	39	10,845	6,946	4,851
Llogaritë e Ambasadave të Republikës së Kosovës	40	2,527	2,068	1,751
Paratë e gatshme në dorë (arka) dhe avance te hapura	41	1,233	3,484	2,744
Gjithsej pasuritë financiare dhe para të gatshme		**445,734**	**442,189**	**329,955**
Qëllimet specifike				
Të përcaktuara nga donatorët	42	15,505	15,818	9,752
Të hyrat vetanake - niveli qendror	43	2,584	1,436	1,765
Të hyrat vetanake - niveli lokal	44	90,005	80,078	55,994
Fondi në mirëbesim për zhvillim	45	7,974	7,354	7,078
Të hyrat e dedikuara	46	2,285	467	52
Të tjera	47	24,807	19,812	15,894
Fondet e pashpenzuara nga huamarrja	48	16,751	5,131	3,941
		159,912	**130,095**	**94,475**
Bilanci i pashpërndarë i parasë së gatshme		**285,822**	**312,094**	**235,480**
Gjithsej Bilanci i Fondeve	34	**445,734**	**442,189**	**329,955**